




Republika e Kosovës



Komuna e Malishevës

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORIVE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS (Janar – Dhjetor 2023)

Ky raport është një format i përmbledhur i të gjitha angazhimeve dhe punëve që janë bërë nga Kryetari i Komunës së Malishevës, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë drejtorët e drejtorive komunale, gjatë vitit 2023

KRYETARI
Ekrem Kastrati

Malishevë, Maj 2024

1. HYRJE...	f. 2-5
2. DREJTORIA E URBANIZMIT.....	f. 5-8
3. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....	f. 8-15
4. DREJTORIA E INSPEKTORATIT.....	f. 16-22
5. DREJTORIA E SHËNDETSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE.....	f. 22-32
6. DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM.....	f. 32-42
7. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL.....	f. 43-53
8. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE.....	f. 54-57
9. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT.....	f. 57-67
10. DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM.....	f. 67-73
11. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME.....	f. 73-75
12. DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCË DHE BUXHET.....	f. 75-97
13. PROJEKTET KAPITALE.....	f. 98-104
14. PËRFUNDIM	f. 105

HYRJE

Ky raport është një format i përbledhur i të gjitha angazhimeve dhe punëve që janë bërë nga Kryetari i Komunës së Malishevës, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë drejtorët e drejtorive komunale, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023. Ky raport është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Malishevës dhe akteve tjera nënligjore. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, angazhimi kryesor i Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera komunale, ka qenë në funksion të respektimit të rendit, ligjit dhe disiplinës në punë. Aktivitetet kryesore të Kryetarit të Komunës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 kanë qenë këto:

- ♣ Koordinimi i punëve me drejtorë të drejtorive, me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe realizimit të punëve sipas planeve përkatëse.
- ♣ Mbajtja e takimeve të rregullta me drejtorë të drejtorive, përcaktimi i detyrave dhe raportimi për punët e realizuara
- ♣ Mbikëqyrja e realizimit të buxhetit të Komunës dhe realizimit i të hyrave vetanake për vitin 2023, si dhe shfrytëzimi sa më racional i mjeteve buxhetore.
- ♣ Mbikëqyrja e realizimit të projekteve kapitale të Komunës
- ♣ Raportimi i rregullt në Kuvendin e Komunës – çdo 3 muaj për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore
- ♣ Propozim aktet për shqyrtim dhe miratim në Asamblenë Komunale
- ♣ Mbikëqyrja në ngritjen e performancës në Administratën e Komunës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarët
- ♣ Takimet publike me qytetarët, për çështje të ndryshme, duke përfshirë edhe dy takimet vjetore, që janë edhe obligim ligjor
- ♣ Bashkëpunimi me institucionet qendrore, për projekte me interes për qytetarët dhe komunën tonë.
- ♣ Takime dhe bashkëpunime me organizata qeveritare dhe OJQ vendore e ndërkombëtare, përfaqësues të USAID-it, OSBE-së, KFOR-it, dhe me organizata humanitare, me të cilat kemi realizuar edhe disa projekte në bashkëfinancim, në fushën e mirëqenies sociale,
- ♣ Bashkëpunimi i ngushtë me të gjitha shoqatat e dala nga lufta, me pensionistët, veteranët e arsimit, etj.
- ♣ Ka përfaqësuar Komunën nëpër vizita zyrtare, gjithnjë në funksion të bashkëpunimit dhe mundësisë së sjelljes së investuesve të mundshëm në territorin e komunës së Malishevës.

Gjithashtu, në këtë Raport, të listuara dhe të detajuara janë edhe disa nga fushat kryesore të angazhimit të kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit në përgjithësi gjatë vitit 2023:

- Diskutimet publike dhe bashkëpunimi me qytetarët
- Furnizimi me ujë të pijes në tërë territorin e Komunës së Malishevës
- Mirëmbajtja e mjedisit
- Përkrahja e familjeve me kushte të rënda ekonomike
- Bashkëpunimi me institucionet qendrore
- Bashkëpunimi me partnerët dhe donatorët vendorë e ndërkombëtarë
- Realizimi i Planit të Punës sipas Drejtorive

FURNIZIMI ME UJË TË PIJES NË TËRË TERRITORIN E KOMUNËS SË MALISHEVËS

Furnizimi me ujë të pijes është një nga problemet me të mëdha me të cilën jemi duke u ballafaquar si Komunë ndër vite. Qeverisja jonë komunale ka vazhduar me angazhimin e saj rreth mundësisë së realizimit të projektit për furnizimin me ujë të pijes për të gjithë fshatrat e komunës së Malishevës, përmes kyçjes në ujësjellësin e Radoniqit. Pjesa më e madhe e fshatrave kanë probleme të mëdha lidhur me mungesën e ujit të pijes, derisa edhe ato fshatra që janë të kyçura përmes kompanisë së “Hidroregjionit Jugor”, çdo ditë e më tepër po kanë problem në rritje, si me mungesë të ujit, po ashtu edhe me prishje të kohëpaskohshme të sistemit të ujësjellësit për shkak edhe të amortizimit të gypave aktual. Njëri nga zotimet tona kryesore ka qenë edhe zgjidhja e problemit sa i përket mungesës së ujit të pijes nëpër fshatrat tona. Si rrjedhojë e kësaj, në takimet tona, pothuajse me të gjithë që jemi takuar, por edhe përmes mjeteve të informimit jeni njoftuar se, që në ditët e para të mandatit tonë, kemi ndërmarrë hapat e duhur në funksion të kësaj çështje. Që në start, kemi zhvilluar takime me kompaninë që operon

në Komunën tonë, dhe ia kemi përcjellë të gjitha pakënaqësitë e qytetarëve tanë lidhur me mungesën e furnizimit me ujë të pijes. Më pastaj, kemi aranzhuar edhe disa takime tjera me institucionet qendrore, por edhe me drejtuesit e Kompanisë Rajonale të Ujësjetllësit “Gjakova”, me të cilët kemi diskutuar lidhur me mundësinë e realizimit të projektit për të kyçur komunën tonë në sistemin e Radoniqit. Ne kemi vazhduar me takime edhe me ministritë përkatëse, dhe ju kemi shprehur kërkesat tona, të mungesës së furnizimit me ujë të pijes, si dhe mundësisë së kyçjes me sistemin e Radoniqit. Si rezultat i gjithë këtij angazhimi tonë, Këshilli Ndërmintor për Ujëra, që drejtohet nga kryeministri, ka marrë vendim që të formohen grupet punuese për gjetjen e zgjidhjeve për furnizim me ujë nëpër komuna, ku qeveria ka përzgjedhur 3 komuna, Malishevën, Ferizajin dhe Klinën. Këto grupe e kanë pas për detyrë që deri më 15 shtator të vitit të kaluar të ofrojnë zgjidhje teknike për secilën komunë, që do të thotë edhe për Komunën e Malishevës mirëpo ende nuk ka ndonjë rezultat konkret nga ana e tyre. Gjithashtu, ne si Komunë kemi vazhduar edhe bashkëpunimin me kompaninë që operon tek ne, “Hidroregjionin Jugor”, ku kemi nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi, që i ka hapur rrugë inicimit të disa projekteve konkrete, në funksion të shfrytëzimit maksimal të burimeve ekzistuese të ujit të pijes, mundësisë së rritjes së kapaciteteve në mënyrë që të bëjmë zgjidhje për të gjitha fshatrat e komunës sonë, si dhe për të ndërmarrë hapa konkret për menaxhimin e ujërave të ndotura. Gjithashtu, ne si Komunë, jemi angazhuar për të bërë zgjidhje për fshatrat Temeqinë dhe Janqist, si dhe në bashkëpunim me “Hidroregjionin Jugor”, jemi duke ndërmarrë hapat e duhur për jetësimin e plotë të burimit të ujësjetllësit në Senik. Vlen të theksohet se rreth kësaj çështje ne kemi bashkëpunuar edhe me partnerët ndërkombëtar, konkretisht me organizatën austriake “OSTAP”, të cilët edhe kanë bërë edhe një analizë dhe një plan detal për të kyçur gjithë fshatrat e komunës së Malishevës në sistemin e Radoniqit. Aktualisht bashkëpunimi me ta është në proces, dhe i jemi drejtuar Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Financave për të hyrë si garantuese në këtë projekt, ashtu siç edhe e kërkon legjislacioni në fuqi, por nuk kemi marrë përkrahjen e nevojshme për të ecur tutje më këtë projekt. Pra, këto janë disa nga angazhimet tona gjatë kësaj Periudhe, sa i përket çështjes së furnizimit me ujë të pijes për qytetarët e Komunës së Malishevës.

MIRËMBAJTJA E MJEDISIT

Sikurse çështja e ujit, për ne si Komunë por edhe për të gjithë qytetarët tanë, pa dyshim se një ambient i pastër është synim i yni i përbashkët. Ne kemi marrë hapat e nevojshëm në funksion të rritjes së ndërgjegjësimit për tu kujdesur për ambientin, sepse kujdesi për ambient është përkushtim direkt për një shoqëri sa më të shëndetshme në komunën tonë. Lidhur me këtë çështje, për këtë periudhë, mund të themi se gjendja e mirëmbajtjes së ambientit nëpër fshatra në përgjithësi është e mirë, mirëpo shqetësimi ynë është situata në zonën urbane, për çka edhe në takimet që kam zhvilluar me kompaninë e “Ekoregjionit”, ju kemi shprehur gjithë shqetësimin tonë por edhe të qytetarëve. Gjatë vitit 2023, kemi ndërmarrë disa aksione të pastrimit në qytet, me karakter ndërgjegjësimi ndaj ruajtjes dhe mirëmbajtjes së mjedisit dhe këto aktivitete do të vazhdojnë. Më pastaj, kemi bërë edhe krasitjen e drunjve nëpër qytet, që në një formë ndikon edhe në përmirësimin e imazhit të zonës së qytetit. Gjatë kësaj periudhe, vazhdon të jetë aktive Task Forca Komunale, që drejtohet nga nënkryetari i Komunës, e cila është marrë me menaxhimin e situatës lidhur me kujdesin për një mjedis sa më të pastër, konkretisht për menaxhimin e mbeturinave inerte dhe mbeturinave tjera në territorin e komunës së Malishevës, por edhe me pikën e mësipërme, pra; gjendjen e furnizimit me ujë të pijes.

Kemi marrë hapat e duhur, për të krijuar mekanizmat tona komunale, që të vazhdojmë edhe me eliminimin e pikave inerte nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës, ku gjatë kësaj periudhe kemi eliminuar rreth 100 pika inerte ilegale në tërë territorin e komunës sonë. Në bashkëpunim me kompaninë “EkoRegjioni Jugor” edhe këtë vit kemi aplikuar edhe larjen e rrugëve në qytet dhe kjo do të praktikohet vazhdimisht.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET QENDRORE

Bashkëpunimi me institucionet qendrore gjatë këtij viti raportues ka qenë domosdoshëm me gjithëse i vështirë. Në funksion të adresimit të kërkesave për të marrë përkrahje për projekte zhvillimore për komunën tonë, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Malishevës, së bashku me bashkëpunëtorë, vazhdimisht kemi zhvilluar takime me disa nga ministritë që lidhen ngushtë me fushën e projekteve tona. Kemi bashkëpunuar me Ministrinë e

Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, të cilave u jemi drejtuar me disa kërkesa për përkrahje të disa nga projekteve tona, të cilat kanë nevojë për më shumë buxhet se sa janë mundësitë tona komunale. Disa nga projektet që janë realizuar dhe janë në realizim e sipër përmes bashkëpunimeve me institucionet qendrore janë këto:

- Asfaltimi i rrugës Lumishtë deri të rrethi i Gurbardhit
- Rregullimi i parkut Mirusha – faza e parë (në proces)
- Rregullimi i tribunës lindore në stadiumin “Liman Gegaj” (në proces)
-

Ndërsa, në mesin e disa kërkesave të cilat i kemi adresuar dhe ende nuk kanë gjetur miratim janë:

- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës lokale nga fshati Lumishtë deri në fshatin Llapqevë (Mrasor)
- Mbështetje financiare për realizimin projektit të unazës-transitit – rruga për Dragobil
- Zgjerimi i rrugës nga Malisheva në drejtim të fshatit Banjë deri në hyrje të autostradës
- Rregullimi i rrugës nga dalja e autostradës deri në fshatin Duhël

BASHKËPUNIMI ME KEDS-KESCO

Në 3 vitet e fundit, periudhat e dimrit kanë qenë një problem i madh për komunën e Malishevës, pasi që kemi qenë ndër komunat e vetme në nivel vendi, që në ditët më të ftohta, jemi ballafaquar me mungesë të theksuar të energjisë elektrike. Në funksion të zgjidhjes së këtij problemi, kemi zhvilluar takime të me të gjitha institucionet qendrore që janë përgjegjëse për sigurimin e energjisë elektrike për qytetarët tanë. Kemi diskutuar për veprimet që duhet t'i ndërmarrim si palë, në mënyrë që komuna jonë të ketë rrjetin e ri elektrik, e me kapacitete të nevojshme nëpër secilin fshat të Malishevës. Siç edhe jeni informuar është arritur marrëveshja me KEDS/KESCO për shtrijen e një kablloje të re që do të rrisë kapacitetin e furnizimit me rrymë në komunën tonë me çka do të arrihet të zvoglohen reduktimet e rrymës. Jemi duke bashkëpunuar shumë me KOSTT për ndërtimin e Trafostacionit prej 220kW në Malishevë. Gjatë këtij viti është bërë hartimi i projektit për nënstacionin për Malishevën, kemi ndarë parcelën përmes Asamblesë, mirëpo aktualisht ka pengesa nga niveli qendror.

PËRKRAHJA E FAMILJEVE NË KUSHTE TË RËNDA EKONOMIKE

Komuna e Malishevës është ndër komuna që përmes politikave të saj, ka arritur t'u del krah në masë të madhe familjeve të cilat jetojnë në kushte të vështira ekonomike e sociale.

Si qeverisje komunale por edhe në bashkëpunim me donatorët, gjatë kësaj periudhe të raportimit kemi realizuar këto nisma:

Kemi përkrahur ndërtimin e mbi 15 shtëpive të banimit

Kemi bërë hapjen e 75 bunarëve për familjet në nevojë

Kemi përkrahur me pako ushqimore mbi 1000 familje

Kemi përkrahur me mjete financiare nga kategoria e subvencioneve mbi 150 raste me probleme shendetësore, gjithmonë në përputhje me mundësitë buxhetore që kemi për këtë kategori e që më duhet ta them që është shumë e vogël (e kufizuar) në raport me kërkesat e shumta që vinë në adresën tonë.

BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT DHE DONATORËT VENDORË E NDËRKOMBËTARË

Bashkëpunimi me partnerë dhe donatorë, qoftë vendorë apo ndërkombëtarë është e domosdoshme, sepse vetëm duke bashkëpunuar mund të bëjmë punë të mira për qytetarët tanë.

Kemi vazhduar bashkëpunimin me shoqatën "Jetimat e Ballkanit", pranë së cilës kemi adresuar një kërkesë për ndërtimin e dhjetëra shtëpive për familjet që kanë kushte të rënda, ku përparësi kanë fëmijët që janë jetimë, të moshuarit, por edhe familje tjera që nuk kanë kulm mbi kokë dhe që njëkohësisht kanë edhe truall të tyre.

Në bashkëpunim me këtë shoqatë janë përkrahur rreth 500 familje me pako ushqimore. Kemi bashkëpunuar me organizatën që financohet nga Qeveria Gjermane, "Help Kosova", më ç'rast kemi nënshkruar kontrata për grante me përfitues nga komuna e Malishevës. Ka vazhduar implementimi i projektit nëpër shkolla, konform marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatën zvicerane ABSM, në fushën e arsimit profesional

Kemi bashkëpunuar me organizatën Qatar Charity në bashkëpunim me të cilët janë realizuar disa projekte si:

- Hapja e bunarëve për qytetarët e komunës sonë me kushte të rënda ekonomike
- Përkrahja e fermerëve të komunës sonë me mekanizëm bujqësor
- Fillimi i projektit për ndërtimin e 10 shtëpive për familjet në nevojë, konform marrëveshjes së bashkëfinancimit me Komunën.

Kemi bërë kërkesë pranë organizatës së Qatar Charity për ndërtimin e një QMF të re në Kijevë (jemi në pritje të një përgjigje pozitive)

Gjithashtu, kemi aplikuar në projekte nërkufitare të Bashkimit Evropian, përmes një marrëveshje të bashkëpunimit me Komunën e Kumanovës (nuk është përkrahur)

Kemi nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me Komunën e Strugës, me karakter të përgjithshëm.

DREJTORIA E URBANIZMIT

Drejtoria e Urbanizmit, duke u mbështetur në fushë veprimtarin e vetë dhe planin e punës për vitin 2023, angazhimet e veta i ka fokusuar në realizimin e projekteve kapitale nga viti 2022 (projektet dyvjeçarë) dhe përgatitjen e materialeve paramasave, projekteve dhe parallogarive për projektet e vitit 2023 në lëmin e infrastrukturën publike.

Për vitin 2023 janë planifikuar projekte të infrastrukturës publike si ndërtimi-asfaltimi i rrugëve lokale, ndërtimi vazhdimi i trotuareve në Qytezë dhe në fshatra, ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza, rinovimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, rinovimi objekteve të shkollave fillore dhe të mesme, ndriçimi publik, investimet në shëndetësi arsim, sport, kulturë dhe mirëmbajtja e kanalizimeve të ujërave të zeza nëpër fshatra dhe Qytezë.

Projektet e infrastrukturës publike të realizuara në vitin 2023

- Ndërtimi-Asfaltimi i rrugë lokale dhe mirëmbajtja e tyre nëpër fshatra dhe Qytezë në gjatësi prej l=14.78 km (projekte dyvjeçare).
- Ndërtimi i rrugës kryesore “Ibrahim Mazreku” nga ura deri te dalja e rreth rrotullimit në lagjen e Gurit (asfaltim i rrugës l= 1500 m, trotuari l= 3000 m, kanalizim për ujera fekale dhe atmosferik l=2500 m, ndriçim l=3000 m, shenjezim horizontal dhe vertikal l=4500 m dhe shtegu për biçikleta l= 1500 m).
- Ndërtimi i sheshit dhe parkingut nëntokësorë në Malishevë dhe infrastrukturës tjetër përcjellesë nën dhe mbitokësore.
- Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Turjak.
- Renovimi-mirëmbajtja e 5.46 km kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatra e Komunës (projekt trevjeçar)
- Renovimi i kolektorit kryesorë të ujërave të zeza (faza e parë) fshatrat Bubël-Lumnishtë në gjatësi prej 2.5 km.
- Ndërtimi i trotuareve në gjatësi 3.3 km,
- Ndërtimi i tri fusha sportive në fshatrat; Guriq, Berishë dhe Stapanicë
- Ndriçimi publik renovimi i tyre nëpër fshatrat e Komunës dhe Qyteza

- Renovimi i objektit të Gjimnazit “Hamdi Berisha” Shkolla e mesme Profesionale ne Kijevë “Lasgush Poradeci” në Kijevë, Shkolla fillore e mesme e ultë “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, Shkolla fillore e mesme e ultë “Labinot Krasniqi” Mirushë, Shtëpia e Kulturës “Tahir Sinani”, Salla e Sportit “Habib Zogaj” me programin e efqiencës.
 - Punimet në stadiumin e Qytetit “Liman Gegaj” (vazhdim) në Malishevë
 - Trajtimi i deponive në territorin e Komunës
 - Ndërtimi i rrugës “Habib Berisha” dhe rregullimi i palestrës sportive
 - Ndërtimi i garazheve në QKMF, renovimi i objektit të QKMF-së dhe rregullimi i oborrit pullazit dhe rrethojës
 - Mirëmbajtja verore -dimërore e rrugëve urbane dhe lokale (km=25)
 - Renovimi i objektit të administratës nga programi i efqiences
 - Ndërtimi i serave bujqësore për fermerëve e fshatrave (46 sera).
- Dalja në terren dhe përgatitja e paramasave për ndërtimin asfaltimin e rrugëve lokale në fshatrat; Ngucat, Kravasari, Llapqevë, Mirushë, Turjakë, astrazup, rudë, Panorc, Pagarushë, Terpezë e Ulët, Shkarashnik, Lumnishtë, Banjë, gajak, Gurishtë, carrallukë dhe Gurbardhë, si dhe rinovimin e rrugëve lokale Drenovc-Vermicë, Carrallukë-Shkarashnik, Bellanicë-Ngucat, Dragobil-Pagarushë dhe Lumnishtë-Turjakë. Projekt që po vazhdojnë të realizohen, mirmbajtja e rrugëve lokale nëpër fshatra dhe Qytezë. Vlen të ceket edhe punimi i rruges Gurbardhë-Turjakë projekt i financuar nga ministria e Infrastrukturës ku deri tani pritet vetëm asfaltimi i sajë.
- Dalja në teren dhe përgaditja për fillimin e punimeve të renovimit të kanalizimit të ujrave të zeza të kolektorit kryesor (faza e parë) fshati Bubel-Lumnishtë, rregullimi kanalizimit te liqeni në fshatin Mirushë, dhe planifikimi i rregullimit të kanalizimit në fshatrat; Bubavec, Kijevë, Drenovc, Banjë dhe lagjen Mirditë në Malishevë si dhe mirmbajtja e kanalizimeve nëpër fshatra ku deri tani janë realizuar diku 12 kilometra, ky projekt është dy vjeçar.
- Dalja në teren dhe përgatitja e paramasave dhe parallogarive për punimin e ndriqimit publik dhe mirmbajtjen në fshatrat dhe Qytezë ku është mendur të jetë projekt tre vjeçar për mirmbajtje ku ka filluar implemtimi i tijë në disa fshatra dhe është duke u realizuar ku deri tani janë realizuar diku 15 km kabell të shtrirë dhe ndrrimi i poqave elektrik .Projekt tjetër është ndërtimi i rrugeve fushore ku deri tani gati të gjitha janë hapur vetem pritet të shtrohen me zhavorë ku deri tani ka mbetur të bëhet pranimi tekik i tyre.
- Gjatë kësaj periudhe një pjesë e stafit është marrë me pregaditjen e materialit të Planit Zhvillimor Komunal (2017-2025) ku si projekt për hartat zonale ku deri më tani janë mbajtur disa takime dhe janë shtjelluar shumë tema me interes për teritorin e Komunes sonë është duke vazhduar që brenda ktië viti të konkretizohet si prijekt ku është duke u financuar nga Kuvendi Komunal. Gjatë kësaj peruedhe kemi pasur edhe takime pune me Ministrinë e Planifikimit rrethë procedurave për finalizimin e hartes zonale për komunën ku është dorzuar materiali rrethë raportit të vlersimit të ndikimit në mjedisë ku po presim pergjigjin nga Ministria dhe të vazhdojm me procedura.
- Dalja në terren dhe përgatitja dhe vazhdimi i ndërtimit të zhveshtoreve dhe tribunave në stadiumin e qytetit ku është duke u punuar ku deri tani kanë përfunduar shumica e punëve janë në finalizim e sipër. Kemi përgatitur paramasën edhe për pjesën tjetër të zgjerimit të tribunave dhe terrenit ndihmës të fushave sportive. Si dhe fillimi i punimeve të fushave sportive në fshatrat Berishë, Stapanicë dhe Guriq.

- Një pjesë e stafit është marrë me përgatitjen e materialeve aplikacioneve për konkurrim në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për projektin mirëmbajtja e rrugës lokale Lumnishtë-Llapqevë, projekti tjetër ka qenë konkurrimi në Ministrinë e Zhvillimit rajonale rreth projektit të ndërtimit të çerdhes së fëmijëve në fshatin Bellanicë. Aktivitet tjetër është konkurrimi në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal me projektin rregullimi i parkut tek liqeni Mirusha ku edhe është fituar dhe kanë filluar punimet në realizimin e parkut Mirusha projek i financuar nga Ministria dhe Komuna dhe kohëve të fundit thirrja prezentimi i disa projekteve infrastrukturore në takimin rajonal në Prizren.
- Një pjesë e stafit ka qenë e angazhuar në ndërtimin e serave bujqësore për fermeret e komunës ku janë përfunduar dhe pranimi teknik i tyre është bërë.
- Si drejtori kemi marrë pjesë në komisione për pranimin teknik vlersime të projekteve të ndryshme në projekte kapitale.
- Rregullimi i garazheve dhe i rrethojës në shtëpinë e shëndetit Dr. “Shpëtim Robaj” në Malishevë ku si projekt është implementuar. Renovimi i nyjave sanitare dhe rregullimi nxehjes në objektin e administratës komunale ku janë realizuar dhe pranimi teknikë është përfunduar.
- Projekti i rregullimit të rrugës kryesore nga ura e madhe deri te transiti i shkollës profesionale ku është realizuar ku pritet vetëm pranimi teknik, projekt ku është planifikuar të zgjerohet rruga edhe me një shirit ndihmës, asfaltimi l=1500 m, ndriqimi elektrik i punuar në gjatësi l=3000 m, punimi i sinjalizimi horizontal dhe vertikal l=4500 m, trotualet në të dy anët e rrugës l=3000 m dhe shtegu për qiklizem l=1500 m dhe gjithë infrastruktura nëntokësorë e punuarë si dhe punimi nëntokësorë i kabllave të energjisë elektrike.
- Vlenë të përmendet edhe implementimi i programit të efijences në katër objektet publike; Shtëpia e kulturës “Tahir Sinani”, shkolla e mesme “Hamdi Berisha”, QKMF “Shpëtim Robaj” dhe shkolla e mesme profesionale në Kijevë i financuar nga fondi i efijncës Kosovare ku deri tani janë përfunduar.
- Kemi hapur konkursin për Projektim Arkitekonik dhe Urbanistik për **“Ndërtimin e Sheshit së bashku me parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës”** i cili konsiderohet si projekti më i madh i realizuar në komunën e Malishevës , ku është duke u punuar me tempo të lartë në gërmimin e parkut për ndertim të parkingut dhe pregaditjen për perfundim të ures së madhe dhe lëshurja për qarkullim.
- Kemi kontraktuar rrugën që lidhet nga shkolla profesionale Qendra e Kompetencës rruga “Habib Berisha” që kalon ka restoran Princesha Palace që lidhet me rrugë e unazës së qytetit deri të stadiumi i qytetit “Liman Gegaj”, ku deri tani kanë përfunduar punimet e rrafshimit dhe zgjerimit ku priten vetem asfaltimi i tyre.
- Në bashkëpunim me ministrine e Arsimit |Shkencës dhe Teknologjisë është lidhur kontrata për renovimin e objektit të vjetër të shkollës fillore “Naim Frashëri” në Banjë që dotë shërbëj si qerdhe për fëmijë 447,000.00 €, ku deri tani janë përfunduar diku pedhjetërqin të punimeve.
- Në drejtorin e Urbanizmit gjatë periudhës Janar- Dhjetor janë parashtruar gjithsejtë 466 kërkesa, ku 271 kërkesa janë realizuar (leje ndertimore, kushte urbanistike, vërtetime, pëlqime, leje perdorimi, leje mjedisore

dhe raporte teknike) dhe 195 kërkesa janë në shqyrtim. Të hyrat financiare në drejtori gjatë kësaj periudhe janë në vlerë prej 438,103.20 €.

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, në përputhje me mandatin e saj ligjor ka arritur të realizojë pjesën më të madhe të objektivave të parapara për vitin 2022. Në fillim të kësaj periudhe janë vendosur në prioritet kërkesat dhe lëndët e papërfunduara gjatë vitit paraprak, shqyrtimi i të gjitha kërkesave brenda afatit të rregullt ligjor, thellimi i bashkëpunimit me të gjitha departamentet në Komunën e Malishevës si dhe organet tjera relevante në nivel qendror.

Janë bërë shumë reforma në infrastrukturën ligjore me anë të udhëzimeve administrative nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës të cilat kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e efikasitetit të punës në sektorin e gjeodezisë dhe kadastrit.

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë brenda saj ka tre sektorë të cilët dallojnë për nga lloji i shërbimeve dhe lëndëve që janë kompetente për t'i shqyrtuar. Ka numër dhe lloje të ndryshme të kërkesave që kryhen në këtë drejtori si: kërkesa për ndërrim pronari, regjistrim dhe fshirje të hipotekave, kërkesa për ndarje dhe bashkim të parcelave, kërkesa tereni nga bashkësitë lokale të fshatrave, kërkesa për rilevim të pronave publike, kërkesa për historiate të parcelave, si dhe kërkesa tjera shtesë nga departamentet tjera brenda administratës komunale.

Përshkrime të përgjithshme për fushën e veprimit të drejtorisë

- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, kryen punë profesionale dhe shërbime tjera subjekteve të ndryshme, është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, sigurimin e hartave Orto-Foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën;
- Planifikimi i rrjetit me pika të reja kontrolluese dhe themelimi i pikave të reja;
- Vektorizimi i planeve të skanuara-i ngastrave dhe zonave kadastrale;
- Azhurnimi i pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe të matjeve të reja;
- Ndarja e ngastrave dhe shënimi i kufijve në rastin e shpronësimit, kryen procedurat e përgatitjes së dokumentacionit rreth shpronësimit të tokës;
- Regjistrimi i pronës së paluajtshme në regjistrat e tokës;
- Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas detyrës zyrtare dhe zhvillon procedurat e regjistrimit sipas kërkesës së palëve;
- Bënë korrigjimin e regjistrit lidhur me regjistrimin e pronës sipas ligjeve në fuqi;
- Bënë azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara, azhurnimi i regjistrit të ndërrimeve të matjeve nga terreni;
- Regjistrimin e hipotekës;

- Regjistrimin e servituteve;
- Regjistrimin e pronës dhe të objekteve;
- Regjistrimin e pronës së dhënë në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër;
- Lëshon certifikata të pronësisë, kopje plani;
- Mbron pronën komunale-publike nga uzurpimet dhe udhëheqë procedurat lidhur me këtë çështje, etj

Ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret

Të gjitha procedurat dhe veprimet në kuadër të kësaj drejtorie janë të rregulluara e të mbështetura me dispozita ligjore të paraqitura si më poshtë:

- Ligji Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme;
- Ligjit Nr. 2003/13 mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit Nr. 2002/5 mbi Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme;
- Ligji Nr. 04/L-009 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligji Nr. 2002/5 mbi Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme;
- Ligji nr. 04/L-013 për Kadastër;
- Ligji Nr. 2002/4 për Hipotekat;
- Ligji mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronësores–Juridike të Krijuara me Uzurpim Arbitrarë të Tokës në Pronësi Shoqërore (GZ. nr. 46/77);
- Ligji me Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronësores – Juridike të Krijuara me Uzurpim Arbitrarë të Tokës në Pronësi Shoqërore (GZ. nr. 37/88);
- Ligji mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L – 031;
- Udhëzim Administrativ Nr. MSHP2004/03 për Zbatimin mbi Themelimin e Regjistrimit për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme;
- Udhëzim Administrativ Nr. 02/2013 për Zbatimin e Ligjit për Kadastër;
- Udhëzim Administrativ (MEA) nr. 09/2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme;
- Udhëzim Administrativ MMPH nr 08-2019 për Tarifat e Produkteve dhe Shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës;
- Udhëzim Administrativ MMPH – nr 09-19 për Ndarjen e Zonave Kadastrale;
- Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 10/2019 për Matjet kadastrale për Regjistrim në Kadastër;
- Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 11/2019 për Ndarjen e Ndërtesës dhe të Pjesëve të Ndërtesës;
- Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 12/2019 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës;
- **Udhëzim Administrativ (MMPH) nr 13-2019 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe të Gjeodetëve;**
- Korniza për Punë Nr. AKK 2013/01 për Korrigjimin e Sipërfaqeve;
- Rregullorja për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për Vitin 2017, Nr. 02/80;
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 03/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 01/2022 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy Bashkëshortëve;

Objektivat e parapara për vitin 2023

Gjatë vitit 2023 sipas planit të punës kemi paraparë dhjetë objektiva, të cilat janë:

1. Vendosja në plan të parë për shqyrtim dhe miratim i të gjitha kërkesave të parashtruara në fund vitit 2022;
2. Identifikimi parcelave, në të gjitha Zonat Kadastrale, në të cilat mungon tipi i pronës apo attribute tjera të pronës, regjistrimi i lëndëve dhe arkivimi i dokumenteve;
3. Azhurnimi i pjesës grafike në zonat kadastrale, në të cilat nuk përputhen pjesa tekstuale me pjesën grafike;
4. Implementimi në regjistra kadastral i Vendimeve Përfundimtare të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësim dhe krijim të të drejtës së servitutit për linjat e Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu KOSTT sh.a në Zonat Kadastrale brenda territorit të Komunë së Malishevës;
5. Implementimi i vendimeve të vjetra për ekspopojim të pronës në rrugët regjionale, aty ku nuk janë bërë ndryshimet sipas lëndëve dhe regjistrave për zgjerimin e rrugëve;
6. Zhvillimi i procedurave administrative, në lidhje me këmbimin e pronës komunale me pronë private, sipas kërkesave të aprovuara nga Kuvendi Komunal;
Përgatitja e lëndëve të cilat janë në shqyrtim në Kuvendin Komunal, lidhur me çështjet pronësore si: dhënia e pronës në shfrytëzim, këmbimi i pronës komunale me pronën private, parcializimin e pronës për ndonjë interes të përgjithshëm, etj.
7. Identifikimi i uzurpimeve të pronës publike komunale, që hynë nën kompetencën e Komunës së Malishevës, zhvillimi i procedurave administrative për uzurpim, përgatitja e lëndëve për gjykatë;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për matje, incizim, kërkesa për rilevim të pronave e rrugëve publike, kërkesa nga Kryetari, Drejtoria e Urbanizimit, Drejtoria e Inspektoratit, institucione tjera, policia, gjykata, bashkësitë lokale, etj.
9. Puna në RDPP, shqyrtimi i të gjitha kërkesave që kanë të bëjnë me regjistrim të pronave, hipotekave, barrave tatimore, vendimeve gjyqësore, regjistrimi i ndarjeve dhe bashkimit të parcelave, servituteve, etj.
10. Sipas kërkesës së Organeve më të larta të Komunës, Kryetarit, Kuvendit, apo përfaqësuesit ligjor do të ofrojmë informata dhe dokumente të nevojshme, në lidhje me pronat komunale.

Realizimi i objektivave

Në realizimin e objektivave për vitin 2023, ka qenë i përkushtuar i gjithë stafi i drejtorisë. Ashtu siç edhe janë paparaqitur me lartë objektivat kemi filluar me shqyrtimin dhe trajtimin e kërkesave të cilat kanë mbetur pa u shqyrtuar në vitin 2022. Gjithmonë kemi vendosur prioritet para vetës që të shqyrtohen të gjitha kërkesat e viteve paraprake në mënyrë që palët të marrin shërbimin dhe përgjigjen sipas kërkesës së tyre.

Gjatë punës së përditshme kemi hasur në shumë raste që mungojnë disa attribute të cilat duhet t'i kenë regjistrat kadastral, si tipi i pronës, lloji i shfrytëzimit, e po ashtu edhe mos harmonizim të pjesës grafike dhe asaj tekstuale. Në këto rrethana kemi paraqitur si objektiv para vetës që të bëhen modifikimet e nevojshme në regjistrat kadastral, plotësimi i të dhënave bazuar në dokumentacionet që posedojmë dhe autorizimet ligjore që kemi.

Në takimet që kemi pasur me zyrtar të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSTT sh.a, në lidhje me regjistrimin e vendimeve përfundimtare për shpronësim dhe krijimin e të drejtës së servitutit, na është dorëzuar e gjithë lënda dhe të dhënat e nevojshme, që të procedojmë më tutje për të bërë regjistrimin e të drejtës së servitutit në Zonat Kadastrale brenda territorit të Komunë së Malishevës. Kjo me qëllim që të krijohet një siguri me e madhe gjatë ndryshimeve me prona që mund të ndodhin në teren.

Sa i përket regjistrimeve të vendimeve të vjetra për ekspoprijim për zgjerimin e rrugëve regjionale, gjatë vitit 2023 e kemi paraqitur si objektiv por nuk kemi bërë shumë në këtë drejtim. Do të jetë një synim edhe në vitet e ardhshme por që është sfidë në vete duke marrë parasysh mungesën e dokumentacioneve.

Edhe gjatë vitit 2023 ka pasur shumë çështje që janë trajtuar nga Kuvendi Komunal e që kanë pasur të bëjnë me pronën e paluajtshme, kështu që vazhdimisht kemi qenë në dispozicion për të ofruar informacione, dokumente dhe sqarime për anëtarët e kuvendit për çështjet që janë trajtuar.

Identifikimi i rasteve që kanë të bëjnë me uzurpimet e pronës publike ka qenë njëri ndër prioritetet tona gjatë vitit të kaluar e që do të vazhdojë edhe në vitet tjera. Kjo ka qenë një sfidë mjaftë e madhe për ne, por në anën tjetër lirim i hapësirave publike ka rezultuar me realizmin me të mirë të projekteve komunale. Janë identifikuar shumë raste të uzurpimit të pronës publike, për të cilat është zhvilluar procedura administrative, janë nxjerra vendime dhe urdhëresa për ekzekutimin e vendimeve dhe lirin e hapësirave publike.

Bashkëpunimi në mes organeve komunale ka qenë në nivel të kënaqshëm, kemi shqyrtuar dhe realizuar shumë kërkesa që na kanë ardhur nga Zyra e Kryetarit, Avokati i komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Inspektoratit, Policia dhe Bashkësitë Lokale. Të gjitha këto në interes publik me qëllim të realizmit sa më të mirë të projekteve komunale.

Njëra ndër objektivat ka qenë edhe përkushtimi në shqyrtimin e kërkesave të ndryshme që kanë të bëjnë me regjistrimin e të drejtave në regjistra kadastral. Ka qenë një numër i madh i kërkesave që kanë të bëjnë me regjistrimin e kontratave të shitblerjes, dhurimit, këmbimit, regjistrimi dhe fshirjen e hipotekave, barrave tatimore, vendimeve gjyqësore, regjistrimin e ndarjeve dhe bashkimit të parcelave, servituteve si dhe kërkesa tjera të ndryshme që kanë të bëjnë me regjistrat kadastral.

Konsiderojmë që kemi arritur një nivel të kënaqshëm të përmbushjes së objektivave, duke shtuar këtu edhe punën e përditshme që kemi me palë në përpjeke që t'i japim sqarimet dhe informacionet e nevojshme që ata kërkojnë.

Sektorët e drejtorisë

Në kuadër të Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, puna dhe procedurat janë të shpërndara në tre sektor: sektori i gjeodezisë, sektori i kadastrës dhe sektori i pronës.

Spektori i Gjeodezisë - është sektori ku palët kanë mundësi që ta shohin gjendjen e pronave të tyre në pjesën hartë - grafike, të bëjnë kërkesa të ndryshme për ndarje, bashkim parcelash, matje të ndryshme, kërkesa për koordinata, korrigjime, barazime të pjesës grafike me pjesën tekstuale, pajisjen me kopje plani, etj. Po ashtu ky sektor realizon bashkëpunime me drejtori tjera aty ku paraqitet nevoja që të bëhen incizime dhe konstatime në terren.

Pasqyrimi i punëve dhe numrit të kërkesave të pranuar dhe shqyrtuara në sektorin e gjeodezisë:

Tabela Nr.1

Përiudha	Lloji i kërkesave									Totali për muaj
	Kopje plani	Koordinata	Historiate	Ndarje të ngastrave	Kërkesa fshati	Korrigjim sipas detyrave zyrtare	Përgjigje për kërkesa të ndryshme	Kërkesa zyrtare	Propozim për Urbanizëm	
Janar	4	25	2	0	0	0	0	1	14	46
Shkurt	10	16	0	0	0	4	0	3	7	40
Mars	11	25	1	0	2	3	6	0	12	60
Prill	13	14	5	0	0	3	1	0	9	45
Maj	6	9	1	2	0	3	1	0	5	27
Qershor	6	12	0	6	1	0	1	2	4	32
Korrik	28	26	2	0	1	0	3	0	5	65
Gusht	13	25	3	0	0	0	0	0	6	47
Shtator	23	12	0	0	3	2	2	0	7	49
Tetor	11	15	1	0	0	2	1	0	6	36
Nëntor	27	23	0	0	0	2	2	0	1	55
Dhjetor	10	14	0	0	0	0	1	1	3	29
Totali i kërkesave	162	216	15	8	7	19	18	7	79	531
Të hyrat €	1,332.00 €	3,889.00 €	140.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	5,361.00 €

Sektori i Kadastrit – ky sektor bënë pranimin e lëndëve të cilat kanë të bëjnë me regjistrime dhe ndryshime në regjistra kadastrale të cilat bëhen në bazë të akteve të ndryshme juridike, vendimeve gjyqësore, vendimeve administrative apo kontratave të ndryshme, regjistrimi i hipotekave, servituteve, objekteve, etj. Për secilin shërbim me udhëzime administrative dhe rregullore janë të parapara tarifat. Pasi zyrtarët e kadastrit pranojnë lëndën, e njëjta shqyrtohet nëse është e pakompletuar atëherë me shkrim njoftohet pala për plotësim lende dhe pas plotësimit merret vendimi për aprovim, për ndryshimet e nevojshme në regjistra.

Po ashtu ky sektor lëshon dokumente të ndryshme kadastrale si certifikata të pronës, certifikatë që nuk posedon pasuri të paluajtshme.

Tabela 2, Pasqyrimi i punëve të shërbimit të kadastrit

Në këtë tabelë është pasqyruar numri i kërkesave dhe i dokumentacioneve të lëshuar përgjatë këtij viti, siç janë: Fleta poseduese, Fleta poseduese për nevoja zyrtare, për raste sociale, Certifikata që nuk posedojnë pronë, Certifikata që nuk posedon pronë për raste sociale, si dhe të hyrat e realizuar nga këto shërbime.

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORIVE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS(Janar – Dhjetor 2023)

Muaji	Fleta poseduese		Fleta poseduese zyrtare		Fleta poseduese për rastet sociale		Certifikata që nuk posedon pronë		Certifikata që nuk posedon pronë-rastet sociale		Gjithsejt	
	Dok.	Të hyrat	Dok.	Të hyrat	Dok.	Të hyrat	Dok.	Të hyrat	Dok.	Të hyrat	Dok.	Të hyrat
Janar	27	108.00 €	13	0.00 €	0	0.00 €	5	15.00 €	82	0.00 €	127	123.00 €
Shkurt	43	172.00 €	36	0.00 €	1	0.00 €	9	27.00 €	74	0.00 €	163	199.00 €
Mars	83	332.00 €	40	0.00 €	2	0.00 €	11	33.00 €	100	0.00 €	236	365.00 €
Prill	65	260.00 €	33	0.00 €	0	0.00 €	6	18.00 €	70	0.00 €	174	278.00 €
Maj	68	272.00 €	57	0.00 €	0	0.00 €	6	18.00 €	70	0.00 €	201	290.00 €
Qershor	45	180.00 €	27	0.00 €	0	0.00 €	3	9.00 €	45	0.00 €	120	189.00 €
Korrik	60	240.00 €	11	0.00 €	0	0.00 €	10	30.00 €	28	0.00 €	109	270.00 €
Gusht	194	776.00 €	21	0.00 €	0	0.00 €	21	63.00 €	61	0.00 €	297	839.00 €
Shtator	77	308.00 €	60	0.00 €	0	0.00 €	17	51.00 €	78	0.00 €	232	359.00 €
Tetor	72	288.00 €	20	0.00 €	0	0.00 €	34	102.00 €	90	0.00 €	216	390.00 €
Nëntor	91	364.00 €	33	0.00 €	2	0.00 €	19	57.00 €	78	0.00 €	223	421.00 €
Dhjetor	51	204.00 €	14	0.00 €	1	0.00 €	7	21.00 €	112	0.00 €	185	225.00 €
Totali:	876	3,504.00 €	365	0.00 €	6	0.00 €	148	444.00 €	888	0.00 €	2283	3,948.00 €

Tabela 3, Numri i lëndëve dhe kërkesave sipas sistemit SIKTK

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri dhe lloji e lëndëve sipas Sistemit të Informacioneve Kadastrale të Pronës në Kosovë (SIKTK), që është në përdorim nga të gjitha Zyrat Kadastrale Komunale në nivel vendi.

RAPORTI VJETOR PËR LËNDËT NË SIKTK 2023					
			Lëndët e	Lëndët e	Lëndët e
Lloji i lëndës	Komuna	Total	Aprovuara	Refuzuara	Proceduara
Bartja e posedimit - Blerje	Malishevë	121	105	3	13
Bartja e posedimit - Dhurim	Malishevë	90	86	0	4
Bartja e posedimit - Këmbim	Malishevë	6	6	0	0
Bartja e posedimit - Shpronësim	Malishevë	2	2	0	0
Bartja e posedimit - Trashëgimi	Malishevë	38	36	0	2
Bartja e posedimit - Vërtetim pronësie	Malishevë	252	245	2	5
Bartje me Aktgjykim dhe fitime tjera të posedimit	Malishevë	74	68	4	2
Bartja e pronësisë - Vërtetim pronësie	Malishevë	5	5	0	0
Bartja e qiramarrjes te qiramarrësi i ri	Malishevë	2	2	0	0
Bashkimi	Malishevë	47	45	1	1
Bashkimi i personave të njëjtë me ID të ndryshme	Malishevë	50	50	0	0
Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit	Malishevë	51	45	3	3
Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK	Malishevë	4	4	0	0
Fshirja e vërejtjes me kërkesë të palës	Malishevë	1	1	0	0
Fshirja e vërejtjes me vendim të gjykatës	Malishevë	4	3	1	0
Modifikimi attributeve të parcelës	Malishevë	168	165	3	0
Modifikimi i attributeve të pjesës së ndërtesës	Malishevë	2	1	0	1
Modifikimi i hipotekës	Malishevë	3	1	0	2
Modifikimi i Servitutit	Malishevë	2	1	1	0
Modifikimi i të dhënave pa njësi kadastrale	Malishevë	49	42	6	1

Modifikimi i të drejtave	Malishevë	3	2	0	1
Ndarja	Malishevë	186	175	6	5
Regjistrimi (krijimi) i parcelës së re	Malishevë	2	0	0	2
Regjistrimi i hipotekës	Malishevë	38	37	1	0
Regjistrimi i ngarkesës tatimore	Malishevë	13	13	0	0
Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës	Malishevë	2	0	0	2
Regjistrimi i qiramarrjes	Malishevë	2	2	0	0
Regjistrimi i servitutit	Malishevë	2	1	1	0
Regjistrimi i së drejtës së shfrytëzimit	Malishevë	2	1	1	0
Regjistrimi i vërejtjes me kërkesë të palës	Malishevë	2	2	0	0
Regjistrimi i vërejtjes me vendim të gjykatës	Malishevë	1	1	0	0
Totali i të hyrave nga SIKTK: 107,547.99 €	TOTALI	1224	1147	33	44

Bazuar në të dhënat e paraqitura më lartë konstatohet që viti 2023 ka qenë një vit me mjaftë angazhime dhe me një vëllim të madh të punës. Si rezultat i këtyre angazhimeve nga të gjithë sektorët janë shqyrtuar një numër i madh i kërkesave si dhe janë realizuar të hyra të konsiderueshme.

Numri total i kërkesave dhe i të hyrave për vitin 2023:

- 4038** kërkesa të ndryshme, për pajisje më dokumentacion, Fletë Poseduese, Kopje Plani, Certifikata që nuk posedon pronë, kërkesa për regjistrime të ndryshme në sistemin kadastral, regjistrimi i kontratave për shitblerje, dhurim, regjistrime të hipoteka, e kërkesa të ndryshme të paraqitura në tabelat e mësipërme.
- 116,856.99 € (euro)**, të hyra të realizuara gjatë vitin 2023, si rezultat i numrit të madh të shërbimeve të ofruara nga kjo drejtori.

Me anë të tabelave grafike të mëposhtme kemi paraqitur një krahasim të punëve gjegjësisht kërkesave dhe të hyrave të realizuara ndër vite.

Tabela Nr.4





Tabela Nr.5 Krahassimi i të hyrave ndër vite

Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitu një krahasim të të hyrave në 8 vitet e fundit.



Sektori i Pronës

Sektori i pronës zhvillon procedura të ndryshme që kanë të bëjnë me uzurpime të pronës komunale, pranon kërkesa nga përfaqësues të fshatrave që kanë të bëjnë me hapjen e ndonjë rrugë nëpër prona private dhe regjistrimin e saj në kadastrë, përgatit dokumentacionin e nevojshëm për procedurën për këmbimin e pronës publike me pronë private sipas vendimeve administrative, përgatit lëndët për procedurë të shpronësimit, pranon kërkesa dhe jep kopje të lëndëve të vjetra të cilat janë të arkivuara në këtë sektor si dhe punë shtesë sipas nevojave dhe kërkesave edhe nga drejtori tjetër.

Shërbimi pronësorë – juridik ka filluar rilevimet e pronës publike nëpër shumë lokalitete, me theks të veçantë në qytetin e Malishevës, si dhe rilevime në lokacione të ndryshme sipas kërkesave dhe ankesave të palëve, dhe për këto lëndë janë iniciuar dhe zhvilluar mbi 100 procedura administrative për shqyrtimin e marrëdhënieve pronësore juridike të krijuara me uzurpim arbitrar të pronës shoqërore. Këto raste kryesisht kanë qenë të fokusuar në rrugët kryesore të qytetit të Malishevës, me qëllim që ta kemi një pasqyrë me të mirë për realizimin e projekteve kapitale dhe ruajtjes së hapësirave publike.

Në bashkëpunim me shërbimin e kadastrit dhe gjeodezisë është bërë regjistrimi në regjistra kadastral i Vendimeve Përfundimtare për shpronësim në Autostradën Gjurgjicë – Kijevë dhe Morinë – Merdare, në territorin e Komunës së Malishevës, përkatësisht në Zonat Kadastrale Kijevë, Mleqan, Llozicë, Balincë, Carrallukë, Shkarashnik, Tërpezë, Lladroc, Banjë, Bellanicë dhe Temeqinë.

Po ashtu kemi bërë regjistrimin e të drejtës së servitutit në pronat shërbyese të cilat preken nga linja 400 Kë, në interes të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSTT sh.a. ky regjistrim ka qenë shumë i nevojshme në mënyrë që të bëhet ruajtja dhe mirëmbajtja e kësaj linje si dhe krijimi i një sigurie me të madhe për qytetarët. Puna dhe angazhimi kryesor për këtë sektor, edhe sektorët tjerë të kësaj drejtorie si dhe departamentet tjera brenda administratës komunale ka qenë dhe mbetet ekzekutimi i vendimeve administrative për lirimin e hapësirave publike të cilat janë shumë të nevojshme për realizimin e projektit kryesor dhe shumë të rëndësishëm për transformimin e Malishevës në qytet me infrastrukturë moderne.

Mbetet sfida numri i vogël i punëtorëve në këtë sektor gjë që ndikon shumë në mbarëvajtjen e punëve dhe zhvillimin efikas të procedurave si dhe mos reformimi i infrastrukturës ligjore që ka të bëjë me trajtimin e uzurpimeve dhe mbrojtjen e pronës komunale e publike.

Këto janë aktivitetet dhe punët e realizuara gjatë kësaj periudhe.

Mbesim të përkushtuar në rritjen e efikasitetit në punë dhe ofrimin e shërbimeve në afatin optimal kohor.

DREJTORIA E INSPEKTORATIT

Drejtoria e Inspektoratit gjatë këtyre muajve ka bërë inspektimin e terrenit në përgjithësi të të gjithë sektorët. Gjatë këtyre muajve jemi angazhuar maksimalisht që detyrat tona t'i përfundojmë me përpikëri.

Kemi bërë planifikimin e punëve për drejtori për vitin 2023, kemi bërë vlerësimin e punëtorëve për vitin 2022, kemi bërë Raportin e punës për drejtori për vitin 2022 dhe të gjitha këto i kemi dorëzuar te kryetari.

Është bërë ndalimi i punimeve në gërmim të një objekti në rrugën “Adem Jashari” në Carrallukë, si dhe në bashkëpunim me Policinë e Malishevës është bërë ndalimin e një tjetër ndërtimi me rastin e rifillimit të ndërtimit në rrugën “Imer Krasniqi” njëkohësisht janë bërë edhe vendosja e shiritave në objekt.

Vendimi i Kuvendit Komunal për ndalimin e sektorit të gastronomisë që të shërbejnë me shishe kemi filluar të bëjmë zbatimin e tij dhe me këtë rast herë pas here kemi inspektuar disa subjekte të gastronomisë dhe aty ku kemi hasur që këto subjekte janë duke ju shërbyer klientëve kemi shqiptuar gjoba mandatore, vlen të ceket se gjatë kësaj kohe të raportimit kemi shqiptuar shumë gjoba mandatore për disa subjekte afariste për mos respektim të këtij vendimi. Kemi lëshuar pëlqime për licencim për kushte minimale teknike për ushtrimin e veprimtarisë afariste për disa subjekte afariste.

Kemi përcjellë për në Drejtorinë e Urbanizmit shkresë lidhur me një ankesë-peticion të lagjes Mekaj- Malishevë lidhur me ndalimin e ndërtimeve të larta në këtë lagje të cilat pretendojnë se do të bëhen.

Kemi bërë inspektimin e furrave të bukës, inspektimi ka qenë me theks të veçantë për deklaracionin e peshës së bukës si dhe përputhshmëria e çmimit me deklaracion të peshës së bukës.

Shqyrtimin e kërkesave në Mleqan për ujëra atmosferik si dhe Terpezë të ulet, për dëmtim të disa pronave nga uji i autostradës.

Është bërë kallëzim penal në Prokurorin Themelore Gjakovë për rifillimin e ndërtimit të objektit në rrugën “Imer Krasniqi” pasi që këtë ndërtim e kemi ndaluar disa vite me herët.

Në bashkëpunim me Policinë dhe zyrtarët e gjeodezisë kemi bërë shenjëzimin e trasesë së rrugës “Ibrahim Mazreku” përkatësisht shenjëzimin e pronës publike me atë private.

Pas njoftimit të Policisë për një rast në fshatin Bubël, për arsye se një qen sipas deklaratës së ankuesit është qen endacak i racës Pitbull ka bërë rrezikimin e familjes, në bashkëpunim me Policinë dhe shoqatën e gjuetarëve kemi bërë eliminimin e tij pasi që konstatimi i veterinarit është se qeni është i tërbuar dhe paraqet rrezik edhe për banoret e tjerë të fshatit, i njëjti rast ka ndodhur edhe në një familje në fshatin Lubizhd dhe është vepruar njëjtë me eliminimin e qenit.

Në bashkëpunim me Policinë e Malishevës kemi inspektuar sektorin e gastronomisë për respektimin e vendimit të kuvendit komunal për ndalimin e përdorimit të shisheve për klient, me këtë rast kemi hasur në subjekte afariste duke ju shërbyer klientëve me shishe, ne kemi bërë ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarisë si dhe njëkohësisht kemi bërë edhe vendosjen e shiritave.

Pas ankesave kemi inspektuar në fshatin Kijevë dhe me këtë rast është shqiptuar gjobë mandatore për hedhje të mbeturinave komunale në pronë publike në vlerë prej (200 €) si dhe dy gjoba tjera në Malishevë për hedhje të mbeturinave në prona publike.

Kemi pasur takime zyrtare me Policinë e Malishevës, me Inspektorët e Ndërtimit të MMPHI.

Me rastin e inspektimit në Ujëvarat e Mirushës kemi vërejtur se në hyrje të Ujëvarës së Mirushës përkatësisht afër pellgut kryesor të Ujëvarave në anën e djathtë ka rrëshqitje-shkëputje të mëdha të gurëve nga bregu lart, pasi që ka ende gur të mëdhenj të shkëputur nga bregu, mirëpo nuk kanë ra poshtë, kemi konsideruar se kjo paraqet rrezikshmëri të madhe për kalimtarët apo vizitorët, që këta gur të bien poshtë nga bregu. Si masë urgjente ne kemi bërë mbylljen e kësaj hapësirë me vendosjen e shiritave, kemi përpiluar edhe procesverbal nr. 10/03/2023 datë 03/03/2023, si dhe njëkohësisht përmes e-mailit kemi dërguar kërkesë që urgjentisht nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim të inspektojnë terrenin dhe të marrin masat e mëtutjeshme për parandalimin e ndonjë fatkeqësie.

Me datën 03/03/2023, pasi janë përfunduar të gjitha procedurat administrative, në bashkëpunim Policinë e Kosovës, zyrtarë të drejtorisë së Gjeodezisë, me kompaninë kontraktuese për ndërtimin e rrugës “Ibrahim Mazreku”, me kompaninë e kontraktuar për rrënim, kemi filluar nga ura e madhe të bëjmë lirimin e hapësirës publike.

Herë pas here së bashku me Policinë kemi bërë njoftime - vërejtje me gojë pronarëve të disa objekteve për filmimin e lirit të hapësirave publike nga vetë ata, e që në përgjithësi kanë filluar vetë të bëjnë lirimin e këtyre hapësirave duke bërë rrënimin e pjesëve të objekteve që janë në hapësirat publike.

Asistimi - mbikëqyrja e punëve të procesit të lirit të hapësirave publike nga ana jonë ka qenë e përhershme si gjatë ditëve të rregullta të punës ashtu edhe gjatë ditëve të vikendit.

Nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Prishtinë jemi njoftuar se në treg janë duke u shitur katër lloje të produkteve (disqe për prerje metali, aparat për ngrohje uji) e që paraqesin rrezikshmëri, seritë e prodhimit të atyre produkteve, ne menjëherë kemi dal në inspektim nëpër të gjitha subjektet afariste të cilat merren me shitjen e këtyre produkteve, ne kemi hasur në numër të vogël të tyre, kemi bërë largimin e këtyre produkteve nga tregu deri në një vendim tjetër nga MINT.

Kemi pranuar tri shkresa nga Policia e Malishevës:

1. Për informata shitesë për një subjekt afarist në Terpezë të Ulët, me këtë rast kemi inspektuar këtë subjekt dhe kemi dërguar informata shitesë për Policinë e Malishevës.
2. Për rrezikshmërinë në rrugën Imer Krasniqi, pasi në tri vende del ujë në rrugë, ne kemi inspektuar këtë lokacion dhe kemi bërë shkresë për Drejtorinë e Urbanizmit.
3. Si dhe për përdorimin e shisheve nga dy subjekteve afariste, me këtë rast kemi shqiptuar për dy subjektet afariste gjoba mandatore (një subjekti afarist gjobë 500 € dhe një tjetri 1000 €)

Pas dëmtimit të një ure të vogël në lagjen Hazrolli-Banjë kemi inspektuar dhe kemi bërë rekomandim për ndërhyrje për rregullimin e dëmtimit të kësaj ure nga Drejtoria e Urbanizmit.

Pas marrjes së shkresës nga Policia e Gjakovës për informata shtesë lidhur me piktetimin e një objekti banesor të ndërtuar, ne kemi kthyer përgjigje me informatat shtesë lidhur me objektin banesor.

Pas njoftimit-kërkesës nga Policia e Malishevës kemi inspektuar-asistuar në një fshat të komunës sonë, në një familje Policia me urdhër të gjykatës gjatë bastisjes përveç substancave narkotike kanë hasur edhe në disa lloje të mallrave të ndryshme (kozmetik në sasi më të mëdha), ne në bashkëpunim me Policinë kemi bërë bllokimin e përkohshëm të atyre mallrave deri në verifikimin e prejardhjes si dhe deklaracionit të mallrave, përgjegjësinë e këtij malli-produkti e ka marrë një subjekt afarist.

Pas konsultave edhe me Inspektoratin e MINT-Prishtinës dhe prezantimit të dokumentacionit të mallit të bllokuar nga personi përgjegjës i kompanisë përsëri me Policinë kemi shkuar në vendngjarje dhe personit përgjegjës ju është lejuar malli me rekomandim që sasia eventuale e dëmtuar dhe e padëmtuar pasi që është e periudhës 2015/16, e tërhequr nga tregu për shitje kur të behet asgjësimi i mallit të lajmërojnë ATK për procedurë të mëtejme. Me rastin e mos pagimit të disa gjobave mandatore nga disa subjekte afariste të cilat i kemi shqiptuar më herët dhe kalimit të afatit ligjor kohor për pagesë të tyre ne kemi iniciuar procedurë përmbartimore të përmbartuesi privat .

Kemi bërë kontrollimin e të gjitha marketeve, ku me theks të veçantë ka qenë kontrollimi mallrave për afat të skadencës të mallrave, pastaj përputhshmëria e çmimit të mallit raft-arkë, ndarja e produkteve me prejardhje shtazore dhe atyre të bimëve, higjiena në përgjithësi.

Me rastin e inspektimeve të marketeve kemi pasur rastë që kemi hasur në mallra të ndryshëm ushqimor me afat të skaduar ku ne kemi bërë konfiskimin e me pastaj asgjësimin e mallit si dhe kemi shqiptuar gjobë mandatore për subjekt afarist dhe personit përgjegjës (ky inspektim është bërë 4 herë gjatë vitit)

Jemi marrë intensivisht me reklamimin (shitjen e mallit) e mallit jashtë vendit të caktuar si dhe me tavolinat që gjenden jashtë lokaleve, ju kemi dhënë urdhëresë për mos reklamim të mallit si dhe ato lokale që dëshirojnë dhe nuk e pengojnë hapësirën e këmbësorëve të pajisën me leje për shfrytëzim të këtyre tavolinave edhe jashtë lokalit në veçanti të veçantë në rrugën “Ibrahim Mazreku”.

Pas marrjes së shkresës nga MINT-Prishtinës për kontrolle të subjekteve afariste për ekspozimin e cigareve elektronike në vende të dukshme, ne kemi dalë nëpër të gjitha subjektet afariste, të cilat merren edhe me shitjen e cigareve elektronike. Gjatë inspektimit në ato vende që kemi hasur në cigare elektronike në vende të dukshme kemi dhënë urdhëresë që këto produkte të mos jenë të dukshme-ekspozuara në asnjë vend të shitjes dhe nuk duhet të jenë të shfaqura për qëllime komerciale, shitjen ta bëjnë pa ekspozime të këtyre produkteve.

Pas njoftimit nga Policia e Malishevës për disa mbeturina medicinale të hedhura në rrugën transite Banjë-Carrallukë, ne kemi inspektuar terrenin dhe njëkohësisht në bashkëpunim me Inspektoratin Shëndetësor dhe atyre të mjedisit të MMPHI, kompaninë e licencuar për përpunimin e mbeturinave medicinale kemi bërë largimin e këtyre mbeturinave.

Janë inspektuar ndërtimet në përgjithësi, në theks të veçantë ndërtimet e larta për të verifikuar a po ju përmbahen kushteve të ndërtimit si dhe janë dhënë urdhëresa për piketimin e këtyre objekteve të ndërtimit të cilat fillojnë apo edhe kanë filluar së ndërtuari.

- Pas njoftimit të Policisë për hedhje të disa mbeturinave nga një banor i fshatit Llozic, ne kemi inspektuar këtë lokacion dhe kemi shqiptuar gjobë mandatore (70 €).
- Pas ankesës të bërë nga një subjekt afarist se në lokalit të tij ka hyr ujë, kemi inspektuar së bashku me zyrtarë të drejtorisë së emergjencave dhe kemi vërtetuar se uji ka hyr në lokal nga rruga “Pavarësia” pas reshjeve të mëdha të shiut dhe ka shkakuar disa dëme në lokal (në punime të veshjeve-fustane).
- Pas kontrollit të Doganave të Kosovës në një restorant, aty kanë hasur që personi përgjegjës i këtij restoranti është duke shërbyer me shishe-llulla klientëve, ata kanë lajmëruar Policinë e Kosovës dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës pastaj ne kemi bërë mbylljen e restorantit duke ja vendosur shiritat.
- Kemi pas inspektim nga Inspektorët e Ujërave të MMPHI-Prishtinë lidhur me shqyrtimin e një ankese anonime për ndërtimin e urës së madhe në Malishevë, dhe në bashkëpunim me ne është inspektuar vend punishtja.
- Kemi shqiptuar gjobë mandatore (200 €) për një subjekt afarist për arsye se ka djeg mbeturinat e mbetura pas përfundimit të punës .
- Pas rifillimit të punimeve të një ndërtimi të cilin ndërtim e kemi ndaluar më herët në lagjen Mirëdita ne kemi dërguar lenden për Kallëzim Penal (për heqje të shiritit dhe rifillim të ndërtimit) dhe njëkohësisht kemi bërë përsëri ndërprerjen e punimeve me vendosje të shiritave
- Pas disa ankesave të banorëve që janë në afërsi të një subjekti afarist e cila ankesë është për ndotje akustike që bëjnë (aparaturat) me rastin e ftohjes së objektit, ne kemi urdhëruar personin përgjegjës të këtij subjekti të bëjnë matjen zyrtare të zhurmës (ndotjen akustike) të cilën e bën ky subjekt, si dhe njëkohësisht të merr masa për eliminimin e zhurmës, e që për shkak të mosrespektimit të urdhërësës sonë është shqiptuar gjobë mandatore (500 €), më pastaj subjekti afarist ka bërë eliminimin e zhurmës .Inspektim në këtë subjekt afarist kemi bërë edhe me Inspektorët nga MMPHI-Prishtinë.
- Me rastin e mbajtjes së festivalit “Oda e Llapushes” kemi asistuar me Policinë dhe Drejtorinë e Kulturës lidhur me mirëvajtjen e përgjithshme të festivalit.
- Po ashtu asistime dhe mbikëqyrje kemi bërë edhe me rastin e mbajtjes së festivalit “Mal Fest”
- Në bashkëpunim me Policinë e Malishevës kemi inspektuar një lokacion në Balincë për arsye se kemi informata se nga dikush ende i panjohur herë pas here është duke hequr dheun në afërsi të rrugës kryesore, në momentin e inspektimit nuk kemi hasur në punime por kërkesa është që edhe policia nëse hasin duke punuar të na njoftojnë.
- Me rastin e fillimit të ndërtimit të një objekti banesor në rrugën “Hamdi Berisha” përkatësisht në momentin e inspektimit kemi hasur duke bërë heqjen e dheut dhe mbushje me zhavorr ne kemi urdhëruar të ndërpriten

punimet, personi përgjegjës nuk ka bërë ndërprerjen e punimeve dhe ka vazhduar me punime përkatësisht ka bërë vendosjen e betonit të ashtuquajtur të vdekur të objektit në bashkëpunim me Policinë kemi bërë ndërprerjen e mëtutjeshme të punimeve duke ja vendosur edhe shiritat mbrojtës-mbyllës, njëkohësisht kemi dërguar lenden për Procedurë Penale-Kalxim penal të Prokuroria e Gjakovës, për veprën penale fillim të Ndërtimit Pa Leje Ndërtimore.

- Me rastin e inspektimit në dy restoranteve kemi hasur që personat përgjegjës të tyre janë duke ju shërbyer klientëve me shishe në bashkëpunim me Policinë kemi bërë mbylljen e veprimtarisë afariste duke ju vendosur shirita mbyllës.
- Pas lajmërimit të Policisë rreth një ankese të një qytetari për një ordinancë stomatologjike, ne kemi bërë inspektimin dhe kemi vërtetuar se ordinanca ka Licencë pune nga Ministria e Shëndetësisë, mirëpo personi përgjegjës i kësaj ordinance pas marrjes së Licences në MSH ka bërë vetëm shuarjen vullnetare të biznesit, e jo edhe të licencës së lëshuar nga MSH. ,ne kemi bërë mbylljen e kësaj ordinance (shirita nuk kemi vendosur sepse aty janë duke u bërë hetime dhe ekzaminime të ndryshme nga Policia).
- Herë pas here është inspektuar në rrugën “Ibrahim Mazreku” për mirëvajtjen e përgjithshme të subjekteve afariste si dhe tregtarëve ambulator të cilët kanë pëlqime për zhvillimin e veprimtarisë në këtë rrugë. Ky inspektim është bërë gjatë orarit të punës si dhe gjatë mbrëmjes, dhe arsye kryesore e këtyre inspektimeve të shumta ka qenë pasi që në muajin korrik dhe gusht kjo rrugë ka qenë e mbyllur për automjete 20:00-24:00 dhe është përdorur shëtitore dhe me këtë rast ka pasur fluks të madh të vizitorëve-qytetarëve
- Me rastin e inspektimit në sektorin e komunikacionit kemi inspektuar kompani transportuese, autotaksit si dhe kombitaxit për mos lehtësimin e kombitaxive që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre lehtë si dhe kompanitë transportuese për respektim të vijave të lejuara urbane si dhe të mos punojnë pa vija urbane komunale , me këtë rast kemi hasur në një k-taxi pa leje të vijave urbane dhe i kemi shqiptuar gjobë mandatore
- Me rastin e inspektimit të terrenit për mbrojtjen e ambientit kemi hasur një qytetar duke hedhur mbeturina të ndryshme në pronën publike dhe me këtë rast i kemi tërhequr vërejtjen dhe gjithashtu kemi shqiptuar gjobë mandatore .
- Po ashtu me rastin e djegies së mbeturinave në një lokacion në Malishevë, për personin përgjegjës që ka bërë djegien e mbeturinave i kemi shqiptuar gjobë mandatore
- Në rrugën “Imer Krasniqi” gjatë vikendit duke inspektuar kemi hasur duke bërë ndërtimin e një muri në pronën komunale përkatësisht në afërsi të rrugës, me këtë rast kemi urdhëruar që murin e vendosur në pronë publike ta rrënojnë në mënyrë vullnetare dhe personi përgjegjës ka zbatuar urdhëresën tonë dhe ka bërë rrënimin-heqjen e murit vullnetarisht aty për aty në pronën publike.
- Pas njoftimit të Policisë me datë 13 tetor rreth orës 17:00, se kemi disa raste të helmimit të disa qytetarëve nga një restorant (fast food), ne menjëherë kemi dalë në vendngjarje dhe njëkohësisht kemi njoftuar Inspektoratin Regjional të AUV-Prizren. Paraprakisht kemi bërë në mënyrë të përgjithësuar monitorimin e rasteve të të helmuarve në QKMF.
- Në koordinim me Inspektorët e AUV, Policinë kemi inspektuar restorantin dhe njëkohësisht kemi bërë ndalimin e veprimtarisë afariste, dhe në ndërkohë inspektorët e AUV kanë marrë mostrat në restorant (të mishit, sosit, sallatës e disa produkteve tjera) dhe i kemi vendosur në frigorifer për ruajtje dhe frigoriferit je kemi vendosur shiritin mbrojtës, si dhe kemi bërë mbylljen e lokalit me shirita mbyllës.
- Të nesërmen në bashkëpunim me Inspektorët e AUV, Institutin e shëndetit publik, Prokurorinë, Policinë, kemi marrë mostrat e ushqimit për analizë , si dhe janë marrë 25 strisho për analizë të mëtutjeshme. Me këtë rast janë konfiskuar dhe njëkohësisht janë asgjësuar sasia prej 64 kg mish i bluar i cili ky produkt ka qenë duke u ruajtur në kushte jo të mira, mishi është asgjësuar aty për aty duke e hedhur në kamionin e kompanisë për mbeturina.

- Duke marr parasysh se dyshimet e helmimit të ndodhur janë nga restorante që përgatitin ushqime të shpejta (fast food) ne në koordinim-bashkëpunim me Inspektoret e AUV kemi bërë inspektime të jashtëzakonshme të këtyre restoranteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tërë territorin e Malishevës dhe me këtë rast kemi bërë ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së tyre në 5 subjekte (restorante) kryesisht në këto restorante kemi dhënë urdhëresë që urgjentisht të bëjnë DDD e hapësirave të lokalit si dhe stafi të pajiset me librezë sanitare, ta mbajnë higjienën e përgjithshme të objektit.
- Pastaj kemi vazhduar me inspektimet në të gjitha restorantet tjera në Malishevë si dhe jashtë qytetit të Malishevës
- Pas ankesave të banorëve të fshatit Balincë ne kemi dalë në vendngjarje dhe kemi të vërtetuar se në disa vende muret anësore të nënkalimit në Balincë janë plasaritur. Me këtë rast kemi bërë disa foto dhe kemi dërguar e-mail për inspektoratin e MMPHI-Prishtinë për rastin në përgjithësi dhe kemi kërkuar që të dalin në teren për marrjen e masave të mëtejshme të nevojshme.
- Pas shkresës së Policisë rreth një ankese të një qytetari ne kemi marrë informatat e mëtejshme për subjektin afarist që është ankuar qytetari dhe njëkohësisht kemi dërguar informatat shtese për subjektin afarist policisë si dhe kemi dërguar e-mail inspektoratit regional të punës në Prizren.
- Me rastin e shpalljes së vijave të lira urbane për komunën e Malishevës ne kemi lëshuar vërtetime për kompanitë transportuese për mbajtjen e vijave urbane.
- Pas kërkesës nga Drejtoria e Arsimit për ndalimin e shetitjes për nxënësit e shkollës së mesme për në Brezovicë që kanë parapa nxënësit pa organizim ligjor, ne me datë 16/12/2023 (shtunë) kemi dalë në teren dhe në bashkëpunim me Policinë kemi vërtetuar se disa kompani transportuese në bashkëpunim me nxënësit kanë bërë organizimin për shetitje për në Brezovicë, dhe me këtë rast kemi bërë ndalimin e kësaj shetitjeje e cila ka qenë pa organizim nga institucionet kompetente që parashihen me udhëzime administrative.
- Me rastin e festave të fund vitit kemi bërë inspektimin e terrenit për parandalimin shitjes së mjeteve piroteknike në hapësira jo të destinuara, si dhe nga persona të mitur.
- Kemi bërë shpërndarjen e Aktvendimeve të Taksës Komunale për subjektet afariste, si dhe shpërndarjen e Vërejtjeve për subjektet afariste të cilat subjekte nuk e kanë paguar taksën komunale për vitet e mëhershme.
- Kemi dërguar disa Kallëzime Penale për personat të cilët kanë filluar punimet në ndërtim Pa Leje Ndërtimore
- Kemi dërguar disa lëndë të përmbaruesi privat për shkak të mos pagesave të gjobave mandatore nga persona përgjegjës të subjekteve afariste
- Është bërë orari i kujdestarisë gjatë gjithë vitit përkatësisht për çdo tre muaj me ndryshime të herë pas herë për barnatoret e qytetit të Malishevës.
- Zyrtar të drejtorisë tonë kanë marrë pjesë në komisione për hartimin dhe ndryshimin e rregulloreve të ndryshme komunale si dhe në komisionin për Transparencë Komunale.
- Janë inspektuar 33 objekte me Leje Ndërtimore të reja të filluara në këtë vit.
- Janë inspektuar 26 objekte të pajisura me Leje Mjedisore Komunale se a po zbatohen-respektohen masat mbrojtëse mjedisore të cekura në raportin mjedisor e që janë respektuar masat mbrojtëse të cekura në raport mjedisor.

- Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Drejtoria e Inspektoratit ka bërë, gjithsej ;
- ❖ 556 Procesverbale;
- ❖ Të hyra të përgjithshme nga Drejtoria 13.359 €
- ❖ 55 Aktvendime, Pëlqime, Vërtetime;
- ❖ 152 Shqyrtime të kërkesave-ankesave të natyrave të ndryshme;
- ❖ 32 Gjoba mandatore ;
- ❖ 3 Kërkesa, Kallëzime penale në Prokurori;
- ❖ 16 Lëndë të përmbareshi privat;
- ❖ 18 Shkresa-Kërkesa policisë;

DREJTORIA E SHËNDETSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

DREJTORI I DREJTORISË- aktivitete gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023

Fillimi i vitit 2023 mund të konsiderohet një fillim i ri, i qetë sa i përket gjendjes së pandemisë me COVID-19, në territorin e Komunës së Malishevës, por edhe më gjerë.

Objektivat dhe qëllimet që ishin përcaktuar në fund të vitit 2022 për vitin 2023 kanë filluar të finalizohen përgjatë këtij viti dhe me të drejtë në këtë vit mund ta quajmë: **vit i sfidave dhe vit i realizimit të projekteve më të mëdha, që deri më tani mund të arrihen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë.**

Është i njohur fakti se institucionet shëndetësore funksionojnë atëherë kur janë të fuqizuara tri shtylla të forta:

- I. Staf të mjaftueshëm profesional për jetësimin e konceptit të Mjekësisë Familjare,
- II. Infrastrukturë të përshtatshme, kushte të punës për staf dhe pacientë,
- III. Pajisje të sofistikuara-bashkëkohore, material sanitar, administrativ dhe higjienik të mjaftueshëm si dhe të realizuar në kohë.

Nisur nga shtylla e parë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë kemi pasur mbështetje nga MSH për shtimin e personelit profesional, ku dhe kemi hapur konkurse për 20 infermierë dhe 9 mjekë. Ndërsa nga Komuna e Malishevës, shfrytëzoj rastin ta falënderoj qeverinë komunale, e cila na ka dalë në ndihmë me projektin SHËRBIMET SHTËPIAKE, të cilin e ka realizuar dhe punëtorët nga gushti i vitit 2022 kanë filluar punën dhe ende vazhdojnë.

Mbështetur në këto kapacitete, institucioni ynë shëndetësor ka arritur të realizojë shërbime në shumicën e shtëpive ku është paraqitur nevoja, duke bërë mjekim, referim dhe kujdes gjatë referimit. Pasi që në këtë dymbëdhjetë muaj të vitit 2023 nuk kemi pasur mungesë të theksuar me staf me përjashtim të Mjekëve Familjarë, atëherë angazhimi ynë si menaxhment ishte të sigurojmë kushte për të ofruar shërbime mjekësore si: aparatura, material sanitar, material higjienik dhe masa mbrojtëse, të cilat janë të domosdoshme për punë.

Planifikimi

Angazhimi i stafit menaxherial në QKMF Malishevë, gjatë vitit 2023 është fokusuar në vlerësim të nevojave të institucionit, inicimin e kërkesave, ndërsa mbështetja nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Kuvendit Komunal, ka bërë të mundur realizimin dhe finalizimin e disa prej kërkesave tona.

Investimet kapitale të cilat janë paraparë për t'i realizuar gjatë këtij viti sipas kërkesave tona janë realizuar shumica prej tyre.

Aparaturat dhe materialin tjetër medicinal, do t'i prezantojmë në formë të tabelave, duke përshkruar me detaje vendin dhe llojin e investimeve, llojin e aparaturave dhe materialin tjetër shpenzues. Të gjitha këto investime në institucionin ton janë të prekshme dhe në shërbim të qytetarëve, ku çdo ditë po rrisim cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe rrjedhimisht po rritet kënaqësia e pacientëve të komunës sonë dhe pacientëve të komunave tjera për rreth, të cilët marrin shërbim në qendrën tonë.

Problem kryesor në QKMF Malishevë tani për tani është mungesa e stafit profesional (mjekëve), gjë për të cilën kemi pasur vështirësi dhe mbingarkesë të mjekëve me orë shtesë në QKMF, QMF dhe në vizitat shtëpiake.

Furnizimi me medikamente nga lista e barnave esenciale nga Ministria e Shëndetësisë gjatë këtij viti ka qenë jo e kënaqshme.

Gjate vitit 2024 pritet të pensionohen disa punëtorë të profileve të ndryshme që janë të sistemuar në shërbime të ndryshme në QKMF, QMF, ne kërkojmë që zëvendësimet me punëtorë të rinj të bëhen sipas vendeve që lirohen. Krejt kjo duhet të bëhet në mënyrë që të vazhdojë puna normale në shërbimet ku punëtorët pensionohen dhe ne të vazhdojmë drejtë standardeve të reja

Aktivitetet e Drejtorit të QKMF-së

Janë mbajtur ligjëratat vetëdijesuese për parandalimin dhe mbrojtjen nga ethet hemorragjike në çdo shkollë të komunës së Malishevës.

Takimet koordinuese me Drejtorin e DSHMS-së.

Takimet dhe kontaktet e rregullta me MSH, IKSHIP dhe IRSHP.

Mbledhjet e rregullta çdo dy javë me Shefat e shërbimeve, për organizimin e punës në shërbime, vërejtje, sugjerime dhe detyra.

Takimet e rregullta ditore me Koordinatorin e cilësisë për mbarëvajtjen e punës, vërejtjet, sugjerimet dhe raportet për gjendjen e cilësisë së shërbimeve.

Takimet e rregullta ditore me Kryeinfermierin për koordinim dhe mbarëvajtje të procesit të punës.

Organizimi i ligjëratave për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të stafit.

Trajnimet e rregullta të stafit të organizuara nga MSH, OJQ-të dhe shoqatat profesionale.

Takimet e rregullta me donatorë dhe grupet e tjera të interesit.

Mbledhja e mbajtur me staf mbi detyrat dhe obligimet e tyre.

Takime të rregullta me komisionin për shqyrtimin e ankesave.

Formimi i komisioneve të veçanta për pranimin e materialit dhe të aparaturës.

Vizita në QKMF-të e tjera për informimin dhe njoftimin me modelet e implementimit të SISH-it.

Vizita në QMF-të në Kijevë dhe Bellanicë me qëllim të ofrimit të bashkëpunimit dhe furnizimit me material të nevojshëm për punë, si dhe mbështetje të vazhdueshme.

Takime ditore me Shefat e shërbimeve.

Takime ditore me punëtorët shëndetësorë dhe dhënia e mundësisë secilit prej tyre për t'i shprehur idetë dhe kërkesat e tyre.

Mbështetje dhe inkurajim për secilin që ka paqartësi në detyrat e tyre.

Takim të rregullta me Komandantin e policisë z Azem Krasniqi për të konfirmuar bashkëpunimin ndërinstitutional.

Takime me përfaqësuesit e KFOR-it LMT-në, në kuadër të bashkëpunimit dhe informimit me aktivitetet e shëndetësisë në Malishevë.

Takimet me përfaqësuesit e Bashkësisë Islame në Malishevë.

SHËRBI MET NË QKMF, QMF, AMF NË DYMBËDHJETË MUJORIN E VITIT- 2023

Puna e stafit në të gjitha institucionet tona përbën një kapitull të rëndësishëm në këtë raport si: Gjinekologji, Interno, Pediatri, Stomatologji, Laborator, RTG, ECHO, Vaksinin, Kartotekë, Barnatore, Depo, Mjekësi Familjare, Urgjencë, Vizita nënave shtatzëne dhe fëmijëve deri në moshën 3 vjeçarë. Vizita në familje dhe përkujdesje të drejtpërdrejtë me pacientë të mjekimit paliativ. Stafi i administratës, stafi i autoparkut, higjienëmbajtës dhe staf i mirëmbajtës, të gjithë kanë kontribuar në forma të ndryshme në ndihmë të pacientëve, përkundër punës dhe detyrave të tyre të zakonshme.

Më pas do të paraqesim raportin e punës për të gjitha shërbimet për dymbëdhjetë mujorin e vitit 2023, ku nga të gjitha institucionet tona gjatë kësaj periudhe janë ofruar: **262049** vizita dhe shërbime mjekësore.

Vizitat dhe shërbimet në institucionin tonë për vitit- 2023 janë si vijon :

Raporti tremujor	TM1	TM2	TM3	TM4	Gjithsej shërbime
Gjinekologjia	2329	2074	2317	2216	8936
Interno	2034	831	957	1298	5120
Stomatologj	1378	1107	1333	1109	4927
Ultrazë	1079	1050	915	1097	4131
Laboratori	4430	3982	4409	4362	17183
Pediatri	4344	3237	4381	3865	15827
Vaksinim anti Covid	0	0	0	0	0
Vaksinim i rregullt	4822	1938	1701	3313	11774
Mjekësia Familjare	17113	13440	14546	13780	58879
Intervencat	11400	8818	9037	9751	39006
Infuzione	8998	5985	8338	6645	29966
Urgjenca	7564	6919	9759	7696	31938
Lidhtorja	1635	1572	2096	643	6942
RTG	1615	1351	1465	1499	5930
Testime per Covid-19	0	0	0	0	0
QMF Kijevë	MF.3561	MF.2593	MF.3448	MF.2859	12461
	Pediatria.709	Pediatria.555	Pediatria.863	Pediatria.758	2885
	Stom. 217	Stom.192	Stom.140	Stom.217	761
	sher inf .4996	Sher.inf.3371	Sher.inf.4666	Sher.inf. 4134	193567
QMF Bellanicë	567	543	705	633	2448
AMF Llazicë	0	115	177	192	484
QMF Drenoc	532	327	169	345	1373
QMF Panorc	319	294	64	547	1225
AMF Llapqevë	17	0	0	0	17
AMF Lubizhdë	0	0	0	0	0

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORIVE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS (Janar – Dhjetor 2023)

AMF Dragobil	15	55	66	53	226
QMFPagarushë	159	89	140	140	528
AMF Kravasari	247	181	103	177	708
Carrallukë	111	146	140	127	524
Terpezë	49	33	21	28	131
Berishë	0	0	0	0	0
Vizita shtëpiake	614	965	1033	2174	4786
Pickime nga rriqrat	7	628	237	11	884
Participimi	€.14855	€.11071	€.15673	€.13634	€.55233
Gjithësej	82294	60809	73226	69669	285998

Shërbime të ofruara për dymbdhjet mujorin e vitit 2023 janë gjithsej: 285998

Kërkesat:

Janë bërë kërkesat për nevojat e QKMF-së drejtuar DSHMS-së sipas planifikimeve për:

- Investime kapitale
- Furnizim me material dhe aparatura
- Rekrutim të stafit

RAPORT I ANALIZAVE TË LLOGARIVE PËR VITIN FISKAL 2023-PERIUDHA FISKALE JANAR-DHJETOR 2023

Buxheti për vitin 2023 është 2,495.711 €

- Pagat dhe Mëditjet ----- 1,160,951.67 €
- Mallra dhe Shërbime- -----762,945.33 €
- Investime Kapitale-----401,814.00 €
- Shpenzimet Komunale-----170,000.00 €

Shpenzimet për Paga dhe Mëditje për vitin 2023 -për periudhën Janar-Dhjetor- janë në vlerë prej-**1.160.951,67**
Në kategorinë Mallra dhe Shërbime shuma e shpenzuar për vitin 2023 ka qenë -**762.945,33**. Sipas raportit të shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Nga kjo kategori e shpenzimeve për nevojat e QKMF-së dhe nevojat tjera janë bërë pagesa për: shërbime kontraktuese,shërbime shëndetësore, furnizime mjekësore, mirëmbajtjen e automjeteve, karburante për vetura, furnizime me lëndë djegëse, mirëmbajtjen e ndërtesave, furnizimi për pastrime, sigurime dhe regjistrime të automjeteve, mirëmbajtjen e pajisjeve, furnizime për zyre, shpenzime të anëtarësimit dhe akomodimit, shërbime tjera kontraktuese si spërkatja e rriqrave, pajisje speciale mjekësore, shërbime teknike si dhe nevojat tjera.

Të gjitha këto shpenzime në mënyrë analitike janë të pasqyruara në raportin vjetor të shpenzimeve ku mund ta gjeni të bashkëngjitur.

- Furnizimit me barna nga lista esencial (Ministria e Shëndetësisë) edhe të hyra tjera të kontraktuara me prokurim për vitin 2023 janë në vlerë prej **-85.817.58 €**. Shuma e barnave që janë dalë nga Depoja për vitin 2023 kapë shumën prej- **73.203.04 €**. Saldo e barnave në Depo sipas komisionit për regjistrim për vitin 2024 është në vlerë prej **12.614.58 euro**.
- Furnizimi me barna nga lista esenciale si dhe furnizimi me Insulinë përmes Barnatores për vitin 2023 kapë shumën në vlerë prej **-80.097.22 €**. Të dalat nga Barnatorja për këtë vit janë në shumë prej **-75.800.16 €**.

Saldo e barnave -insulinës në Barnatore sipas komisionit për regjistrim për vitin 2024 është **-4.323.52 euro**. Gjatë vitit 2023 për nevojat e QKMF-së janë shpenzuar **17392**lita Naftë si dhe **671** litra Benzinë, të gjitha këto litra janë të arsyetuara me urdhëresa për lëvizjen e autoambulancave.

Investime Kapitale të parapare për vitin 2023 janë në vlerë prej **-401.814,00**. Të gjitha këto mjete janë shpenzuar siç vijon:

- Shpenzime për rrugë lokale **-35.814.00**
- Pajisje speciale mjekësore **-6.000.00**
- Rregullimi i garazheve në QKMF **-100.000,00**
- Shpenzime në emër të rinovimit **-60.000,00**
- Rregullimi i oborrit **-200.000,00**

Të gjitha këto shpenzime në mënyrë analitike janë të pasqyruara në raportin vjetor të shpenzimeve.

Shpenzimet Komunale të parapara për vitin 2023 janë në vlerë prej- **170.000,00**

Të shpenzuara sipas raportit vjetor janë **-126.166,44**, shuma tjetër prej **-43.833,56** mjetet në procedurë të shpenzimit për vitin e ri fiskal 2024

- Të hyrat vetanake të grumbulluara për vitin 2023 janë- **58.374.20**. Të gjitha këto të hyra janë të dorëzuara ne Bankë

Rastet me pickim nga rriqrat paraqesin prapë një problem të madh për komunën tonë edhe pse shifrat kanë tendencë rënie, por rreziku nga infeksioni vazhdon të mbetet i njëjtë.

Ne si staf menaxherial do të angazhohemi në realizimin e objektivave dhe qëllimeve tona, gjithmonë duke pretenduar të ngrisin cilësinë e shërbimeve, gjë që është edhe objektivi kryesor i Mjekësisë Familjare. Shpresojmë në një bashkëpunim të mirë me të gjithë stafin e QKMF-së, e po ashtu një mbështetje nga strukturat e Kuvendit Komunal që janë kompetent për të udhëhequr Kujdesin Parësor në Komunën e Malishevës. Mbështetje e rendit të parë janë stafi shëndetësor, i cili përballet me pacientë.

Profesionalizmi dhe humanizmi i stafit shëndetësor reflekton imazhin e institucionit tonë.

Zhvillimi i burimeve njerëzore është një ndër elementet më të rëndësishme të kujdesit shëndetësor dhe kjo realizohet me zhvillimin e vazhduar profesional, gjë për të cilën dua ta falënderoj koordinatoren e EVP-së Dr. Gëzim Krasniqin – Pediatër, i cili e bënë këtë punë me shumë profesionalizëm dhe krejtësisht pa pagesë.

Përdorimi i rregullt i standardeve dhe i protokolleve të cilësisë së shërbimeve dhe të performancës në punë do të jetë synimi ynë kryesor gjatë vitit 2024, ku me këtë synojmë të zbatojmë ligjet dhe rregulloret e punës në KPSH. Ndihmesë dhe mbështetje e vazhdueshme për realizimin e objektivave të QKMF-së, pa dyshim është Koordinatori i cilësisë Dr. Ali Krasniqi- Specialist i Biokimisë Klinike, e që me këtë rast dua ta falënderoj përzemërsisht.

Shpresojmë që ne si Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare të arrijmë të realizojmë këto qëllime gjatë vitit 2024 dhe të avancojmë vazhdimisht ndër vite, derisa të arrijmë standardet e një sistemi bashkëkohor shëndetësor.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE-RAPORT-Dt:01/01/2023 - 31/12/2023*Raporti Financiar i SNS-së Korrik – Nëntor -2023*

<i>Nr</i>	<i>Muajt</i>	<i>Nr. Familjeve</i>	<i>Shuma Euro</i>
1	Janar	711	97.590.00
2	Shkurt	687	94.410.00
3	Mars	687	92.860.00
4	Prill	656	89.770.00
5	Maj	640	87.430.00
6	Qershor	638	87.260.00
7	Korrik	631	86.360.00
8	Gusht	626	85.232.06
9	Shtator	612	83.230.00
10	Tetor	601	81.730.00
11	Nëntor	594	80.970.00
12	Dhjetor	590	80.320.00

<i>Aplikim</i>	<i>Aktivitetet</i>	<i>Kateg 1</i>	<i>Kateg 2</i>	<i>Gjithsejtë</i>
	1. Nr. i rast. që kanë aplik. Për herë të parë	22	6	28
	1.1 Sa prej tyre janë të aprovuara	16	4	20
	1.2 Sa janë në shqyrtim	0		
	1.3 Sa prej tyre janë të refuzuara	6	2	8
RIAPLIKIM	2. Nr. i rast. të larguara për mos ri-aplikim	52	27	79
	2.1. Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar	404	329	733
	2.2 Nr. i rasteve të larguara për mungesë të dokumentacionit	19	20	39

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORIVE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS (Janar – Dhjetor 2023)

VERIFIKIM	3 Nr. total i familjeve të verifikuara/riverifikuar	505	448	953
	3.1 Sa prej tyre janë të aprovuara	419	393	812
	3.2. Sa prej tyre janë refuzuar/çregjistruar	86	55	141
KOM-MJEKSOR	4 Numri i rasteve të dërguara në KM	512	0	512
	4.1. Numri i rasteve të aprovuara nga KM	407	0	407
	4.2. Numri i rasteve të refuzuara nga KM	105	0	105
	4.3. Numri i rasteve të kthyer nga KM përpos-kompletim dokumentacioni	///	0	///
ANKESAT	5. Nr. i ankesave të paraqitura nga Shfrytëzuesit	64		64
	a) Në shkallë të parë (I)	0	0	0
	b) Në shkallë të dytë (II)	64		64
	5.1. Numri i ankesave të aprovuara	1	///	1
	5.2 Numri i ankesave të refuzuara	39		39
	5.3 Numri i ankesave në shqyrtim	21	//	21
	5.4 Kontestet në gjykata	0	0	0
	a) Kontestet të pranuar	0	0	0
	b) Konteste të refuzuara	0	0	0
RIAKTIVIZIMET	6. Nr. i rasteve të Riaktivizimit	18	2	20

Aktivitetet tjera : Gjatë kësaj periudhe kemi ndihmuar disa familje me nga një pako ushqimore dhe herë pas here edhe me nga 50 kg miell. Po ashtu kemi bërë vizita dhe riverifikime në shumë familje që janë përfitues të Skemave Sociale.

Komente: Raporti përputhet me raportin e zyrtarëve të SNS-së

Vërejtje: numri i përfituesve levis sipas kërkesave dhe riaktivizimeve.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE-RAPORT VJETOR -PËR PERIUDHËN Janar - Dhjetor -2023 SHËRBIMI SOCIAL

1	Kujdestaria	15- të bartura
2	Delikuenca	145- raste
3	Sanim i marrëdhënieve bashkëshortore	1-rast
4	Dhuna ndaj gruas	49- raste
5	Besimi i fëmijëve	12-raste
6	Strehimi familjar te të afërmit e tyre	16 Kujdestarë -të bartura
7	Fëmijë në SOS-Kinderdof	/// raste
8	Në Shtime	4 raste-të bartura
9	Në shtëpinë e pleqve	///
10	Mendime për martesat e të miturve	1
11	Adoptime	///
12	Kujdestarë për raste të veçanta	1-rast
13	Konflikt prindër fëmijë	4-rast
14	Fëmijë me sjellje asociale	30 -raste
15	Ndarje bashkëshortore me dhe pa kurorë	5 raste
16	Fëmijë jetim pa të dy prindërit	///
17	Strehim Familjar jo te të afërmit e tyre	3 rast-te bartura
18	Njoftime për iniciimin e procedurës penale për të mitur nga P.P.K – e Gjakovës	34 raste
19	Kontaktime të fëmijëve me prindërit e tyre (prindër të ndarë)	6
20	Braktisje të fëmijëve	3 raste-të bartura
21	Raste të fëmijëve me nevoja të veçanta	82
22	Viktima abuzimit seksual	2
23	Heqja e zotësisë së Veprimit	2 raste
24	Dhunë Familjare	4
25	Viktima të Trafikimit Vendor	///
26	Disëharmonit e marrëdhënieve bashkëshortore	7 raste
27	Bashkime Familjare	2
28	Mbrojtje të fëmijëve	9 raste
29	Fëmijë me Nevoja të Veçanta që kanë vdekur	1
30	Dëshmi për zotësi të veprimit dëshmi	315
31	Dëshmi për lirim nga nënshtetësia e Kosovës	86 dëshmi
32	Dëshmi për fitimin e nënshtetësisë	3
33	Mos kujdesje ndaj të moshuarve	5
34	Tentim Vetëvrasje	2-raste
35	Regjistrime të më vonshme	1
36	Person i vetëm	3-raste
37	Vërtetime për kryerjen e punës Praktike në Shërbimin Social	4

Aktivitetet tjera: Kemi pasur trajnime në fushën e Strehimit Familjar, të dhunës në familje, kundër Viktimave të trafikimit dhe trajnime tjera në kuadër të Shërbimeve Sociale.

2 studentë kanë bërë praktikë në shërbimet sociale.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe kemi pasur raste të dhunës në familje dukshëm më shumë se sa vitin e kaluar ku të gjitha këto raste janë trajtuar në mënyrë të profesionalizuar nga ana e Organit të Kujdestarisë.

Komentet: Raporti përputhet me raportet e zyrtarve të SHSP.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE-RAPORTI ADMINISTRAT-FINANCA-Dt:01/01/2023-31/12/2023

Qendra për Punë Sociale në Malishevë gjatë kësaj periudhe ka bërë shfrytëzimin e mjeteve financiare në bazë të alokimeve të lejuara nga ana KK-Malishevë.

Përcjellja dhe shfrytëzimi racional i mjeteve financiare në bazë të alokimeve të lejuara nuk është bërë sipas planifikimit të Buxhetit nga ana e QPS-ës.

Planifikimi i Buxhetit të QPS-ës për Shërbime Sociale në kodin e caktuar nga Ministria e Financave 75561 nuk është shpenzuar nga zyrtari i Ad. financa.

PETI CESH - Raporti vjetor financiar Janar-Dhjetor për vitin 2023

Tabela nr.1

Nr	Data	Nr.CPO	Kodi Ekonomik	Lloji i shpenzimit	Shuma €
1	///	///	///	Tonera dhe protokol	///
2	///	///	///	///	///
3	///	///	///	///	///
Totali					

Vërejtje: Raporti për këto Shpenzime është në Drejtorinë e Financave dhe Thesarin e KK-Malishevë.

Raporti Financiar për shpenzimet e telefonit Janar- Dhjetor për vitin 2023

Raporti Financiar për shpenzimet e ujit Janar- Dhjetor për vitin 2023

Raporti Financiar për shpenzimet e energjisë elektrike Janar - Dhjetor për vitin 2023

Raporti Financiar për shpenzimet e mbeturinave Janar - Dhjetor për vitin 2023

Pagesa për Shërbime Kontraktuese

RAPORTI FINANCIAR MALLËRA DHE SHËRBIME VITI 2023

SHËRBIMET SOCIALE KODI I PROGRAMIT – 75561

Raporti Vjetor Korrik - Nëntor i shpenzimit të karburantit për vitin 2023

Tabela nr.2

Vetura Shkoda – 04Z-10-30

Nr	Muaji	Viti	Kilometrat	Karburanti i harxhuar në litra
1	Janar	2023	1490	104 L
2	Shkurt	2023	1709	151 L
3	Mars	2023	1427	93 L
4	Prill	2023	1161	102 L
5	Maj	2023	1355	101 L
6	Qershor	2023	1968	136 L

7	Korrik	2023	2014	147 L
8	Gusht	2023	1313	91 L
9	Shtator	2023	1160	92 L
10	Tetor	2023	1945	137 L
11	Nëntor	2023	1466	92 L
12	Dhjetor	2023	2080	135L

Karburantet për Gjenerator periudha Janar - Dhjetor 2023**Tabela nr.3**

Nr	Muaji	Data	Sasia - litra
1	///	///	///
Totali	///	///	///

Karburantet për Nxehje Qendrore periudha Janar - Dhjetor 2023**Tabela nr.4**

Nr	Muaji	Data	Sasia - litra
1	///	///	///
Totali	///	///	///

Vërtetime që është në Asistencë Sociale

Janar – Dhjetor 2023

NR.	MUAJI	Nr. I kerkesave
1	Janar	28
2	Shkurt	36
3	Mars	9
4	Prill	6
5	Maj	2
6	Qershor	1
7	Korrik	///
8	Gusht	4
9	Shtator	2
10	Tetor	2
11	Nëntor	2
12	Dhjetor	2

Vërtetime që nuk është në Asistencë Sociale

Janar –Dhjetor 2023

NR.	MUAJI	Nr. i kërkesave
1	Janar	22
2	Shkurt	14
3	Mars	10

4	Prill	7
5	Maj	2
6	Qershor	2
7	Korrik	3
8	Gusht	6
9	Shtator	///
10	Tetor	2
11	Nëntor	///
12	Dhjetor	5

DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM

PËRMBLEDHJE

Bazuar në realizimin e punës së Drejtorisë për Arsim dhe Edukim deklarojmë që gjatë kësaj periudhe ka pasur aktivitete të shumta të cilat janë bazuar në planin e veprimit të DKA-ës për vitin 2023.

Për të realizuar punët në procesin edukativo arsimor DKA-ja ka zhvilluar një varg konkurses, të cilat janë bazuar në legjislacionin në fuqi përfshirë rekrutimin e personelit arsimor mësimdhënës dhe teknik. DKA-ja ka bashkëpunuar ngushtë me Institucionet kompetente për të shpallë dhe realizuar konkurset për personelin arsimor, mësimdhënës dhe administrativ.

Në rekrutimin e personelit arsimor kemi zhvilluar kontakte të vazhdueshme me MASHT-in për të bërë të mundur shpalljen e konkursit edhe për angazhimin e personelit arsimor për fëmijët me nevoja të veçanta. Në drejtim të arritjeve të avancimit të pozitës së personelit arsimor, gjithashtu kemi bashkëpunuar ngushtë me MASHT-in dhe SBASHK-un e donator të tjerë në realizimin e pakove trajnuese për mësimdhënës. Këtu përfshihen angazhime në fushën e kurrikulës, dhe programeve të trajnimit të organizuara nga SBASHK-u, të cilat janë mbajtur nëpër shkolla në koordinim me nevojat e personelit arsimor sindikalist. Po ashtu kemi bashkëpunuar me CARITAS-in në avancimin e njohurive për edukatorët, të cilët punojnë me nxënësit parashkollor dhe po ashtu jemi në realizim të pakos së përkrahjes për klasat e parafillorëve me mjete konkretizimi.

Po ashtu kemi përkrahur realizimin e trajnimit për udhëheqje arsimore ku shumë kandidatë nga mësimdhënësit kanë qenë pjesë e këtij trajnimit.

Duke ditur që nevoja për ngritje të kapaciteteve arsimore për burimet njerëzore shumë herë ka qenë pjesë e programeve online në fushën e kurrikulës, dhe metodologjisë arsimore duke bashkëpunuar ngushtë me shumë donatorë dhe MASHT-in në realizimin e programeve të ndryshme dedikuar personelit arsimor. Po ashtu në këtë drejtim janë realizuar bashkëpunime të shumta, Zyrën për vlerësime dhe trajnime në MASHT. Këtu duhet veçuar bashkëpunimin që kemi pasur me SIA në Gjakovë në shqyrtimin e shumë aspekteve të legjislacionit për të drejtat e personelit arsimor. Në kuadër të bashkëpunimit për qasje në programet vlerësuese ndërkombëtare dhe kombëtare, shumë mësimdhënësë janë angazhuar në programin e vlerësimit PISA duke u njoftuar me mënyrën e realizimit të këtij testi ndërkombëtar, i cili është me rëndësi edhe për sistemin tonë arsimor. E gjithashtu angazhime në realizimin e testeve të tjera si TIMS- PIRLS.

Për të përkrahur të rinjtë dhe studentët DKA-ja ka lejuar edhe realizimin e shumë hulumtime të studentëve të drejtimeve të ndryshme arsimore që kanë realizuar praktikën profesionale në shkollat tona. Po ashtu është mbajtur edhe testi i maturës shtetërore për afatin e parë dhe të dytë, ku kalueshmëria është rreth 50% e nxënësve në të dy afatet.

Po ashtu lajm me rëndësi për qytetarët e komunës sonë ishte edhe hapja e drejtimeve të reja në IAAP “Lasgush Poradeci” në Kijevë dhe ato drejtime janë:

➤ Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë;

RRJEDHA E SHPENZIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN 01.01.2023-31.12.2023

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)		
Administrata e arsimit		Buxheti i planifikuar për vitin 2023	Shpenzimi në PR 2023	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022
1	2	3	4	5=4/3*100
		€	€	%
Paga dhe medetje	11	42,453.04	42,453.04	100.00
Mallra dhe shërbime	13			
Shpenzimet komunale	14			
Subvencionet dhe transferet	20	90,000.00	89,999.73	100.00
Investimet kapitale	30	280,000.00	279,999.69	100.00
TOTALI		412,453.04	412,452.46	100.00

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)		
Arsimi parafillor Çerdhet		Buxheti i planifikuar për vitin 2023	Shpenzimi në PR 2023	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022
1	2	3	4	5=4/3*100
		€	€	%
Paga dhe medetje	11	499,510.26	499,510.26	100.00
Mallra dhe shërbime	13	110,623.00	110,064.72	99.50

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)		
Arsimi fillor		Buxheti i planifikuar për vitin 2023	Shpenzimi në PR 2023	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022
1	2	3	4	5=4/3*100
		€	€	%
Paga dhe medetje	11	6,362,735.77	6,360,619.86	99.97
Mallra dhe shërbime	13	399,438.98	399,341.84	99.98
Shpenzimet komunale	14	72,034.00	36,499.58	50.67
Subvencionet dhe transferet	20			
Investimet kapitale	30	100,354.86	97,780.00	97.43
TOTALI		6,934,563.61	6,894,241.28	99.42

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)		
Arsimi I mesëm		Buxheti i planifikuar për vitin 2023	Shpenzimi në PR 2023	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022
1	2	3	4	5=4/3*100
		€	€	%
Paga dhe medijtje	11	1,076,820.41	1,076,820.41	100.00
Mallra dhe shërbime	13	134,499.21	133,734.90	99.43
Shpenzimet komunale	14	38,466.00	23,438.35	60.93
Subvencionet dhe transferet	20			
Investimet kapitale	30	20,000.00	19,999.80	100.00
TOTALI		1,269,785.62	1,253,993.46	98.76

Realizimi i të hyrave vetanake për vitin 2023- Sektori i Arsimit.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraparak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2023	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2023	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2023	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
Arsimi dhe shkenca		€	€	%	€
Participimet nga qerdhet		50,000.00	48,314.00	96.63	21,158.00
Të tjera admarsimi fillor					
Të tjera admarsimi mesëm					
TOTALI		50,000.00	48,314.00	96.63	21,158.00

Kontratat në përkrahje të institucioneve arsimore:

Për të realizuar kushte më të mira të punës në procesin edukativo- arsimor janë realizuar edhe këto punë dhe aktivitete:

- Kontrata: Furnizimi me material higjienik;
- Furnizimi me material teknik, i cili ka kontratë të përfunduar;
- Furnizimi me tonerë dhe letër për institucionet arsimore nga AQP-ja;
- Furnizimi me gravura dhe mirënjohje për nevojat e personelit arsimor pensionist;
- Realizimi i kontratës për mjete të zërimit për nevojat e aktiviteteve shkollore;
- Furnizimi me derivate për nevojat e shkollave me rastin e reduktimeve të energjisë elektrike;
- Hapja e Objektivit të ri të Çerdhës në Malishevë dhe në Kijevë;
- Kryerja e Shërbimeve të Internetit për Institucionet Arsimore;
- Në realizim Kontrata për furnizim me ushqim dhe pije për Çerdhen'' Zërat e Ëmbël'' në Malishevë;
- Kontrata shërbimi transportues për nxënësit me nevoja të veçanta;
- Kontrata shërbime transportuese për nxënësit, të cilët vijnë në mësimet në SHFMU'' Dëshmorët e Kombit'' në Ngucat, SHFMU'' Hasan Prishtina'' në Tërpezë, dhe SHFMU'' Ismet Jashari'' në Temeqinë, nxënësve të lagjes Garaqevë për në SHFMU'' Asim Vokshi'' në fshatin Panorç, SHFMU'' 28 Nëntori'' në Kërvasari.
- Në procedurë kontrata e re për bartjen e nxënësve në fshatin Janqist dhe Shkozë.
- Në realizim kontratat për furnizim me lëndë djegëse dru dhe pelet për institucionet arsimore.

- Realizimi i disa punëve në evitimin e defekteve në infrastrukturën shkollore përfshirë rrjetin e kanalizimit, energjisë elektrike, nyjeve sanitare dhe punë të natyrës renovuese.
- Furnizimi i Çerdhës me material didaktik.
- Furnizimit me shujtë ditore për nxënësit e programit fillor 1- 5
- Kontrata për mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore në institucionet arsimore-dyvjëçare
- Kontrata për renovimin e shkollave, kontratë dyvjëçare.

Aktivitetet të tjera:

DKA gjithashtu gjatë vitit 2023, ka realizuar edhe një varg aktivitete të tjera, të cilat kanë të bëjnë me:

- Realizimi i aktiviteteve për nder të Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve;
- Realizimi i aktiviteteve për nder të Ditëve të Shkollave;
- Realizimi i testeve provuese për testin e arritshmërisë për nxënësit e klasave të Nënta dhe të testeve provuese për Testin e Maturës shtetërore;
- Realizimi i testeve- Testit PISA, TIMS, Testit të Arritshmërisë dhe Testit të Maturës për dy afatet;
- Pjesëmarrja në garat shkollore sportive në Futboll, Volejball, Atletikë etj.
- Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme organizuar për Nxënësit me Nevoja të Veçanta;
- Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme organizuar për Edukatorët;
- Organizimi i takimeve me KFOR- LMT në Malishevë për të realizuar projekte të ndryshme në dobi të institucioneve arsimore.
- Vizita nëpër shkolla për nder të Ditëve të Shkollave;
- Pjesëmarrja në vizita monitoruese për institucionet arsimore;
- Bashkëpunimi me SIA në Gjakovë, MASHT-in e institucionet tjera e locale qendore;
- Takime me palë të ndryshme të nivelit lokal dhe qendror për mbarëvajtjen e arsimit;
- Përgatitjet për furnizim me tekste të reja shkollore.

Drejtorja për Arsim dhe Edukim ka realizuar edhe aktivitete të tjera si në:

- Realizimin e dhjetëra vizitave me karakter pune nëpër institucionet arsimore në komunë;
- Shqyrtimi i qindra kërkesave dhe ankesave të palëve të ndryshme;
- Pjesëmarrjen në shumë takime në nivel lokal dhe qendror për tematikat e ndryshme arsimore, përfshirë fushën kurrikulare, integrimin e nxënësve me nevojat të veçanta;
- Përgatitja e raporteve për Asamblenë Komunale;
- Realizimi i vizitave me karakter pune nëpër institucionet arsimore;
- Pjesëmarrje në takimet shkollore me rastin e njohjes së kontributit për mësimdhënësit pensionist;
- Përgatitja e raporteve për programin e performancës;
- Realizimi i testit Pisa, Testit TIMSS, Testit të Arritshmërisë dhe Testit të Maturës shtetërore. etj;
- Mbajtja e takimit me Aktivin e Drejtorëve;
- Organizimi i garave me karakter garues sportiv në mes shkollave;
- Përkrahja e aksioneve për pastrim të objekteve shkollore;
- Shqyrtimi i fillimit të projekteve për investimet kapitale në shkolla sipas Buxhetit të vitit 2023 në koordinim me drejtorinë e urbanizmit.

Aktivitetet e realizuara sipas planit të veprimit të DKAE-së

Muaji janar:

- ✓ Monitorimi i fillimit të gjysmë vjetorit të II-të;
- ✓ Dorëzimi i raporteve të punës për nevojat e DKA-ës/ Zyrën e Informimit si dhe përfundimi i formularëve për nevojat e DKA-ës;
- ✓ Përgatitja e Cash Floë (Rrjedhës së parasë) bazuar në buxhetin e aprovuar të vitit 2023;
- ✓ Planifikimi i mbajtjes së takimeve për kurrikulë: përgatitja e dosjeve të mësimdhënësve ;
- ✓ Mbajtja e takimit në mes EPVP ;
- ✓ Vizitë Handikos;
- ✓ Vizitë klasës së bashkangjitur
- ✓ Paraqitja e kërkesave pranë zyrës së kryetarit për të realizuar fillimin e PPP dhe plotësimin e nevojave përmes përkrahjes financiare bazuar në buxhet
- ✓ Realizimi i takimeve me MASHT-të dhe donatorë tjerë
- ✓ Mbajtja e takimit në mes EPVP
- ✓ Vizitë institucioneve arsimore.
- ✓ Vizitë organizatave të Shoqërisë civile.
- ✓ Pjesëmarrja në aktivitete shkollore me rastin e flakës së Janarit
- ✓ Monitorimi i statistikave shkollore, plan programeve dhe fillimit të funksionimit të aktiveve profesionale

Muaji shkurt:

- ✓ Vazhdimi i përgatitjeve nëpër shkolla për kremtimin e Ditës së Pavarësisë duke u angazhuar në aktivitete shkollore, gara mësimore, kuize diturie, orë letrare, koncerte muzikore, aksione për mbrojtjen e mjedisit, vizita me karakter shkollore në shkollat si motra
- ✓ Realizimi i zotimeve për disa kërkesa tek kategoria për mallra dhe shërbime
- ✓ Pjesëmarrje e nxënësve në programin kulturo artistik në koncertin festiv për Ditën e Pavarësisë në Qendër të Qytetit në Malishevë
- ✓ Fillimi i përgatitjeve për shënimin e Ditës së Mësuesit dhe monitorimi i procesit edukativo arsimorë
- ✓ Evidentimi i të gjitha aktiviteteve me bazë shkollore , si dhe regjistrimi i të gjithë nxënësve, të cilët do të marrin pjesë në gara të karakterit komunal për nder të Ditës së Mësuesit dhe Ditës së Nënës
- ✓ Identifikimi përmes aktiveve profesionale për nxënësit të cilët do të iu nënshtrohen garave të karakterit komunal, dhe kombëtar
- ✓ Dhe realizimi i aktiviteteve të tjera në koordinim ndërinstitutional
- ✓ Hartimi dhe nxjerrja e dokumenteve të nevojshme për të funksionalizuar punën e Ekipit.
- ✓ Mbajtja e takimit në mes EPVP
- ✓ Identifikimi i nevojave të komunitetit shkollore në fushën e NVM
- ✓ Identifikimi përmes aktiveve profesionale për nxënësit të cilët do të iu nënshtrohen garave të karakterit komunal, dhe kombëtar;
- ✓ Vlerësimi i procesit edukativo arsimor në fushën e cilësisë në shkolla përmes vizitave dhe identifikimeve të vlerësimeve të brendshme të shkollave
- ✓ Vlerësim i shkurtër rreth ecurisë së deritanishme në Institucionet Arsimore, DKA dhe bashkëpunimi me institucionet relevante

Muaji mars:

- ✓ Shënimi i Ditës së Mësuesit;
- ✓ Vizitë pune nëpër të gjitha shkollat e komunës sonë;
- ✓ Takim me Këshillin e Drejtorëve mësimdhënës dhe me Veteranë të Arsimit;
- ✓ Fushata e vetëdijesimit për parandalimin e etheve hemorragjike;
- ✓ Mbajtja e takimit mujor në nivel të DKA-ës në nivel të Stafit të DKA-ës/ Koordinatorët e cilësisë dhe kurrikullës/ nivel të ekspertëve dhe bashkëpunorëve profesional/ të shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në shkolla;
- ✓ Vlerësimi i përfundimit të kërkesave për tremujorin e parë të shkollave;
- ✓ Vizitë pune në disa shkolla të komunës sonë qasja e pjesëmarrjes së NMV-ve në aktivitetet shkollore;
- ✓ Realizimi i zotimeve për shpenzimet kapitale për vitin 2021 dhe përgatitje e raportit shpenzues për të gjitha kategoritë e shpenzimeve

Muaji prill:

- ✓ Kërkesa për regjistrim në klasën e parë;
- ✓ Kërkesa për numrin e teksteve shkollore, të cilat nevojiten për vitin shkollor 2023-2024;
- ✓ Kërkesa për regjistrim në klasat e dhjeta në arsimin e mesëm të lartë;
- ✓ Takime me ZRA, MASHT, Drejtorinë e Punës dhe të Mirëqenies sociale si dhe Organizata tjera, të cilat punojnë në fushën e arsimit dhe të edukimit;
- ✓ Realizimi i aktiviteteve mjedisore në shkolla;
- ✓ Mbajtja e takimit mujor në nivel të DKA-ës dhe të aktivitetit të drejtorëve e koordinatorëve të shkollave;
- ✓ Organizimi dhe mbajtja e aktiviteteve garuese në nivel të shkollave dhe pjesëmarrja e shkollave në organizime rajonale e kombëtare të karakterit shkollore;
- ✓ Mbajtja e takimit mujor në nivel të DKA-ës;
- ✓ Takime me ZRA, MASHT, Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies sociale si dhe Organizata tjera, të cilat punojnë në fushën e arsimit dhe edukimit për FNV.

Muaji maj:

- ✓ Pjesëmarrje në Shënimin e aktiviteteve për Ditën e Evropës;
- ✓ Përgatitja e kërkesave për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2024-2025;
- ✓ Regjistrimi i fëmijëve në Çerdhe;
- ✓ Regjistrimi i fëmijëve në klasën parafillor në kuadër të shkollave fillore;
- ✓ Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë të arsimit fillor;
- ✓ Riprovimet për maturantë;
- ✓ Rezultati i riprovimeve për maturantë;
- ✓ Provimi përfundimtar në shkollat profesionale;
- ✓ Rezultati nga provimet përfundimtar në shkollat profesionale;
- ✓ Paraqitja e Provimit të Maturës Shtetërore
- ✓ Dorëzimi i shënimeve përfundimtare për listën e nxënësve dhe Qendrave të testimit për maturantë
- ✓ Konsultimet me shkollat për buxhetin për vitin 2024;
- ✓ Sensibilizim i opinionit për regjistrimin e FNV në institucione arsimore;
- ✓ Pjesëmarrje në Shënimin e aktiviteteve për Ditën e Evropës;
- ✓ Realizimi i pjesëmarrjes në vizita shkollore të karakterit festiv, mësimor dhe inspektues;
- ✓ Mbajtja e takimit mujor të DKA-ës.

Muaji qershor:

- ✓ Fushatë vetëdijesimi për përfshirjen më të madhe të fëmijëve në edukimin parashkollor;
- ✓ Ankesat e nxënësve;
- ✓ Publikimi i rezultateve të ankesave;
- ✓ Përfundimi i vitit mësimor për klasat: e 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe 12-ta;
- ✓ Lista përfundimtare e administrueseve dhe qendrat e testimit;
- ✓ Faza përgatitore për riprovime për klasat: e 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe 12-ta;
- ✓ Riprovime për klasat: e 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe 12-ta;
- ✓ Rezultati nga riprovimet e klasave të 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe 12-ta;
- ✓ Mbarimi i mësimit klasa 1-8-të dhe parafillorët;
- ✓ Faza përgatitore për riprovime për klasat: e 6-ta, 8-ta;
- ✓ Riprovime për klasat: e 7-ta, 8-ta;
- ✓ Komunikimi i suksesit klasat nga 1-5-të;
- ✓ Dorëzimi i kërkesave për tekste shkollore;
- ✓ Dorëzimi i tabelarit të suksesit të nxënësve për të gjitha nivelet e arsimit
- ✓ Përgatitja e procedurave për furnizim me lëndë të parë për ngrohje me dru, pelet, derivate dhe antifriz;
- ✓ Vlerësimi i zbatimit të tremujorit të dytë të kërkesave nga shkollat si dhe hartimi raportit të punës për gjashtëmujorin e parë janar – qershor 2023.
- ✓ Regjistrimi i nxënësve për drejtimet e reja në IAAP ” Lasgush Poradeci” në Kijevë, si; Bashkëpunor profesional i infermierisë, Teknik i Sistemeve të TIK; Zhvillues i aplikacioneve softuerike; Asistent Restoranti

Muaji korrik

- ✓ Publikimi i rezultateve të testit të arritshmërisë së klasat e 9-të
- ✓ Shqyrtimi i ankesave të rezultateve të testit të arritshmërisë
- ✓ Publikimi i rezultateve të ankesave
- ✓ Komunikimi i suksesit për klasat 6-8 -ta
- ✓ Shpallja e konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, gjimnaze dhe shkolla profesionale
- ✓ Dorëzimi i dokumenteve për regjistrim në klasa e 10-të gjimnaze dhe shkolla profesionale
- ✓ Shpallja e listës së nxënësve të regjistruar në klasën e 10 –të, gjimnaze dhe shkolla profesionale
- ✓ Shpallja e konkursit për mësimdhënës, viti shkollor 2023-2024
- ✓ Përgatitja e statistikave të gjysmë vjetorit të dytë dhe dërgimi në MASHT
- ✓ Realizimi i takimit mujor në nivel të DKA-ës / Drejtorëve të shkollave dhe koordinatorëve të cilësisë

Muaji gusht

- ✓ Riprovimet për klasat e 6-12-ta
- ✓ Përgatitjet për shpërndarjen e teksteve
- ✓ Rezultati nga riprovimet 6-12-ta
- ✓ Paraqitja e provimit të Maturës Shtetërore
- ✓ Realizimi i shpërndarjes së librave falas nga MASHT-i.
- ✓ Përzgjedhja e kompanive për bartjen e transportit të nxënësve për vitin shkollor
- ✓ Konkursi plotësues për klasat e 10-ta, gjimnaze dhe shkolla profesionale
- ✓ Dorëzimi i dokumenteve për regjistrim në klasat 10-të gjimnaze dhe shkolla profesionale

- ✓ Shpallja e listës së nxënësve të regjistruar në klasën e 10 –të, gjimnaze dhe shkolla profesionale
- ✓ Pranimi i kuadrit mësimor për vitin shkollor 2023-2023
- ✓ Përgatitja e objekteve shkollore
- ✓ Furnizimi i shkollave me material për zyrë, sportiv, higjenik, pedagogjik etj.
- ✓ Furnizimi i nxënësve me tekste shkollore
- ✓ Takime me shkollat e mesme të larta për organizimin e ekskursioneve shkollore për Maturantët
- ✓ Angazhimi për të planifikuar hartimin e buxhetit për vitin 2023
- ✓ Mbajtja e takimit mujor në nivel të DKA-ës

Muaji shtator:

- ✓ Fillimi i vitit shkollor 2023-2024.
- ✓ Inspektimi i fillimit të procesit me pjesëmarrjen edhe të kryetarit të komunës
- ✓ Shpërndarja e kalendarit shkollor dhe e orarit mësimor të shkollave- komunitetit të prindërve
- ✓ Monitorimi i procesit të shpërndarjes së teksteve mësimore.
- ✓ Provimi i Maturës Shtetërore –dita e dytë
- ✓ Publikimi i rezultateve të testit të maturës
- ✓ Hulumtimi i rasteve të braktisjes së shkollimit
- ✓ Takime me Këshillin e Prindërve
- ✓ Plotësimi i librave të klasës me të dhënat e kërkuara për lëndët dhe tekstet mësimore dhe monitorimi i përfshirjes së të dhënave në sistemin e SMIA
- ✓ Monitorimi i ekskursioneve shkollore të maturantëve.
- ✓ Vlerësimi i kërkesave të shqyrtuara për tremujorin e tretë dhe plotësimi i nevojave dhe vlerësimi përfundimtar i të dhënave në buxhetin e shkollave për delegim në asamblenë komunale

Muaji tetor:

- ✓ Realizimi i vizitave në shkolla
- ✓ Mbledhja e të gjitha të dhënave për aktivet profesionale, grupet mësimore, organet e tjera shkollore
- ✓ Organizimi i garave ndërshkollore në shkollat fqinjësore duke realizuar edhe ekskursione shkollore
- ✓ Organizimi i takimit në nivel të DKA-ës me Grupet Profesionale/ Drejtorët e Shkollave/ Përfaqësuesit e Prindërve/ SIA- Gjakovë / Koordinatorët e cilësisë
- ✓ Organizimi i takimit në nivel të DKA-ës me Grupet Profesionale/ Drejtorët e Shkollave/ Përfaqësuesit e Prindërve/ SIA- Gjakovë / Koordinatorët e cilësisë dhe EPVP
- ✓ Realizimi i vizitave inspektuese në shkolla
- ✓ Furnizimi me lëndë djegëse dru dhe pelet e me derivate për institucionet arsimore.

Muaji nëntor:

- ✓ Përgatitjet për shënimin e festive të Nëntorit. Organizimi i aktiviteteve me karakter garues, mësimorë dhe kulturor me pjesëmarrje edhe të komunitetit të prindërve dhe komunitetit të biznesit.
- ✓ Organizim i takimit me Këshillin e Drejtorëve
- ✓ Realizimi i vizitave inspektuese në shkolla.
- ✓ Organizimi i takimit me përfaqësuesit e Sindikatës, të Policisë së Kosovës, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale/ OJQ-të
- ✓ Organizimi i garave të Olimpiadës për Matematikanëve të rinj.
- ✓ Përgatitja e planit dinamik të prokurimit për vitin 2024.

Muaji dhjetor:

- ✓ Organizime shkollore për nder të ditës për të Drejtat e fëmijëve;
- ✓ Pjesëmarrje në aktivitet për Personat me nevoja të veçanta
- ✓ Vlerësim i realizimit të plan programit mësimor për gjysmë vjetorin e parë.
- ✓ Realizimi i takimit me Këshillin e Drejtorëve
- ✓ Organizimi i takimit me aktivin e drejtorëve, këshillin e prindërve, koordinatorëve të cilësisë
- ✓ Nxjerrja e raportit përfundimtar për gjashtëmujorin e dytë dhe e raportit vjetor për vitin 2023.

Bashkëpunimi me institucionet tjera:

DKA-ja ka realizuar bashkëpunime me shumë institucione lokale dhe qendrore:

- Bashkëpunimi me Zyrën për Barazi Gjinore në realizimin e aktiviteteve për të drejtat e njeriut, të fëmijëve dhe të gruas;
- Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës në projekte të përbashkëta për mjedis të sigurtë shkollor;
- Bashkëpunimi me Shoqata Joqeveritare lokale dhe Qendrore në projekte me rëndësi për komunitetin shkollor;
- Bashkëpunimi me Hidro Regjionit në trajtimin e disa kërkesave nga ana institucioneve arsimore;
- Bashkëpunimi me Ekoregjionin për arritjen e objektivave për mjedise të pastra shkollore;
- Bashkëpunimi me CARITAS-in në ngritjen e pozitës së infrastrukturës për klasat parashkollore e gjithashtu realizimin e programit trajnues për edukatorët dhe personelin e Çerdhës;
- Bashkëpunimi me KEDS-in për trajtimin e problemeve në rrjetin e energjisë elektrike;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Drejtoritë komunale;
- Bashkëpunimi me QKMF'' Dr. Shpëtim Robaj'' në Malishevë;
- Bashkëpunimi me shumë donatorë të cilët përkrahin vazhdimisht institucionet arsimore;
- Bashkëpunimi me LMT me seli në Malishevë për shqyrtimin e realizimit të projekteve me rëndësi shkollore;
- Bashkëpunimi me KFOR-in Turk dhe Zvicerian: Realizimi i projektit për kabinetin e informatikës për Gjimnazin '' Hamdi Berisha'' në Malishevë si dhe shqyrtimi I Hapjes së tri puseve për Institucionet Arsimore për SHFMU'' Kajtaz Ramadani'' në Paralelet e saj në Gullboc dhe Stapanicë dhe SHFMU'' Emin Duraku'' në Dragobil.
- Bashkëpunimi me Komitetin e Arsimit në Trajtimin e temave me rëndësi arsimore;
- Bashkëpunimi me KPF-ën në shqyrtimin e raporteve për Asamblenë Komunale;
- Bashkëpunimi me Këshillin për Sigurinë në Bashkësi.

PËRGATITJET PËR VITIN E RI SHKOLLOR 2023/2024

Duke u bazuar në vazhdimësinë e zhvillimit të procesit edukativo arsimor, Drejtoria për Arsim dhe Edukim kishte filluar përgatitjet për të realizuar përgatitjet që viti i ardhshëm shkollor të jetë i organizuar dhe të funksionojë në kushte sa më të mira në përputhje me rekomandimet që do të ipen nga MASHT-i

Për të realizuar përgatitje sa më të mira të stafit mësimdhënës DKAE-ja ka bashkëpunuar ngushtë me shkollat në përgatitjet e konkursit për pranimin e punëtorëve të rinj. Kjo është bërë në koordinim dhe bazuar në legjislacionin në fuqi të nxjerrë nga MASHT-i. DKAE-ja ka shpallë konkurs për plotësimin e mbi 20 pozitave të punës. Në kuadër të rekrutimit të personelit arsimor për nivelin 0 programi parashkollor- edukimi në Çerdhe, ne kemi rekrutuar personelin arsimor përmes konkursit dhe janë kryer të gjitha procedurat shpresojmë se në shtator stafi i pranuar në punë do të fillojë punën e vet për të realizuar funksionimin edhe të dy Çerdheve të reja.

Në drejtim të një arsimit sa më gjithëpërfshirës, Drejtoria për Arsim dhe Edukim ka bërë kërkesë që të shtohet numri i edukatoreve në institucionet tona. Kjo e bazuar në KAB të vitit 2023 dhe për vitin 2024, ku thuhet se raporti Edukatore nxënës duhet të jetë: 1:12 nxënës. E aktualisht një edukatore në shkollat tona duke vlerësuar mesataren angazhohet për 20 nxënës. Kjo është shumë dhe del jashtë standardeve arsimore, pasi niveli parafillor kërkon përkushtim më të madh në raport me fëmijët. Vlerësuar në aspekte të përgjithshme konsiderojmë që institucionet arsimore janë duke lëvizur në drejtim të mirë të plotësimit të kuadrit të kualifikuar që na garanton për rezultate sa më të larta të procesit edukativo arsimor. Në këtë drejtim bazuar edhe në konkursin e shpallur kemi nevojë për plotësimin e pozitave me kualifikime për lëndët matematikë, gjuhë gjermane, TIK, gjuhë angleze, Art dhe muzikë. Në fushën e përgatitjeve për arsim gjithëpërfshirës DAE-ja ka punuar ngushtë me Shkollat, Këshillin e Prindërve, dhe gjithashtu ka themeluar Ekipin për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me nevoja të Veçanta me qëllim të plotësimit të këtij standardi institucional dhe përfshirjen e këtyre fëmijëve në procesin arsimor. Po ashtu formimi i EPRMB-ve – Ekipeve për Parandalimin e Braktisjes dhe Reagimit për mos Regjistrim të Nxënësve është kërkesë për të gjitha shkollat e koordinuar me MASHT-in.

Në përgatitjen për vitin e ardhshëm shkollor do veçuar edhe anën e planifikimit financiar, ku jemi duke punuar ngushtë me Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Buxhet dhe me MASHT-in që të koordinojmë sa më mirë veprimet tona që të kemi një planifikim sa më gjithëpërfshirës. Do të mbetet sfida angazhimi i koordinatorëve të cilësisë në shkollat, të cilat deri tani janë çertifikuar nga MASHT-i. Po ashtu po planifikojmë të angazhojmë edhe rritjen e numrit të Shërbimit Pedagogjik dhe Psikologjik në shkollat tona. Gjithashtu në këtë drejtim e kemi pasur të lejuar që të angazhojmë edhe mësuesë mbështetës për të ndihmuar integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat tona, ku tash janë të punësuar 8 mësime dhe kemi shpallë konkurs edhe për 3 pozita (tre) për asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta..

Për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme për përgatitjet dimërore nëpër shkolla po paraqesim një raport të përgjithshëm cili do të reflektojë anën e burimeve njerëzore, përgatitjet për mallra dhe shërbime e gjithashtu infrastrukturën shkollore.

Në aspektin e burimeve njerëzore kemi pothuajse stafin e kompletuar dhe të kualifikuar për të realizuar punën në procesin edukativo arsimor në rast të zhvillimit të punës në institucionet arsimore. Për të plotësuar nevojat për stafin e drejtorisë, konsiderojmë që Drejtoria për Arsim dhe Edukim ka nevojë të domosdoshme të shtojë numrin e stafit të vet të punës, pasi që aktualisht funksionon me 4 punëtorë dhe Drejtoreshën e DKAË-së. Për të kompletuar stafin, i cili do të ndikonte në rritjen e përgjegjësisë krahas institucioneve arsimore, konsiderojmë se prania e një pedagogu dhe një psikologu dhe një zyrtari për arsimin parafillor dhe zyrtari për arsimin fillor është nevojë e domosdoshme që të mund të plotësojmë stafin për punë sa më gjithëpërfshirëse, që do të na garantonte cilësi dhe rezultate pozitive nga i gjithë procesi edukativo arsimor.

Në aspektin e infrastrukturës besoj që kemi një infrastrukturë të mirë që garanton funksionimin e rregullt të institucioneve arsimore

Këtu do të veçojmë intensifikimin e punimeve në Shkollat në Dragobil dhe në Malishevë, projektin për Çerdhen në Banjë, projekte të MASHTI-it. Besojmë që në këtë vit shkollor do të fillojmë punën në të Objektit të ri shkollor në SHFMU" Asim Vokshi" në Panorc dhe gjithashtu hapja e Çerdhes së re në Malishevë, e cila do të pranojë afërsisht edhe 80 fëmijë të tjerë, të cilët do të vijnë në mësimet dhe hapja e Çerdhes në Kijevë. Tek SHFMU" Asim Vokshi" në Panorc, është realizuar projekti për furnizim me inventar dhe shkolla është pajisur me inventarë shkollore. Po ashtu për të përkrahur infrastrukturën shkollore kanë qenë në zbatim kontrata për renovimin e shkollave. Po ashtu është kontrata për mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore e cila vazhdon të mbetet në realizim edhe për pjesën shtesë sipas nevojave të institucioneve arsimore.

Kemi vështirësi në furnizim me material administrativ përveç letrës për shkak të kufizimeve në procedurat e prokurimit publik. Është në realizim kontrata për furnizim me rekuizita sportive. Po ashtu kontrata për shkollat me rastin e ditëve të shkollave dhe mirënjohjen e kontributit të mësimdhënësve pensionistë. Gjithashtu do të bëjmë në këtë javë furnizimin me librat e klasës, materialit pedagogjik, po ashtu edhe këtë vit DKAË-ja do të përkrah nxënësit e familjeve në nevojë, të cilat kanë nevojë të furnizohen me pajisje shkollore.

Po ashtu kemi disa shkolla të cilat janë të përfshira në një marrëveshje për efikasitet të energjisë elektrike: Gjimnazi'' Hamdi Berisha'' në Malishevë, të kryera punimet, SHFMU'' Ibrahim Mazreku'' në realizim e sipër punimet, SHFMU'' Labinot Krasniqi'' të realizuara punimet, IAAP '' Lasgush Poradeci'' në Kijevë në realizim e sipër punimet.

Besoj që në javët në vazhdim do të fillojnë edhe procedurat për furnizim me material teknik dhe mirëmbajtja teknike për institucionet arsimore. Por edhe kjo është e diktuar nga procedurat e prokurimit publik për shkak të ankesave. Po ashtu në realizimin e një mjedisi të sigurt shkollor do të bëhet edhe realizimi i Shërbimeve DDD (Dezinfektim, Deratizim dhe Dezinsektim) për institucionet arsimore.

Drejtorja për Arsim dhe Edukim gjatë këtij viti, ka realizuar edhe shumë punë të tjera administrative përfshirë, raportet statistikore, koordinimin me shkollat për planifikimin e shpenzimeve për vitin 2024, identifikimin e nevojave për projekte prioritare për institucionet arsimore, dhe komunikimin e rregullt me Drejtorinë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa në përgatitjen e planifikimeve buxhetore për vitin 2024. Duke ditur që edhe këtë vit do të furnizohemi me tekste shkollore, ju njoftojmë se do të ketë furnizim për nivelin 1 pra për klasat 1-5 – ta dhe DKAË-ja ka dorëzuar me kohë të dhënat për furnizimin me tekste shkollore, por ende ky proces nuk ka përfunduar. Pra jemi në pritje të MASHTI-it për fillimin e procesit të furnizimit me tekste shkollore për fazën e parë dhe nuk kemi asnjë njoftim zyrtar për fazën e dytë me furnizim me tekste shkollore. Ky është një shqetsim evident, i cili na përshkon në këtë muaj sepse nuk kemi asnjë lëvizje që të furnizohemi me tekste para shtatorit.

Po ashtu janë bërë edhe shumë specifikime për realizimin e shërbimeve për shkollat. Gjithashtu janë realizuar me dhjetëra konkurse për plotësimin e personelit arsimor dhe administrativ e teknik për shkollat. Po ashtu DKAË-ja ka realizuar të gjitha raportet për mbajtjen e Testeve–ICILS, Testit TIMSS, Testi i Arritshmërisë, dhe Testin e Maturës për afatin e parë e gjithashtu është e përgatitur për mbajtjen e testit të maturës për afatin e dytë, etj.

Përfundim:

Bazuar në rrjedhat e përgjithshme konsiderojmë që sektori i arsimit duhet të mbështetet nga Granti i Përgjithshëm për të mbuluar të gjitha nevojat, të cilat i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime ku janë rritur çmimet dhe e kemi të pamundur të jemi të kompletuar në plotësimin e tyre duke ditur që kemi një buxhet të kufizuar të kësaj kategorie, e cila nuk plotëson të gjitha nevojat.

Shkollat kanë nevojë, për furnizime me mjete konkretizimi, pajisje informatike, perde, kamera të sigurisë, furnizim me lëndë djegëse pelet dhe nevojat tjera. Kemi nevojë për përkrahje në realizimin e shërbimeve trajnuese për personelin arsimor dhe Këshillat Drejtues të Shkollave, realizimin e praktikës profesionale. Po ashtu në vitin shkollor planifikojmë të mbulojmë transportin e nxënësve në Ngucat, Tërpeze, Temeqinë, Shkozë, Carrallukë, Lagjen Kodrali të Kërvasarisë. Garaqevë.

Bazuar në realizimin e aktiviteteve të deritanishme deklarojmë që DKA-ja do të vazhdojë të punojë me përkushtim për realizimin e planit të punës për gjithë vitin 2023.

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Drejtoria e Bujqësisë duke u bazuar në buxhetin dhe Planin e punës për vitin 2023, dhe në kërkesat e fermerëve, këtë vit ka realizuar një numër të madh të projekteve dhe aktiviteteve ku janë ndihmuar fermerët dhe ekonomit bujqësorë në rritjen e produktivitetit për sektorët prioritar. Bujqësia në Komunën e Malishevës, ka filluar të zhvillohet duke u bazuar në angazhimet e bujqve lokal dhe është njëra prej degëve kryesore të zhvillimit ekonomik. Mund të thuhet se një pjesë e madhe e territorit të Komunës është e mbuluar me tokë pjellore dhe ka klimë të përshtatshme që garanton prodhimtari ekonomike dhe profitabilitet të drithërave, pemëve, perimeve dhe blegtorisë.

**PROJEKTET E REALIZUARA NGA DBPZHR PËR PERIUDHËN VJETORE 2023****1. Përkrahja e blegtorëve me subvencionim të qumështit përmes pagesave direkte qumësht/litër për 6 mujin e dytë 2022**

Ky projekt është planifikuar të ndahet në dy periudha të aplikimit (çdo 6 muaj), për 6 mujin e dytë të vitit 2022, ku kemi publikuar thirrjen për aplikim me datë: 19.01.2023 dhe nr: 08/03, ku në këtë projekt kanë përfituar 70 fermerë të cilët dorëzojnë qumësht në pikat grumbulluese të qumështit.

Pas vlerësimit të aplikacioneve të fermerëve Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka përpiluar listën e përfituesve ku janë përkrahur 70 fermerë (blegtorë) me **0.03 Euro** për litër të qumështit përkatësisht janë subvencionuar 1,074.522.00 litra qumësht.

Vlera e përgjithshme e këtij projekti ka qenë: **32,235.66 Euro**.



2. Përkrahja e blegtorëve me subvencionim të qumështit përmes pagesave direkte qumësht/litër për 6 mujorin e parë 2023

Edhe ky projekt është planifikuar të ndahet në dy periudha të aplikimit (çdo 6 muaj), për 6 mujorin e parë të vitit 2023, ku kemi publikuar thirrjen për aplikim me datë: 01.08.2023 dhe nr: 08/760, ku në këtë projekt kanë përfituar 77 fermerë të cilët dorëzojnë qumësht në pikat grumbulluese të qumështit.

Pas vlerësimit të aplikacioneve të fermerëve kemi përpiluar listën e përfituesve ku janë përkrahur 77 fermerë (blegtorë) me **0.03 Euro** për litër të qumështit përkatësisht janë subvencionuar 917,746.00 litra qumësht.



Foto e dorëzimit të qumështit nga fermerët nëpër pika grumbulluese të qumështit

Vlera e përgjithshme e këtij projekti ka qenë: **30,470.25 Euro**.

3. Subvencionimi i fermerëve me Pagesa direkte për Bletari, dhe Blegtori (dele dhe dhi)

Gjatë muajit prill është publikuar thirrja për aplikim nga ana e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për pagesa direkte për bletari dhe blegtori (dele dhe dhi).

Me këtë projekt janë paraparë që të përkrahën bletarët me nga 4 euro për shoqëri bletësh, si dhe blegtorët të cilët mirrën me mbarështimin e blegtorisë së imët (dele dhe dhi) qumështore me nga 3 euro për krerë.



Në këtë thirrje kanë aplikuar 106 bletarë si dhe 37 fermerë për dele dhe dhi.

Vlera e përgjithshme e këtij projekti ka qenë: **34,342.00 €**

4. Përkrahja e fermerëve përmes Organizatës “QATAR CHARITY”

Në bashkëpunim me Organizatën “QATAR CHARITY” me seli në Prishtinë si dhe Komunës së Malishevës (Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), si rezultat i memorandumit të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit të datës 31.05.2023 dhe nr. 01/773.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me datë: 02.06.2023 me nr 08/253, ka hapur thirrjen për aplikim për këto projekte;

1. Serrë bujqësore për kultivim me sip. 96 m² dhe sistem të ujitjes.
2. Shoqëri bletësh me 8 - tetë bletë.
3. Frezë dheu për traktor.
4. Kositëse bari për traktor.
5. Moto-kultivator me frezë dhe kosë.

Kjo thirrje për aplikim është e hapur prej datës 02.06.2023 deri me 16.06.2023, ku në këtë projekt kanë përfituar një numër i madh i fermerëve:

- ❖ 53 fermerë me serra me sipërfaqe prej 96 m²
- ❖ 10 fermerë me nga tetë koshere dhe tetë shoqëri bletësh
- ❖ 12 fermerë me freza të dheut për traktor

- ❖ 8 fermerë me nga një kosë bari për traktor
- ❖ 10 fermerë me nga një motokultivator me frezë dhe kosë.

5. Përkrahja e fermerëve me Mekanizëm Bujqësor

Në kuadër të zhvillimit të bujqësisë, lavërtarisë, pemëtarisë, vreshtarisë dhe perimtarisë, Komuna e Malishevës, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka publikuar shpalljen për përkrahjen e fermerëve me Mekanizëm Bujqësorë.

Shpallja ka qenë e publikuar me datë 01.08.2023 me nr protokolli 08/761, ku në këtë projekt Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka kontribuar me 70% të shumës së pajisjeve bujqësore, kurse fermeri ka participuar me 30% të shumës.



Në këtë thirrje kanë përfituar 80 fermer me këtë lloj të mekanizmit:

1. Spërkatëse 400 litra 14 copë
2. Shpërndarëse të plehut kimik 350L 17 copë
3. Mbjellëse Misëri 4 rende 15 copë
4. Mbjellëse Gruri 16 rende 14 copë
5. Freza 1.6 m 14 copë
6. Spërkatëse me benzinë kolicë 3 copë
7. Nxjerrëse të qepëve njërendore 3 copë

Vlera e përgjithshme e këtij Projekti ka qenë: **78,986.41 €**

AKTIVITETET E REALIZUARA NGA DBPZHR PËR PERIUDHËN VJETORE 2023

Drejtorja e Bujqësisë për këtë periudhë të punës përveç aktiviteteve që ka pasur në pritjen e palëve, pranimin e kërkesave nga ana e fermerëve, përgjigjen e ankesave, përgatitjen e vërtetimeve për viza turistike për ata fermer që merren me bujqësi, regjistrimin e fermerëve në programin e AZHB-së dhe lëshimin e NIF – it (numri identifikues i fermerit), konsultime me fermerët të cilët nuk kanë pasur njohuri rreth bujqësisë, mënyrës së aplikimeve për subvencione dhe sqarime rreth procedurave të aplikimit, ka kryer edhe punë të tjera si më poshtë:

1. Thirrja për aplikim për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e dytë 2022.

Prej datës **12.01.2023 deri me datë 10.02.2023 ora 16:00** stafi i Drejtorisë së Bujqësisë ka qenë i angazhuar në aplikimin e fermerëve për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, viçave për majmëri dhe therjet e raportuara të gjedhit për gjashtëmujorin e dytë 2022, që i ndanë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Gjatë kësaj periudhe në Drejtorinë tonë për këtë masë kanë aplikuar 44 fermerë.

2. Thirrja për aplikim për pagesa direkte për vitin 2023

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka hapur thirrjen për aplikim për të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojnë për mbështetje përmes Programit për Pagesa Direkte për vitin 2023.

Këto procedura të aplikimit kryhen në Drejtorinë e Bujqësisë Malishevë, nga stafi i drejtorisë, ku i gjithë stafi merret me procedurat e publikimit të thirrjes, përgatitjen e dokumentacionit, sqarime tek fermerët rreth procedurave për aplikim, si dhe digjitalizimin e parcelave të mbjella.

Përkrahja jepet për këto kultura dhe aktivitete bujqësore:

- Pagesa Direkte për sipërfaqet e mbjella me grurë dhe sasinë e prodhuar/dorëzuar të grurit;
- Pagesa Direkte për sipërfaqet e mbjella me farë të grurit;
- Pagesa Direkte për sipërfaqet e mbjella me elb;
- Pagesa Direkte për sipërfaqet e mbjella me thekër;
- Pagesa Direkte për sipërfaqet e mbjella me tërshërë;
- Pagesa Direkte për sipërfaqet e mbjella me misër;
- Pagesa Direkte për sipërfaqet e mbjella me luledielli;
- Pagesa Direkte për vreshtat ekzistues;
- Pagesa Direkte për verën e prodhuar dhe të deklaruar zyrtarisht;
- Pagesa Direkte për pemishtet ekzistuese;
- Pagesa Direkte për sasinë e dorëzuar/ shitur të frutave të mjedrës;
- Pagesa Direkte për primin e sigurimit bujqësor për kulturën bujqësore të mjedrës, mollës, kumbullës, rrushit, dredhëzës, specit, arrës fasules, misrit, qershisë, vishnjës dhe dardhës si dhe primin e sigurimit bujqësor

tradicional (breshër), për kulturën bujqësore të mollës - pemishtet intensive, kulturën e specit - kultivimi intensiv dhe rrushin e verës;

- Pagesa Direkte për prodhimtarinë e materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe të hardhisë së rrushit;
- Pagesa Direkte për sipërfaqet e mbjella me perime;
- Pagesa Direkte për prodhimtarinë organike;
- Pagesa Direkte për bimët mjekësore dhe aromatike;
- Pagesa Direkte për lopë dhe buallica qumështore;
- Pagesa Direkte për dele dhe dhi qumështore;
- Pagesa Direkte për bletë;
- Pagesa Direkte për pula vojse;
- Pagesa Direkte për dosa për riprodhim;

Periudha e aplikimit:

Aplikimi ka zgjatur 30 ditë kalendarike, ka filluar nga data 28.02.2023 dhe ka përfunduar me date 29.03.2023 deri në orën 16:00.

Mirëpo me vendim të Ministrisë është shtyrë afati për aplikim deri me datë 14.04.2023 në orën 16:00.

Gjatë kësaj periudhe të aplikimit për Pagesa Direkte për vitin 2023 në Komunën e Malishevës kanë aplikuar 1143 fermerë, ku më poshtë i kemi paraqitur të ndara në Kultura dhe Aktivitete tjera Bujqësore.

Statistikat e përgjithshme të sipërfaqeve të kulturave lavërtare, perimëtare, pemëtare, vreshtave, bimëve mjekësore aromatike si dhe fondi blegtoral, shpezëve, dhe bletarisë, në Komunën e Malishevës.

Tabela 1. Të dhënat e sektorëve për vitin 2023 në Komunën e Malishevës

Sipërfaqja e Kulturave Lavërtare/ha		
	Nr.fermerëve	Sipërfaqja/ha
Grurë	767	2821.26
Misër	388	1052.01
Tërshërë	42	94.03
Elb	7	10.48
Sipërfaqja e Kulturave Pemtare dhe Vreshtare/ha		
	Nr.fermerëve	Sipërfaqja/ha
Mollë	43	124.77
Dardhë	10	16.19

<i>Arra</i>	38	70.84
<i>Vishnje</i>	4	8.38
<i>Qersh</i>	3	3.01
<i>Kumbull</i>	21	19.89
<i>Ftua</i>	2	3.04
<i>Lajthi</i>	3	1.61
<i>Pjeshkë</i>	2	16.19
<i>Mjedër</i>	2	0.38
<i>Vreshta</i>	87	44.13
Blegtori, Shpezëtari dhe Bletari		
	Nr. fermerëve	Krerë/Copë/Shoqëri
<i>Lopë Qumështore</i>	161	1951
<i>Dele Qumështore</i>	39	4839
<i>Dhi Qumështore</i>	10	737
<i>Buallica</i>	1	2
<i>Pula</i>	1	4000
<i>Bletë</i>	73	4969
Sipërfaqja me Kultura Perimore dhe BMA /ha		
	Nr. fermerëve	Sipërfaqja/ha
<i>Patate</i>	2	5.92
<i>Qepë</i>	10	8.4
<i>Lakër</i>	2	2.1
<i>Fasule</i>	3	13.71
<i>Kunguj</i>	5	2.98
<i>Shalqinj</i>	3	2.51
<i>Perime në Sera</i>	2	0.52
<i>Bimë mjekësore dhe Aromatike</i>	4	3.11

3. Dëmet në Bujqësi të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi, komuna ka formuar komisionin profesional për vlerësimin e dëmeve në terren.

Komisioni komunal ka përgjegjësi të:

- ✚ Pranimin e kërkesës nga ana e fermerit/ës;
- ✚ Verifikimin e gjendjes faktike në teren i shoqëruar me procesverbal dhe i nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit;
- ✚ Përgatitja e raportit të vlerësimit për secilin fermer/e si dhe dokumentet e bashkëngjitura në vijim:
 - a) Kërkesa e fermerit-ës;
 - b) Procesverbali i komisionit komunal për konstatimin e gjendjes në teren;
 - c) Fotot nga terreni;
 - d) Kopja e letërnjoftimit të fermerit-ës;
 - e) Kopja e llogarisë bankare e fermerit-ës;
 - f) Deklaratë nën betim/ zotim për saktësinë e të dhënave të prezantuara gjatë procesit të vlerësimit të dëmeve.

Në Komunën e Malishevës kemi pasur dëme nga fatkeqësitë natyrore elementare gjatë muajit Prill, ku ka shkaktuar dëme në bujqësi.



Foto nga terreni gjatë vlerësimit të dëmeve nga ngricat pranverore.

Sektori më i dëmtuar ka qenë aj i pemëtarisë, ku sipas verifikimit nga ana e komisionit në Komunën tonë, dëme nga fatkeqësitë natyrore elementare kanë pasur 9 fermerë si kultivues të kulturave pemëtoje, dhe serave si dhe është përgatitur raporti i vlerësimit për secilin fermerë si dhe raporti përfundimtarë, dhe njëkohësisht janë dorëzuar te Komisioni qendrorë i formuar nga Qeveria e Kosovës për shqyrtim dhe kompensim të dëmeve.

Vlera e përgjithshme e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare ka qenë: **64,292.32 €uro.**

4. Realizimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2023

Në këtë vit sipas shënimeve të grumbulluara nga terreni në Komunën tonë kanë qenë të planifikuara të mbillen me kultura pranverore afër 1,479.20 ha, ndërsa janë realizuar 1,358.42 ha.

Tabela 2: Struktura e mbjelljeve pranverore

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e realizuara ha
1	Misër për kokërr	895
2	Misër i gjelbër (për sillazh)	157
3	Tërshërë	94.03
4	Elb Pranveror	10.48
5	Patate	57
7	Perime	95.2
8	Bimë Foragjere	36
9	Fasule Monokulturë	13.71

5. Fushata e korrje-shirjeve për vitin ekonomik 2022/2023 në Komunën e Malishevës

Fushat e korrje-shirjeve në këtë vit në komunën tone ka filluar me datë 14.07.2023

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme në mënyrë që ky proces mjaft i rëndësishëm të shkojë mirë dhe të mos ketë pengesa, për këtë arsye është formuar shtabi komunal për korrje-shirje.

Shtabi komunal i formuar me anë të vendimit të Kryetarit në përbërje prej 5 anëtarëve, gjatë gjithë kësaj periudhe ka qenë në teren duke bërë inspektime për të parë që gruri ishte në pjekuri të plotë dhe lagështia e grurit a ka qenë në suazat e lejuara për korrje.

Në këtë vit në territorin e komunës sonë kanë qenë të mbjella me drithëra të bardha rreth 3,623.51 ha, dhe këto sipërfaqe janë pritur që të korren gjatë kësaj periudhe.

Drejtori e Bujqësisë para fillimit të kësaj fushate i ka informuar autokombajnerët dhe i ka njoftuar lidhur me rregullat që duhet ti përmbahen si dhe rreth çmimit të rekomanduar për korrje-shirje nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e që ka qenë 130 € / ha.



Kushtet atmosferike jo të mira, reshjet e shpeshta dhe të shumta kanë ndikuar që fillimi i fushatës së korrje-shirjeve të jetë pak më i vonuar. Këto kushte kanë ndikuar në rendiment çka do të thotë se këtë vit rendimenti është pak më i ulët se sa vitin e kaluar, mirëpo krahasuar në nivel vendi është në suazat e mesatares.

Rendimenti mesatar i grurit për këtë vit ka qenë rreth 2,850.00 kg/ha.

Fushata e korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Malishevës zyrtarisht ka përfunduar me datë: 04.08.2023.

PYLLTARIA DHE MBROJTJA E PYJEVE

Gjatë vitit kalendarik 2023 stafi i Njesisë pyjore Komunale në mbrojtjen e pyjeve nga dëmtimet e ndryshme eventuale si nga prerjet ilegale, po ashtu edhe nga faktorët tjerë (zjarret, sëmundjet e ndryshme, insektet etj), uzurpimet e tokave pyjore, prerjet pa leje të drunjve në pyjet private, ndërtimet pa ndërrim destinim të pronës etj; përkundër vështirësive natyrore të ndryshme duke u nis nga stafi jo i mjaftueshëm për mbrojtjen e 7800 ha pyje publike dhe vëzhgimin e punëve në mbi 8000 ha pyje private, mungesa e një veture për punë tereni në pyje për efikasitet në punë; mund të konkludojmë se kemi përmbushur kënaqshëm detyrat dhe obligimet sipas ligjit.

✚ Gjatë këtij viti në pyjet publike të Njesisë “Pyjet e Malishevës” kemi pasur 2 raste të shpërthimit të zjarreve dhe janë përfshirë rreth 30 hektar, ku ky zjarr ka zgjatë 2 ditë. Zjarret kishin ndodhur në muajin shkurt në Rajonin “Rrafshina” para fillimit të vegjetacionit, në ndërkohë kemi rigjenerim të drunjve. Në Rajonin “Dubrava” zjarri ka ndodhur në vjeshtë dhe zgjati dy ditë, dëmet ishin të konsiderueshme dhe për rigjenerim eventual të drunjve duhet pritur fazën e vegjetacionit si dhe për bimët tjera. Në parandalimin e dëmeve më të mëdha duhet cekur intervenimin profesional dhe në kohë të Njesisë së Zjarrfikësve në Malishevë.

✚ Nga pronarët e pyjeve private gjatë vitit 2023 kemi pranuar 11 kërkesa për damkosje dhe prerje të drunjve të zjarrit për nevoja familjare, nga të cilët janë kërkuar 146 M3 drunj zjarri, ndërsa janë realizuar 42 M3. Duhet

cekur se viteve të fundit ka rënë shfrytëzimi dhe numri i kërkesave për prerje të drunjve të zjarrit në pyjet private.

- Nga Gjykata janë nxjerrë 87 Aktvendime për dëme nga prerësit ilegal të drunjve në pyjet e Njesisë “Pyjet e Malishevës” me dëme pyjore prej 108.20 M3 në vlerë monetare 17321.62 euro. Prej tyre 55 Aktvendime janë pozitive dmth dënuese, Aktvendime të pezulluara për shkak të parashkrimit janë 32, dhe negative nuk ka. Nga Gjykata për Kundërvajtje janë nxjerrë 49 Aktvendime dënuese dhe janë pezulluar 31 Fletëparaqitje. Ndërsa Gjykata Penale ka nxjerrë 6 Aktvendime dënuese, një Fletëparaqitje Penale është pezulluar.
- Nga Rojat e pyllit në vitin 2023 janë ngritë në Gjykatën për Kundërvajtje dhe në Prokurori 32 Fletëparaqitje për dëme në drunj nga prerësit ilegal, për dëmin e shkaktuar në M3 44.27 në vlerën prej 7078.00 euro.

Gjatë muajit dhjetor me vendim të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, është bërë kontroll i rregullt vjetore për evidentimin e dëmeve në “Pyjet e Malishevës”, sipas vendimit komisioni ka hartuar raport mbi të gjeturat në teren, ku në formë të përmbledhur japim në tabelën në vijim të dhënat për 5 (pesë) Rajonet e Njesisë;

Tabela 3: Të dhënat e gjetura në teren për 5 rajonet e njesisë.

Roja e pyllit	Rajoni	Demi i gjetur M3	Demi në euro	Nr i Fletpara.	Demi i M3 arsyetuar	Demi euro	Demi i paarsyetuar M3	Demi i paarsyetuar në euro
Fahredin Bytyqi	Cer1	14.68	1980.16	6	10.91	1667.88	3.77	317.28
Sheremet Berisha	Rrafshina	4.77	763.20				4.77	763.20
Naim Berisha	Bjeshka	27.32	4122.79	12	18.48	3037.77	8.84	1085.02
Sheremet Berisha	Mirusha	9.86	1449.20	4	4.95	792.00	4.91	675.20
Fahredin Bytyqi	Dubrava	16.07	2374.70	6	9.93	1588.80	6.14	785.90

Gjithsej dëmet e gjetura 72.70 M3 ose 10690.11 €, prej të cilave dëme të arsyetuara me ngritje të Fletëparaqitjeve nga rojet 44.27 M3 në vlerë prej 7078.45 euro, ndërsa dëme të paarsyetuara 28.43 M3 në vlerë 3626.58 euro. Duhet cekur se bashkëpunimi me drejtorit tjera si Drejtorin e Kadastrit dhe Inspektoratit në Komunë ka qenë në nivel sikurse me Agjencionin Pyjor të Kosovës - zyrën regjionale në Prizren, Inspektoratin qendror të pyjeve të Kosovës, e veçanërisht me Policinë e Kosovës- Stacioni Policor Malishevë si dhe me Shërbimin e Njesisë së Zjarrfikësve Malishevë

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Drejtoria e Shërbimeve Publike në këtë periudhë një vjeçare është angazhuar maksimalisht për kryerjen e detyrave të punës të parapara në kuadër të veprimtarisë së vetë në realizimin e projekteve sipas planifikimeve buxhetore, si dhe të parapara me ligjet në fuqi.

Si drejtori jemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave dhe ankesave në afat të parapara procedural që përcaktojnë ligjet, rregulloret dhe statuti i komunës.

Detyrat dhe projektet e parapara nga kjo drejtori për periudhën janar-qershor të vitit 2023 të realizuara dhe disa prej tyre janë në procedurë të realizimit (tenderimit) i paraqesim në formë të shkruar;

- Mbikëqyrja e ofrimit të shërbimeve publike lokale, duke përfshirë furnizimin me ujë, rrjetin e ujësjellësit, rrjetit të kanalizimit.
- Mbikëqyrja e operatorit ekonomik për shërbimet e automarimangës (zhvendosja dhe bllokimi i automjeteve).
- Mbikëqyrja dhe përkujdesja për shërbimin e dekorimit të qytetit për festa zyrtare.
- Mbikëqyrja e realizimit të shërbimeve që janë ofruar nga Bashkësia Islame në Malishevë sipas marrëveshjes së lidhur me datë: **12.05.2023** në mes Kryetarit të Komunës dhe kësaj bashkësie në Malishevë për heqjen e shpenzimeve të varrimit në afat prej një viti.
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me KEDS për rregullim të TS (trafostacioneve) të ri dhe rrjetit elektrik në fshatra.
- Në kuadër të projektit për Ngritjen e kapaciteteve për Menaxhimin e Mbeturinave, projekt ky i mbështetur nga JICA Japoneze, ka vazhduar Edukimi Mjedisor në 4 shkollat e përcaktuara nga ana grupit punues, shkollat i kanë kryer ligjëratat sipas orareve të përcaktuara nga vetë shkollat si dhe kanë filluar grumbullimin e materialeve të riciklueshme (kapakët e shisheve PET dhe kanaqet.)
- Vizita studimore në Japoni në JICA Tokyo ishte një mundësi shumë e mirë për të marrë njohuri të reja dhe na ka shërbyer shumë neve si zyrtarë për menaxhimin e mbeturinave gjithashtu edhe drejtorit të Shërbimeve Publike.
- Kemi mbajtur takime të rregullta mujore me stafin e JET për pilot projektet që aktualisht janë duke u zhvilluar. Me z. Kato kemi bashkëpunuar për Master Planin për MM, gjithashtu me z. Paulo kontakte të vazhdueshme lidhur me reformën e taksës për MM. Takime kam mbajtur edhe me koordinatoren znj. Senada duke na i dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me skedarin e përcaktuar për reformën e taksës pra të PP4.

Po ashtu edhe me znj. Kaëanishi ka vazhduar bashkëpunimi në kuadër të Edukimit Mjedisor.

- Kemi aprovuar Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave dhe kemi përcaktuar taksë të reja, në rregullore kemi parapara formimin e sektorit për MM

Kemi paraqitur nevojën për buxhet shtesë gjatë konsultave për rishikim të buxhetit me zyrën e buxhetit në kuadër të Drejtorisë së Financave.


- Kam hartuar edhe një organogram të sektorit, ku kemi paraqitur edhe pozitën e punës që mendojmë se duhet angazhuar, pra një staf të ri, i cili do të merret vetëm me çështjen e menaxhimit të mbeturinave.
- Në bashkëpunim me drejtorinë e Arsimit kemi përzgjedhur edhe 4 shkolla tjera për të aplikuar pilot projektin për Edukim Mjedisor.

Aktualisht jam duke punuar një Marrëveshje bashkëpunimi me Ekoregjonin në Prizren për listën e klientëve (pra bartjen e listës së klientëve).

- Në bashkëpunim me ekspertët Japonezë kemi nxjerrë rezultatet e ĒACS (Përbërjen e Mbeturinave) për komunën tonë, në vazhdim po e paraqesim në mënyrë grafike dhe tabelore përbërjen e mbeturinave për komunën e Malishevës;

Gjetjet mbi rezultatet e WACS

Përbërja reale embeturinave të përziera (Malishevë)



Gjetjet mbi rezultatet e WACS

Përbërja reale e mbeturinave të përziera (Malishevë)												
Sezoni	Dimër				Verë				Dimër dhe Verë			
Kategoria	Shtëpiake (ton/ditë)	Përcës shtëpiake (ton/ditë)	Total (ton/ditë)	Mesatarja e peshuar Përbërja	Shtëpiake (ton/ditë)	Përcës shtëpiake (ton/ditë)	Total (ton/ditë)	Mesatarja e peshuar Përbërja	Total (ton/ditë)	Përbërja e përgjithshme	Mesatare (ton/ditë)	Përbërja mesatare
Mbeturinat e kuzhinës	8.1	2.3	10.5	37.0%	6.0	3.2	9.2	30.1%	19.7	33.5%	9.8	33.5%
Letër	1.2	3.4	4.5	16.0%	1.9	3.4	5.4	17.6%	9.9	16.9%	5.0	16.9%
Tekstile	0.4	0.0	0.4	1.4%	0.7	0.0	0.7	2.2%	1.1	1.8%	0.5	1.8%
Mbeturinat e gjelbra (bimësia)	1.2	0.0	1.2	4.2%	0.8	0.1	0.9	2.9%	2.1	3.6%	1.0	3.6%
Bar/dru/bambu	0.0	0.0	0.0	0.0%	0.3	0.0	0.3	1.1%	0.4	0.6%	0.2	0.6%
Plastike	2.3	3.1	5.4	19.2%	4.4	3.8	8.2	26.7%	13.6	23.1%	6.8	23.1%
Gome/lëkurë	0.0	0.0	0.0	0.0%	0.0	0.0	0.0	0.0%	0.0	0.0%	0.0	0.0%
Metal	0.2	0.3	0.4	1.6%	0.3	0.8	1.1	3.5%	1.5	2.6%	0.8	2.6%
Shishe/xhama	0.7	0.4	1.1	3.9%	0.7	2.7	3.4	11.3%	4.5	7.7%	2.3	7.7%
Dheu/gurët/qera mika	0.0	0.3	0.3	1.1%	0.0	0.0	0.0	0.0%	0.3	0.5%	0.2	0.5%
Hiri nga pajisja e ngrohjes	0.5	0.0	0.5	1.7%	0.0	0.0	0.0	0.0%	0.5	0.8%	0.2	0.8%
Të tjera	3.5	0.4	3.9	13.9%	1.0	0.3	1.3	4.4%	5.3	8.9%	2.6	8.9%
Total	18.1	10.2	28.3	100.0%	16.2	14.2	30.5	100.0%	58.8	100.0%	29.4	100.0%
Mbeturinat e kuzhinës, mbeturinat e gjelbra dhe bari/druri/bambuja	9.3	2.4	11.7	41.3%	7.2	3.3	10.4	34.2%	22.1	37.6%	11.1	37.6%

Siç shihet nga rezultatet e nxjerra se komuna jonë gjeneron një sasi të madhe të plastikës pra, 23% e totalit të mbeturinave, prandaj jemi duke shqyrtuar mundësinë se si ta grumbullojmë në mënyrë të organizuar këtë sasi të plastikës duke bashkëpunuar me ndonjë biznes të interesuar.

- Bashkëpunimi me drejtorin e urbanizmit në hartimin,realizimin dhe mbikëqyrjen e projekteve në kuadër të veprimtarisë në fushën e shërbimeve publike si: rrugët, trotualet, furnizimit me ujë, kanalizimet e ujërave të zeza, ndriçimit publik, gjelbërimit etj.
- Janë dhënë vendime, pëlqime për hyrjen në bulevardin “Ibrahim Mazreku” si dhe vërtetime për student dhe raste sociale;
- Kemi bërë menaxhimin, kontrollimin dhe pastrimin e hapësirave publike, shesheve, varrezave të dëshmorëve, varrezave të maturanëve, si dhe pastrimin e rrugëve të qytetit me ujë sipas marrëveshjes nr: 01/645 datë 03.05.2023 në mes të KK-Malishevë dhe Ekorigjionin jugor - SH.A në afat njëvjeçar.
- Kemi bërë menaxhimin e kontratës me nr. Prokurimit 76, dhe nr. protokolli 03/144 e lidhur me datë 07/11/2022 nr. protokolli 62500-22-5456-1-2-1, me emërtim SHENJËZIMI I RRUGËVE DHE OBJEKTEVE PUBLIKE NË FSHATRAT DHE QYTETIN E MALISHEVËS me afat prej tri viteve.
- Hapjen e 75 bunarëve me shoqatën e QATAR CHARITY dhe Komunës së Malishevës.
- Ndërtimi i 10 shtëpive bashkëpunim në mes të shoqatës QATAR CHARITY dhe Komunës së Malishevës.
- Zbatimi i masave EE për OBS-01 i fituar për financimin nga FKEE dhe Komuna, ku 90% e financimit kryhet nga FKEE dhe 10% nga Kumuna e Malishevës.

- Strehimi i përkohshëm edhe i 3 familjeve në OBS-01 dhe 02.
- Hartimi i Rregulloreve për Transportin Publik Urban dhe të Mbeturinave.
- Është bërë largimi dhe pastrimi i mbeturinave inerte në hapësira publike në territorin e Komunës së Malishevës, janë kryer 105 pika.
- Kryerja e punëve të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushëveprimtarisë së drejtorisë.
- Dokumentet të lëshuara nga drejtoria me protokoll në zyrën pritëse dhe të brendshëm ;

1. Vërtetime -08

2. Vendime -04

3. Pëlqime -06

4. Njoftime -63

5. Raporte -36

6. Kërkesa - 427

7. Aktvendime -09

8. Autorizime -01

9. Të ndryshme – 55

10. Formular aplikimi - 33

Të gjitha dokumentet si tërësi janë: 642.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN JANAR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Në fillim të muajit janar kam përgatitur dhe dorëzuar planin e punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2023 dhe kam dorëzuar raportin një vjeçar të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022.

Së bashku me zyrtarët kemi bërë përgatitjet për përzgjedhjen e laureatëve të vitit 2022 në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kemi bërë shpalljen publike në të cilën klubet letrare, sportive, OJQ-të rinore kanë bërë propozimet e tyre dhe sipas komisionit të formuar është bërë edhe përzgjedhja e më të mirëve në keto fusha për vitin 2023

Më 20/01/2023, bashkë me zyrtarin e kulturës Kushtrim Morina dhe zyrtarin e sportit Albert Morina, kemi vizituar disa objektë të Trashëgimisë Kulturore me qëllim të informimit të pronarëve, poseduesve dhe shfrytëzuesve të asetit të Trashëgimisë Kulturore që janë në Mbrotjtje të Përkohshme të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2022/2023.

Gjatë kësaj vizite kemi takuar pronarët e asetëve , përfaqësuesit e fshatrave dhe kemi shpërndarë disa njoftime informuese për përgjegjësitë ndaj asetëve të trashëgimisë kulturore, bazuar në Ligjin Nr. 02/L-88 PËR TRASHËGIMIN KULTURORE.

Njoftimet janë pranuar dhe nënshkruar nga pronarët e asetëve që janë në pronësi private dhe nga përfaqësuesit e fshatrave që janë në pronësi shoqërore.

Bashkë me zyrtarin e kulturës Kushtrim Morina kemi pritur përfaqësuesit nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore - Prizren, ky takim u realizua me qëllim të dorëzimit të kopjeve të njoftimeve informuese të pranuar dhe nënshkruara nga pronarët dhe përfaqësuesit e fshatrave në lidhje përgjegjësitë e pronarëve dhe shfrytëzuesit të asetëve të trashëgimis kulturore që janë në mbrotjtje të përkohshme.

Në këtë takim u informuam se çdo vitë nga Qendra Rajonale e Trashëgimis Kulturore do pranojm njoftime informuese për listën e astëve tjera që janë në mbrotjtje të përkohshme dhe të njejtat do të pranohen nga poseduesit, pronaret dhe perfaqësuesit e asetëve.

Në janar 2023, kemi filluar me përgaditjet për “Flakën e Janarit” , kemi konkretizuar agjendën e programit në tërësi dhe kam përgatitur ftësat.

Shënimi i Flakës së Janarit- sipas agjendës janë vënë vënë buqeta me lule të vendi i rënies, më pas Homazhe dhe nderime tëk varri i dëshmorit Hysni Mazreku-Malishevë dhe Homazhe dhe nderime tëk varri i dëshmorit Ali Kryeziu – Bubavec. Gjithashtu, për të nderuar “Flakën e Janarit” kemi organizuar orë letrare në sallën e kuvendit komunal.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN SHKURT - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Më 11 shkurt, kemi nisur përgatitjet dhe planifikimin për shënimin e 15-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Kemi diskutuar për mënyrën e shënimit të kësaj ditë, si dhe kemi konkretizuar agjendën aktivitetëve për shënimin e kësaj ditë.

Më 15 shkurt, kemi bërë shpërndarjen e ftesave dhe agjendën e aktivitetëve me rastin e shënimit të 15-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ftesat i kemi shpërndarë tek Stacioni Policor në Malishevë, Shoqatat e dala nga Lufta e UÇK-së dega në Malishevë, Kryqi i kuq, HANDIKOS, LMT KFOR, QKMF, Shoqata e Pensionistëve, Bashkësia Islame, etj.

Më 17 shkurt, është shënuar 15-vjetori i Pavarësisë së Kosovë, aktivitetet kanë filluar sipas agjendës, mbledhja solemne më pas nderime para Shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Malishevë, homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe në Kleçkë, vizitë në Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz. Gjithashtu, kemi organizuar edhe transportin dhe drekë për familjet e dëshmorëve.

Në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” është mbajtur sesion informues për trashëgiminë kulturore të Kosovës që nga periudhat prehistorike-moderne. Ky projekt është i mbështetur nga MKRS në bashkëpunim me DKRS.

Gjithashtu, është mbajtur punëtorja për trajnimin “Edukimi i grave të reja mbi feminizmin” që është organizuar nga ARTPOLIS dhe KVRL dhe DKRS në Malishevë.

Në muajin shkurt për nder të shënimit të 15-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës është organizuar turnir Sportiv në Volejboll.

Më datë 15.02.2023, së bashku me Klubin e Volejbollit Malisheva, është organizuar turniri në Volejboll, për nder të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Turniri është organizuar në shkollën "17'Shkurti" në Banjë të Malishevës ku pjesëmarrës ishin këto klubet:

- 1."KV MALISHEVA"- Malishevë
- 2."KV FERONIKELI"- Drenas
- 3."KV THERANDA"- Suharekë
4. "KV VLLAZNIMI"- Gjakovë

Fitues në këtë Turnir:

Vendi i parë--- "KV FERONIKELI"

Vendi i dytë--- "KV MALISHEVA "

Vendi i tretë--- "KV VLLAZNIMI"

Fituesit në fund u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjithashtu komuna e Malishevës së bashku me DKRS ka mbuluar shpenzimet e ushqimit për ekipet pjesëmarrëse.

Në këtë turnir ishte prezent edhe unë si drejtor i DKRS-së të cilët i përshëndeta të pranishmit dhe ekipet pjesëmarrëse në këtë Turnir të Pavarësisë.

Aty theksova se Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport vazhdimisht i ka përkrahur klubet sportive dhe aktivitetet sportive, por synohet që në të ardhmen kjo mbështetje të jetë edhe më e madhe.

Gjithashtu i urova të pranishmit për 15- vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 50 Sportistë, ndërsa numri i shikuesve 200.

Më 23 shkurt, së bashku me zyrtarin e kulturës Kushtrim Morina dhe zyrtarin e sportit Albert Morina ishim në takim në Drejtorinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit të komunës së Dragashit, në këtë takim u pritëm nga Drejtoresha e DKRS-së Liridona Misinaj, ku dhe diskutuam për shumë çështje të ndryshme në fushën e kulturës, rinis dhe sportit. Si komuna fqinje diskutuam edhe rreth bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ideve në fushën e kulturës, rinis dhe sportit.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN MARS - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Më 1 mars, kemi nisur përgatitjet dhe planifikimin për shënimin e Epopesë së UÇK-së.

Është mbajtur takimi i parë me këshillin organizativ për shënimin e Epopesë së UÇK-së, në këtë takim të këshillit kemi diskutuar për mënyrën e shënimit të kësaj ditë, si dhe kemi konkretizuar agjendën e aktiviteteve për shënimin e kësaj ditë.

Më 2 mars, kemi filluar me përgatitjet e agjendës dhe të ftesave, më pas kemi bërë shpërndarjen e ftesave te familjaret e dëshmorëve dhe në institucione në Komunën e Malishevës.

Më 5,6,7 mars, në kuadër të shënimit të manifestimit “Epopëja e UÇK-së”, kemi organizuar aktivitete të ndryshme. Aktivitetet kanë filluar me seancë solemne më pas janë bërë nderime pranë shtatores së Komandantit Legjendar “Adem Jashari” në Malishevë, homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe në Prekaz. Gjithashtu, kemi organizuar transportin dhe drekë për familjet e dëshmorëve.

Aktivitetet e manifestimit “Epopëja e UÇK-së” janë përmbyllur me ndezjen e flakadanëve në kompleksin “Kodra e UÇK-së” në Ngucat.

Më 29 mars, kam përgatitur dhe shpërndarë agjendën dhe ftesat me rastin e shënimit të 24-vjetorit të masakrës së Burimit.

Më 31 mars, sipas agjendës është mbajtur një mbledhje përkujtimore dhe janë bërë homazhe në Kompleksin Memorial në vendin e ngjarjes (Vrella e Mëhillit) në fshatin Burim, dhe më pas homazhe te varrezat e martirëve në Dragobil.

Gjithashtu, në kuadër të shënimit të Epopesë së UÇK-së është bërë përrurimi i librit “Lule Lirie” i autorit Agron Krasniqi.

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara për shënimin e "Epopesë së UÇK- së", është organizuar turniri në futboll të femrave.

Ky aktivitet sportiv është organizuar në bashkëpunim me klubin e futbollit KFF “Malisheva”, dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Në këtë turnir morën pjesë 3 ekipe nga komuna jonë.

Ekipet pjesëmarrëse në turnir ishin:

KFF “Malisheva”

KFF “Shqiponja”

KFF “16 Qershori”

Fitues i këtij turniri ishte KFF “16 Qershori”

Në këtë turnir së bashku me zyrtarin e sportit Albert Morina dhe zyrtarin Kushtrim Morina kemi qenë të pranishëm dhe kemi përcjellë për së afërmi këtë turnir. Pjesëmarrësit i përshëndeta dhe i urova ekipet pjesëmarrëse në turnirin që është organizuar për nder të Epopesë së UÇK-së, që mbahet me 5-6 dhe 7 Mars.

Fituesit në fund u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjithashtu kemi mbuluar edhe shpenzimet e ushqimit për ekipet pjesëmarrëse.

Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 54 Sportistë, ndërsa numri i shikuesve 100.

Gjatë këtij muaji në kuadër të aktiviteteve të drejtorisë, e kemi vizituar stadiumin e qytetit “Liman Gegaj” në Malishevë, me qëllim të njoftimit me punimet që janë duke u realizuar në stadiumin e qytetit, përkatësisht në ndërtimin e tribunave dhe zhveshtoreve në stadium.

Pas njoftimit me punimet që janë duke u realizuar në stadium, kam kërkuar nga ana e operatorit, që të intensifikoj punimet në ndërtimin e zhveshtoreve dhe pjesës së tribunës, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira dhe sipas standardeve të kërkuara, për zhvillimin e garave sportive.

Kam realizuar takim me drejtorin e departamentit të infrastrukturës sportive në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku kemi diskutuar për projektet e nevojshme në komunën e tonë, me theks të veçantë ndërtimin e tribunave të stadiumit, të cilat janë në ndërtimin e punimeve të vrazhda.

Gjatë muajit mars kanë filluar garat komunale shkollore 2023.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, i ka përkrahur të gjitha aktivitetet sportive që janë pasqyruar në këtë raport. Numri i pjesëmarrësve të përfshirë në aktivitetet është rreth 300.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN PRILL - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Janë mbajtur garat regjionale në futsall që është mbështetur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nga thirrja publike 2023. Së bashku me zyrtarin e sportit Albert Morina kam marrë pjesë në këto gara dhe kam bërë shpërndarjen e mirënjohjeve, të kupave dhe të medaljeve për shkollat fituese. Shkollat fituese në garat regjionale në futsall nga komuna e Malishevës kanë marrë pjesë në garat rajonale në Gjakovë. Në këto gara kanë arritur të nxënë vendet e para ekipi i femrave i SHFMU “Visar Krasniqi” nga Drenoci dhe ekipi i femrave SHML “Hamdi Berisha” nga Malisheva.

Kam pasur takim me OJQ-të Kulturore, Rinore dhe Sportive ku kemi diskutuar për problemet me të cilat ballafaqohen ata, idetë e tyre për aktivitete të ndryshme në komunën e tonë si dhe kemi diskutuar edhe për disa kriteret të cilat i kemi punuar për Thirrjen Publike për subvencionim të OJQ-ve.

Gjatë muajit prill kam përgatitur kriteret për thirrjen publike për subvencionim të OJQ-ve, ku edhe i kam rekomanduar kryetarit të komunës z. Ekrem Kastrati që thirrjen publike ta bëjë mbi bazën e atyre kriterëve në mënyrë që të kemi ndarje sa më të mirë të subvencioneve për klubet sportive, organizatat kulturore e rinore që veprojnë në komunën tonë. Gjithashtu kam punuar në përgatitjen e shkresave, kërkesave të ndryshme që lidhen me thirrjen publike. Pas gjithë këtyre punëve kemi arritur që në muajin prill të bëjmë edhe shpalljen për thirrje publike e cila është hapur me datë 21.04.2023 dhe mbyllet me datë 16.05.2023 në ora 16:00. Thirrja publike për subvencionimin të OJQ-ve është bërë në bazë të rregullores së MF, nr.04/2017 mbi kriteret dhe standardet dhe procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Gjithashtu, siç është e përcaktuar edhe me rregullore kemi bërë edhe shpalljen publike për Ekspert të Jashtëm për Komisionin Vlerësues për shqyrtim të projekt propozimeve nga OJQ-të. Po ashtu kemi formuar edhe komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve për thirrjen publike për ekspert të jashtëm.

Kemi pranuar dhe shqyrtuar shumë kërkesa nga klubet sportive dhe organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në komunën e Malishevës, ku disa prej tyre i kemi rekomanduar për zyre të kryetarit dhe ministrisë së kulturës.

Si DKRS kemi filluar përgatitjet për organizmin e ditës së çlirimit të komunës së Malishevës që është më 16 qershor. Kemi bërë kërkesë për binë, zërim dhe elementet tjera të cilat nevojiten për organizimin e 16 qershorit (akademinë solemne, ndarjen e çmimeve, konkurset pamore letrare e artistike si dhe organizmin e koncertit festiv që planifikohet të mbahet në parkun e qytetit me artistë të mirënjohur).

Gjatë muajit prill kanë filluar garat regjionale shkollore në futsall, ku si Malishevë e kemi pasur nderin që garat regjionale të organizohen në komunën tonë.

Gjatë këtij muaji është bërë përrurimi i librit “Kujtesa Historike-Histori, rrëfime e dëshmi 1981-1999” e autorit Demush Krasniqi.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN MAJ - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Së bashku me zyrtarin e rinisë z. Mehdi Krasniqi, kam zhvilluar takim me drejtorin e Departamentit të Rinisë pranë Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Xhevat Bajrami. Me drejtorin z. Bajrami kemi diskutuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet DKRS-së dhe DiR-it në të mirë të rinisë. E kam njoftuar për aktivitetet rinore që kemi planifikuar t'i realizojmë për këtë vit me OJQ-të rinore në komunën e Malishevës.

Me 5 maj, kemi mbajtur takimin e dytë me përfaqësuesit e OJQ-ve Kulturore, ku diskutuam për organizimin e aktiviteteve dhe Ekspozitën Artistike që tashmë është tradicionale për çdo manifestim të 16 qershorit- Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të UÇK-së.

Në këtë takim ishim 6 pjesëmarrës.

Në maj, kemi nisur përgatitjet dhe planifikimin për shënimin 16 Qershorit -Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Malishevës. Kemi konkretizuar agjendën aktiviteteve për shënimin e kësaj dite. Po ashtu kemi përgatitur dhe publikuar konkursin artistik në lëmin e artit pamor, letrar dhe muzikor. Kam pasur takim me këshillin organizativ të 16 qershorit

Gjatë këtij muaji kam pasur takime me disa nga përfaqësuesit e klubeve sportive ku është diskutuar për çështje të ndryshme sportive, kemi biseduar për vështirësitë me të cilat përballen këto klube sportive të cilat bëjnë gara në nivele të ndryshme garuese.

Së bashku me kryetarin e komunës z. Ekrem Kastrati kam marrë pjesë në garat e kupës së Kosovës në Atletikë e cila është mbajtur në stadiumin e qytetit “Liman Gegaj” në të cilën klubi i Atletikës Malisheva fitoi vendin e parë.

Kemi bërë përgatitjet për turnirin tradicional “Ibrahim Mazreku” në futboll të vogël që mbahet më 16 qershor. Gjatë këtij muaji kam bërë përgatitjen e kontratave për të gjitha OJQ-të, të cilat kanë përfituar nga thirrja publike e cila është shpallur nga DKRS.

Gjatë muajit maj është mbajtur turniri tradicional “Ngucati nderon dëshmorët” të cilin e ka mbështetur financiarisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN QERSHOR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Më 1 qershor, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, kemi organizuar festival të këngëve dhe valleve për fëmijë, në bashkëpunim me SHKA “ODA E KIJEVËS”. Festivali është organizuar në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë.

Të pranishëm për ta shikuar këtë shfaqje teatrale ishin rreth 400 fëmijë.

Kam takuar përfaqësues nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, konkretisht me drejtorin e QRTK-së z. Samir Hoxha dhe kemi bërë kërkesë për restaurimin e mullirit të Syl Sahitit në fshatin Ngucat.

Më 15 qershor, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës, janë zhvilluar aktivitete kulturore dhe sportive.

Aktivitete të shumta janë zhvilluar për nder të Ditës së Çlirimit dhe Dëshmorëve të Komunës së Malishevës:

Orë letrare, ky aktivitet u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës, ku të pranishëm në këtë orë letrare ishin rreth 50 persona.

Konkurs në poezi, rezultatet janë shpallë gjatë orës letrare.

Konkurs në artin pamor.

Ekspozita artistike, kjo ekspozitë kolektive u organizua në Muzeun e Qytetit “Jahir Mazreku” në Malishevë. Në këtë Ekspozitë morën pjesë shumë Artistë dhe artdashës të artit pamor me gjithsej 23 punime dhe pas vlerësimit të komisionit me vendin e parë u vlerësua punimi i z. Rinor Jetullahu, me vendin e dytë u vlerësua punimi i z. Arijon Krasniqi dhe me vendin e tretë u vlerësua punimi i z. Nderim Bytyqi. Të pranishëm në hapjen e kësaj ekspozitë kolektive ishin rreth 50 persona.

Gjithashtu, u mbajt edhe konkursi dhe publikimi i rezultateve në fushën e muzikës.

Më 16 qershor, shënimi i Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të komunës së Malishevës, ka nisur me vizitën dhe vendosjen e buqetave me lule të varrezat e Dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz.

Është mbajtur aktiviteti “Marshojmë për Ditë të Çlirimit”, është mbajtur me të gjitha institucionet lokale nga komuna deri të varrezat e dëshmorëve në Malishevë.

Parakalimi i grupit të motoçiklistëve në qytet për nder të Ditës së Çlirimit.

Pas homazheve kemi vazhduar me mbledhjen solemne të Kuvendit Komunal, Akademisë Përkujtimore, ndarjen e çmimeve tradicionale të kuvendit komunal, programin kulturorë-artistik që është mbajtur në Bulevardin “Ibrahim Mazreku” në Malishevë. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm të gjithë strukturat lokale, familjet e Dëshmorëve dhe mysafir të shumtë brenda dhe jashtë vendit. Për të nderuar këtë datë historike dhe për të pasuruar edhe më shumë këtë aktivitet me programin e tyre artistik ishin Ansambli “Dibra”, artisti Basri Lushtaku dhe artistë të ndryshëm. Në këtë aktivitet të pranishëm ishin rreth 1000 pjesëmarrës.

Pas tubimit qendror kemi vazhduar me program në Bulevardin Ibrahim Mazreku, në të cilin kanë marrë pjesë këngëtar , Shoqëri Kulturore Artistike dhe grupe të ndryshme të muzikës, këngëtarë të njohur të vendit tonë. Gjatë kësaj mbrëmje, janë argëtuar rreth 3000 qytetarë të ndryshëm përfshirë të gjitha moshat.

Në mbrëmje është mbajtur koncert festiv për të rinjtë, për nder të Ditës së Çlirimit dhe Dëshmorëve të komunës së Malishevës.

Për nder të 16 Qershorit ditës së Çlirimit dhe ditës Dëshmorëve të Malishevës në bashkëpunim me klubin e futbollit të femrave “16 Qershori” është mbajtur turnir në stadiumin “Liman Gegaj” Malishevë, ku pjesëmarrës ishin 7 ekiye nga vende të ndryshme.

Për nder të 16 Qershorit ditës së Çlirimit dhe ditës Dëshmorëve të Malishevës në bashkëpunim me klubin e Ping-Pongut “Llapusha” është mbajtur turnir në palestrën sportive “Habib Zogaj” në Malishevë, ku pjesëmarrës ishin garues nga vende të ndryshme, në fund të turnirit fitues i vendit të parë doli Afrim Velu nga klubi i Ping-Pongut “Llapusha”, në fund fituesit u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Për nder të 16 Qershorit ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës në bashkëpunim me klubin e Futsallit “Malisheva” është organizuar turnir në futboll të vogël për meshkuj në qendrën sportive “Fusha Jonë” në Lubizhdë ku pjesëmarrës ishin 75 ekiye nga vend të ndryshme të Kosovës.

Fituesit në fund u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Po në këtë ditë, është zhvilluar një miqësore në futboll ndërmjet komunës së Malishevës dhe të Komunës së Klinës.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, i ka përkrahur të gjitha aktivitetët kulturore, rinore dhe sportive që janë realizuar gjatë muajit qershor.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN KORRIK - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Gjatë këtij muaji me kërkesën tonë dhe aprovimin e kryetarit kemi nxjerrë vendimin për themelimin e këshillit organizativ për organizimin dhe manifestimin e Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës” që do të mbahet më 1 dhe 2 gusht 2023.

Këshilli organizativ ka pasur këtë përmbajtje:

1. Fitim Shala – Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
2. Mehdi Krasniqi – Zyrtar për Rini,
3. Albert Morina – Zyrtar për Sport,
4. Enver Mazreku – Zyrtar në drejtorinë për Arsime dhe Edukim,
5. Blerta Krasniqi – Shefe e kabinetit të kryetarit,
6. Zymer Zogaj – Zyrtar në Muze,
7. Valentina Krasniqi – Zyrtare në drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Këshillin organizativ të Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës” e kam udhëhequr unë si drejtor i DKRS-së.

Gjatë këtij aktiviteti kemi paraparë edhe organizmin e panairit artizanal dhe së bashku me OJQ “Fatjona” kemi bërë të gjitha përgatitjet që panairi të mbahet më 1 dhe 2 gusht dhe që do të paraprijë festivalit folklorik “Oda e Llapushës”.

Po ashtu, në muajin korrik kam filluar përgatitjet edhe për festivalin rinor “MAL FEST” i cili do të organizohet për herë të parë në komunën tonë, së bashku me OJQ-të në komunën tonë dhe në bashkëpunim me biznese të shumta brenda dhe jashtë komunës sonë.

Gjatë këtij muaji kam qenë në takim me Drejtorin e kompanisë Golden Eagle në Suharekë, me të cilin kemi biseduar lidhur me organizmin e festivalit “MAL FEST” dhe kompania në fjalë ka qenë sponsori gjeneral i festivalit. Po ashtu, takime kam pasur edhe me sponsoret e tjerë të festivalit, siç janë: Stonë Castle, Kastrati, Kështjella etj.

Ky festival ka karakter rinor dhe do të përcjelljet me aktivitete të tjera rinore, siç janë: ekspozita me fotografi, gara në rrjetë sociale për fotografimin më të mirë. Gjithashtu, në këtë festival biznese të shumta do të jenë prezentë me pijet dhe ushqimet e tyre. Ky festival do të mbahet në parkun e qytetit me datë 3 dhe 4 gusht.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN GUSHT - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Me 1 gusht, krahas Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës”, për dy ditë është hapur edhe panairi me punë artizanale, i cili këtë është organizuar në hapësirat e oborrit të Muzeut të Qytetit në këtë panair janë prezantuar punimet e dorës në veshje, si dhe të ushqimeve tradicionale.

Panairi është organizuar nga shoqata e gruas “Fatjona” në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte afër 20 pjesëmarrës, ndërsa numri i vizitorëve ishte rreth 2600 vizitorë.

Më 1 dhe 2 gusht, kemi organizuar Festivalin Folklorik “Oda e Llapushës”– edicioni i tetë, një festival me karakter garues gjithëkombëtar, në këtë festival u prezantuan vlera të larta të folklorit shqiptar, ku morën pjesë rapsod të shumtë, Shoqëri kulturo-artistike, Ansamblet e këngëve dhe valleve nga të gjitha trevat shqiptare dhe diaspora.

Festivali filloi me defileun artistik, të grupeve, shoqërive kulturore-artistike, rapsodëve. Defileu ka nisur në orën 18:00, duke filluar nga Rruga “Hamdi Berisha” pranë KEDS-it deri të Sheshi i Dëshmorëve në qendër të qytetit. Nata e parë e festivalit filloi në orën 19:00, ku u prezantuan 12 pikët pjesëmarrëse përfshirë rapsodë, grupe, ansamble kulturore.

Në natën e dytë juria profesionale ka bërë ndarjen e çmimeve fituese të festivalit.

Juria profesionale e cila përcjelli dy net radhazi Festivalin Folklorik “Oda Llapushës”- edicioni VIII, pasi dëgjoi me vëmendje pikat muzikore të cilat u prezantuan në këtë festival, nga solistë, duete, trio, kuartet solistësh dhe grupe e ansamble nga hapësirat shqiptare.

Gjatë këtij muaji, më datë 12 dhe 13 gusht është mbajtur Festivali Rinor “MALFEST”. Ky festival është mbajtur në parkun e qytetit në Malishevë dhe gjatë këtyre dy ditëve kanë përforcuar artistë të ndryshëm, brenda dhe jashtë komunës sonë. Gjatë këtij festivali pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë edhe të shërbimit me pije dhe ushqim, në të cilin kanë qenë prezentë sponsorët tanë.

Festivali ka pasur edhe karakter kulturor, është mbajtur një ekspozitë me disa nga ikonat e muzikës në Malishevë dhe është mbajtur një takim debatues për fotografinë në përgjithësi. Ky festival “MAL FEST” është mbajtur për herë të parë në komunën e Malishevës dhe në të ka pasur pjesëmarrës të shumtë.

Në kuadër të festivalit “MAL FEST” është mbajtur një konkurs më fotografi të bukurive natyrore dhe të trashëgimisë kulturore të komunës së Malishevës. 3 vendet e para janë shpërblyer edhe me mjetë financiare.

Gjatë festivalit “MAL FEST” është realizuar edhe ekspozita artistike nga Arijon Krasniqi. Kjo ekspozitë është realizuar në mbështetje të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në kuadër të thirrjes publike për subvencionimin e OJQ-ve rinore, kulturore e sportive të komunës së Malishevës.

Gjithashtu, gjatë këtij muaji është mbajtur edhe organizimi për manifestimin e 25-vjetorit të Dëshmorëve të Kombit, Dita e Brigadës 121 “Kumanova” në fshatin Kleçkë.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN SHTATOR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Më 15 dhe 16 shtator 2023, organizuar nga KVRL dhe mbështetur nga DKRS është mbajtur Kampi Rinor 2023. Në këtë kamp janë zhvilluar aktivitetet me karakter garues, lojëra të ndryshme dhe është mbajtur një ligjëratë nga përfaqësuesi i Kryqit të Kuq, z. Isuf Morina.

Është mbajtur Akademi Përkujtimore për të përkujtuar civilët e vrarë në masakrën e Gollubovcit. Po ashtu, janë bërë edhe homazhe te varrezat.

Në komunën e Malishevës është festuar Dita e Rinisë dhe janë mbajtur aktivitete të shumta.

Është organizuar konkurs në poezi për të rinj.

Konkurs në ese.

Konkurs në artin pamor.

Gjatë këtij muaji janë mbajtur ligjërata për parandalimin e bullizmit të të rinjtë e komunës së Malishevës. Aktiviteti në fjalë është mbajtur në shkollat e mesme të komunës së Malishevës. Ky aktivitet është mbajtur në bashkëpunim me Organizatën Joqeveritare rinore “Feniksi”.

Në muajin shtator është mbajtur akademi përkujtimore për masakrën e Gollubovcit. Gjithashtu, janë bërë edhe homazhe nderimi të varrezat e civilëve në Gollubovc.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN TETOR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Është bërë zbulimi i bustit të Nexhmije Pagarushës në Pagarushë. Gjithashtu, pranë këtij busti është përruruar edhe parku kushtuar artistes Nexhmije Pagarusha.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka bërë organizimin e Akademisë Përkujtimore dhe është shfaqur program artistik me artistë të ndryshëm nga gjithë trevat shqiptare.

Gjatë muajit nëntor kam marrë pjesë në Konferencën për Rini “Dreamin Kosovo” që është mbajtur në Prizren. Në këtë konferencë me karakter rinor kanë marrë pjesë përfaqësues rinorë nga komuna të ndryshme të Kosovës, gjithashtu edhe përfaqësues rinorë ndërkombëtar. Organizatori i kësaj konference ka nderuar komunën e Malishevës me mirënjohje për kontributin e dhënë për rini.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN NËNTOR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Gjatë këtij muaji është realizuar ngjarja më e madhe sportive e mbajtur ndonjëherë në Malishevë, mbrojtja e titullit të botës në Muay Thai, e cila është mbajtur në Palestrën Sportive “Habib Zogaj” në Malishevë. Sportisti nga Komuna jonë z. Luan Rudaj në këtë mbrojtje të titullit është shpallur kampion botë në Muay Thai. Në këtë ngjarje madhështore kishte shumë mysafir nga shumë vende të botës dhe numri i pjesëmarrësve ishte rreth 1500.

Gjithashtu, në këtë muaj kemi mbajtur ligjërata me të rinjtë e komunës së Malishevës për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës. Kjo ligjëratë është mbajtur në bashkëpunim me Organizata Joqeveritare rinore nga komuna e Malishevës.

Kemi mbajtur aktivitete kulturore, rinore e sportive për nder të 28 nëntorit. Fillimisht kemi mbajtur seancë solemne në Asamblenë Komunale. Gjithashtu, janë bërë edhe homazhe nderimi të Varrezat e Dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz.

Gjatë këtij muaji, në bashkëpunim me organizatën lokale Health of Nature in Kosovo është mbajtur aktivitet vetëdijësues për rëndësinë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në kuadër të festave të Nëntorit është bërë pranim dorëzimi i mbi 500 ekzemplarë librash në bibliotekën e SHFMU “Asim Vokshi” në Panorc. Aksioni për grumbullimin e librave e ka bërë zyrtari për rini dhe ushtruesi i detyrës së zyrtarit të kulturës z.Mehdi Krasniqi.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN DHJETOR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Organizuar nga Qendra e Rinisë dhe mbështetur nga DKRS, janë mbajtur ligjërata për vullnetarizmin në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” dhe në Gjimnazin “Hamdi Berisha”. Në këtë ligjëratë të rinjtë janë njohur me mënyrën se si organizohet puna vullnetare dhe përfitimet nga kjo punë. Të rinjtë janë pajisur me certifikata të pjesëmarrjes në ligjëratë. Ky aktivitetet është mbështetur nga DKRS nëpërmjet Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ-ve.

Në këtë muaj është mbajtur Orë letrare në bashkëpunim me SHKL “Tafil Kelmendi. Aktiviteti është mbajtur në sallën e asamblesë komunale.

Në këtë muaj, në bashkëpunim me Qendrën e Rinisë kemi organizuar aktivitet “Të rinjtë në zyrat e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport”. Të rinjtë kanë kryer praktikë njëditore në zyrat e DKRS dhe janë njoftuar për së afërmi me punën njëditore të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Malishevës.

Gjatë këtij muaji kanë përfunduar punimet për rinovimin e Palestrës Sportive “Habib Zogaj” në Malishevë. Është bërë ndërrimi i çatisë, dritareve, izolimi i mureve të jashtme, ndriçimi i palestrës si dhe ngrohja e palestrës. Ky investim është bërë nga komuna e Malishevës në bashkëpunim me Fondin Kosovar për Eficienc.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe ka qenë bartëse e aktiviteteve në përgatitjen dhe menaxhimin e emergjencave në territorin e Komunës së Malishevës dhe e cila ka menaxhuar dhe koordinuar me sektorët varës në kryerjen e punëve dhe detyrave të parashtruara sipas Planit të Punës për vitin 2023, në përputhshmëri me ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret që janë në fuqi. Të gjithë sektorët e kësaj drejtorie i kanë kryer punët dhe detyrat e parapara me kohë dhe me sukses.

Gjatë muajit Janar gjendja në territori e komunës së Malishevës ka qenë e qet, me disa raste intervenimi nga NJPZSH.

1. Intervenime; zjarr në objekte ndërtimore
2. Zjarre në pajisje elektronike- 2 raste
3. Zjarre në oxhaqe-1 rast
4. Zjarre në ushqim bagëtish-stalla-3 raste
5. Zjarre në automjete- 1 rast
6. Zjarre në kontejnerë dhe mbeturina-1
7. Intervenime teknike-1
8. Aksidente në komunikacion-2
9. Vërshime-3

Muaji Shkurt, edhe gjatë muajit shkurt drejtoria Mbrojtje dhe shpëtim ka qenë e angazhuar në raste intervenimi, vlen të ceket se në të gjitha rastet e intervenimit nuk kemi pasur raste me fatalitet, për kundër gjithë kësaj drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka qenë e përgatitur për interveni në të gjithë territorin e komunës së Malishevës.

1. zjarre në objekte ndërtimore-3
2. zjarre në pajisje elektrike-1
3. zjarre malore-4
4. zjarre fushore-7
5. zjarre në oxhaqe- 1
6. zjarre në kontejnerë dhe mbeturina-4
7. zjarre tjera-1
8. aksidente komunikacioni-1
9. zjarre në automjete- 2

Gjithsej raste intervenimi në muajin shkurt drejtoria Mbrojtje dhe Shpëtim ka intervenuar në 24 raste në të cilat nuk kishte raste me fatalitet, por vetëm dëme të konsiderueshme.

Gjatë muajit Mars drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka qenë e ngarkuar me punë në teren, ku si pasojë e temperaturave të larta, ka pasur edhe raste zjarri ku kemi pranuar telefonata nga qytetarët, me të marrë informacion ekipet e zjarrëfiksive kanë reaguar në kohë dhe kanë arritur ta shuajnë zjarrin pa shkaktuar dëme në njerëz apo edhe gjera materiale, konkretisht zjarret kanë ndodhur në zonat fushore-malore, ku si pasojë edhe nga pakujdesia e qytetarëve ka ardhur deri te zjarri.

1. Zjarre në objekte ndërtimore-3
2. Zjarre në pajisje elektrike-1
3. Zjarre malore-3
4. Zjarre fushore-2
5. Zjarre në ushqim bagëtitish-1
6. Zjarre në automjete-1
7. Intervenime teknike- 2

Gjithsej raste intervenimi drejtoria ka kryer 13-raste intervenimi.

Gjatë kësaj periudhe të muajit Mars, gjithashtu kemi përgatitur dhe e kemi dorëzuar kërkesën për fillimin e inicimit të procedurave për, spërkatjen e zonave të cilat janë të rrezikuara nga, ethet Hemoragjike, (Rriqrat)

Në muajin prill kemi pasur gjithsej 3 raste intervenimi;

1. zjarre në objekte ndërtimore
2. zjarre në pajisje elektrike
3. zjarre malore

Në muajin maj drejtoria ka pasur 6 raste intervenimi;

1. zjarre në pajisje elektronike
2. Zjarre në automjete-1
3. Zjarre në kontejnerë-2
4. Intervenime teknike-1
5. Vëzhgimi në terren-1

Muaji qershor ka qenë i qetë dhe me raste intervenimi, fatmirësisht pa dëme të konsiderueshme.

Gjatë muajit qershor kemi pasur gjithsej 10 raste intervenimi;

1. Zjarre në objekte ndihmëse-2 raste

2. Zjarre në paisje elektrike-1 rast
3. Zjarre në ushqim bagëtish-stalla-1 rast
4. Zjarre në kontejnerë-2 raste
5. Intervenime teknike-1 rast
6. Shërbime me pompë uji-2
7. Thirrje të rrejshme kemi pasur-1 rast

Muaji korrik ka qenë i ngarkuar me raste intervenimi, drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka qenë në nivelin e detyrës dhe me sukses ka arritur të bëjë interveniminin në kohe ku ka shmangur çdo mundësi që të ketë pasoja të rënda.

1. Zjarre në objekte ndihmëse-1 raste
2. Zjarre në paisje elektrike-2 raste
3. Zjarre malore-1 raste
4. Zjarre fushore-15 raste
5. Zjarre në automjete-2 raste
6. Zjarre në kontejnerë- 4 raste
7. Intervenime teknike-3 raste
8. Aksidente në komunikacion-3 raste

Rastet gjatë muajit korrik kanë qenë gjithsej 31 raste intervenimi.

Raste në muajin gusht janë rritur për shkak të temperaturave të larta të cilat e kanë kapluar territorin e komunës sonë.

Gjithsej raste intervenimi gjatë këtij muaji drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim i ka bërë 98 raste.

1. Zjarre në objekte ndërtimore-4 raste
2. Zjarre malore-10 raste
3. Zjarre fushore-65 raste
4. Zjarre në ushqim bagëtish-2 raste
5. Zjarre në kontejnerë dhe mbeturina-6 raste
6. Zjarre të tjera-1 rast
7. Intervenime teknike-1 rast
8. Aksidente në komunikacion-5 raste
9. Pastrimi i vendit të ngjarjes pas aksidentit-2 raste
10. Vërshimet në objekte-2 raste
11. Thirrje të rrejshme-1 rast

Edhe gjatë muajit shtator raste e intervenimit kanë pasur një intensitet më të lartë të rritjes, ku kemi pasur gjithsej 122 raste intervenimi;

1. Zjarre në objekte ndërtimore-2 raste
2. Zjarre në objekte ndihmëse-1 rast
3. Zjarre malore-17 raste
4. Zjarre fushore-92 raste
5. Zjarre në ushqim bagëtish-3 raste
6. Zjarre në kontejnerë dhe mbeturina-2 raste
7. Intervenime teknike-1 rast

8. Aksidente në komunikacion-1 rast
9. Furnizim me ujë-2 raste
10. Thirrje të rrejshme-1 rast

Në muajin tetorë kemi ulje të rasteve të intervenimit, gjithsesi gjatë muajit tetor, kemi gjithsej 54 raste intervenimi;

1. Zjarre malore-3 raste
2. Zjarre fushore- 47 raste
3. Zjarre në automjete-1 rast
4. Aksidente në komunikacion-1 rast
5. Pastrimi I vendit të aksidentit-2 raste

Muaji nëntor ka qenë një muaj i qetë në territorin e komunës së Malishevës, gjithsej raste intervenimi i kemi pasur 15 raste;

1. Zjarre në paisje elektrike-2 raste
2. Zjarre fushore-2 raste
3. Intervenime teknike-2 raste
4. Aksidente në komunikacion-6 raste
5. Shërbime tjera-1 rast
6. Thirrje të rrejshme-2 raste

Në muajin dhjetorë kemi pasur gjithsej 23 raste intervenimi, pa pasur pasoja me fatalitet.

1. Zjarre në objekte ndërtimore- 3 raste
2. Zjarre në paisje elektrike-6 raste
3. Zjarre fushore-4 raste
4. Zjarre në ushqim bagëtish-2 raste
5. Intervenime teknike-3 raste
6. Aksidente komunikacioni-1 rast
7. Shërbime tjera-1 rast
8. Vërshimet në objekte-3 raste

Totali i daljeve në teren gjatë vitit 2023 ka qenë 414 raste intervenimi, ku vlen të ceket se nuk kemi pasur raste me fatalitet por vetëm dëme të konsiderueshme materiale.

Spektori i Planifikimit Emergjent,

Edhe gjatë kësaj periudhë ka vazhduar të jetë elementi themelor në identifikimin e shkaktarëve të rrezikut dhe evidencimin e tyre.

Spektori i Planifikimit Emergjent, gjatë kësaj periudhe ka kryer punët në:

Freskimin e Planit të Vlerësimit të Rrezikut për territorin e Komunës së Malishevës me të dhëna të reja.

Freskimin e Planit të Reagimit për Komunën e Malishevës, Inspektimin e Rasteve Emergjente,

Përgatitjen e plan-projekteve për: (zjarret, ethe hemorragjike etj.)

Hartimin e plan-projektit për vendosjen e videokamerave në Qytezë, faza e dytë,

Menaxhimi i Plan-projekteve në spërkatjen e territorit të Komunës së Malishevës kundër rriqrave nga toka, dhe kontratave të ndryshme, inspektimit të shkaktarëve të rasteve Emergjente, si dhe punë dhe detyra të tjera për të cilat është i autorizuar.

Spektori për Informim dhe Alarmim, gjatë këtij muaji, ka kryer detyrat e veta të parashtruara sipas ligjit, rregulloreve, udhëzimeve administrative që janë në fuqi dhe urdhrave dhe urdhëresave. Qendra Operative Emergjente Lokale (QOEL) në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim nuk ka qenë e aktivizuar.

➤ **Njësi për Zjarrfikje dhe Shpëtim (NjPZSH)**

NjPZSH gjatë kësaj periudhe ka kryer detyrat sipas përshkrimit të vendeve të punës, Planit të Punës, Rregullores së NjPZSH dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushëveprimtarinë e NjPZSH-së duke aplikuar standardet e kërkuara.

Me sukses janë arritur objektivat, qëllimi kryesor i të cilave ka qenë luftimi i zjarrit dhe mbrojtja e pasurisë dhe të mirave materiale të qytetareve, duke qëndruar sa ma afër komunitetit ku punojmë dhe jetojmë.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur dëmtime në të mira materiale apo edhe humbje jete si pasojë e zjarreve.

Fatmirësisht zjarret kanë qenë fushore dhe të menaxhueshme, aksidente trafiku me dëmtime materiale dhe jo me fatalitet.

Spektori i Preventivës ndaj zjarrit dhe Hulumtimit

Spektori i Preventivës ndaj zjarrit dhe Hulumtimit, në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë tre mujorit, Prill, Maj, Qershor - 2023 ka vazhduar të jetë elementë themelor i parandalimit të zjarrit, në bazë të ligjit për mbrojtje nga zjarri me Nr 04/L012 .

Gjendja e përgjithshme e mbrojtjes (parandalimit) nga zjarri në këtë qytet, është bërë duke marrë parasysh (objektet vitale) edhe pompastacionet për furnizim të qytetarëve me derivate dhe gaz pothuajse është e mirë (e volitshme), pasi që ata i (kryejnë) evitojnë masat kryesore të parandalimit nga zjarri dhe e marrin shumë serioze (situatën) dhe 70% prej tyre i evitojnë mangësitë në objekte në afatin prej 15 ditësh deri në 30 ditë.

Problem në vete paraqesin tani ndërtimet e reja të cilat janë mbi katërkatëshe, ku ato ndërtohen në vende ku mundësia e intervenimit të shërbimeve emergjente është e vështirë dhe në disa raste e pamundshme, aty mungojnë daljet dhe shkallët emergjente, në hidrante mungon uji për intervenime etj.

Të gjitha këto janë probleme të cilat tani e ngarkojnë situatën në përgjithësi për një preventivë më të suksesshme në momentin e duhur.

Inspektime të rregullta në objekte publike dhe private. - Dalje në vende të ngjarjes për hulumtimin e shkaqeve të shpërthimit të zjarreve. - Lëshimi i pëlqimeve për mbrojtje nga zjarri në dokumentacionin investivo teknik për ndërtimin e objekteve. Gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer inspektime të rregullta në objekte të impianteve për shitjen e derivateve të naftës dhe butan gazit, objekte industriale, hotele, qendrave tregtare, lokaleve afariste, institucioneve shkollore dhe shëndetësore. - Në bashkëpunim me hetuesit e stacionit policor kemi dal në vendet e ngjarjes për hulumtimin e shkaqeve të shpërthimit të zjarrit.

Me kërkesë të pronarëve të objekteve të djegura apo të dëmtuara nga shpërthimi i zjarrit janë lëshuar Raportet e zjarrit.

Në institucione Komunale është bërë verifikimi i aparateve për shuarjen e zjarreve, propozimi për plotësimin e aparateve shtesë dhe servisimin e aparateve ekzistuese.

Në vazhdim janë të evidentuara inspektimet gjatë kësaj periudhe kohore:

1. Inspektime të rregullta.....	10
2. Inspektimet kontrolluese.....	6
3. Masat e propozuara.....	6
4. Në sektorin publik.....	10
5. Në sektorin privat.....	12
6. Pëlqime në dokumentacionin investivo-teknik.....	0
7. Dalje në vendin e ngjarjes për hulumtimin e shpërthimit të zjarrit.....	10

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë kësaj periudhe, ka qenë bartëse e aktiviteteve në pergaditëjen dhe menaxhimin e emergjencave lokale ne territorin e Komunës së Malishevës, dhe e cila ka menaxhuar dhe koordinuar me Sherbimet Emergjente Komunale përmes, sektorëve mvarës në kryerjen e punëve dhe detyrave të parashtruara sipas planit të punës për vitin 2023, dhe në pëputhëshmeri me Ligjin, Udhëzimet dhe Urdhëresat administrative qe jane ne fuqi. Të gjitha sektorët e kësaj Drejtorie i kanë kryer punët dhe detyrat e veta të parashtruara me Ligjet, në kohë dhe me sukses.

Gjatë kësaj periudhe, përkundër rasteve emergjente që kanë ndodhur, e që si pasojë e tyre, nuk pasur humbje jete në njerëz, por vetëm dëme jo të konsiderueshme në të mira material, dhe që nuk pasur nevojë për aktivizimin e POEL.

Drejtorja Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe, aktivitetet e veta të angazhimit i ka zhvilluar sipas Planit të Punës së DMSH-së për vitin 2023, duke realizuar aktivitetet si në vijim, dhe atë në:

1. Mirëmbajtjen e Planeve Emergjente për komunën e Malishevës,
2. Mbajtjen e Gadishmerisë së personelit të Drejtorisë dhe (ERE) Ekipeve për Reagim, gjatë situatave Emergjente, dhe OQ-ve (Organizata Qeveritare), të përfaqësuar në KKMSH (Komitetin Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim-Shtabi),
3. Inspektimin e rasteve Emergjente, (zjarreve, vërshimeve, aksidenteve etj) dhe shkaktarëve të reziqeve, (shembje dheu dhe rreziqet e tjera), duke dhënë rekomandime dhe kërkesa,
4. Hartimin e Plan-Projektit për themelimin e SKMSHN-së (Struktura Komunale për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë),
5. Pjesmarrja aktive e personelit të DKMSH-së në Grupe punuese për hartimin e Planeve Komunale (Planit të Integritetit etj.),
6. Koordinimi i punës së KKSBS-së (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi),
7. Përgjigjëja ndaj kërkesave të qytetarëve,
8. Paraqitjen e kërkesave për furnizim me mjete të punës, paisje dhe pranim të personelit si: (pranim të personelit në NjPZSH, veshmbathje dimrore, autoveturë, paisje të IT, material higjienik dhe administrativë,
9. Menaxhimi i kontratave dhe pjesmarrja e personelit ne komisione per pranimin e punve,(Ethet hemoragjik KK,desinsektimi i QKMF,

Kurse, Sektori i Preventivës ndaj zjarrit dhe hulumtimit, gjatë kësaj periudhe ka qenë bartës i aktiviteteve në Inspektimin dhe Preventivën kundër zjarrit në territorin e komunës së Malishevës, duke bërë gjithsej:

- Inspektime fillestare - 10 (në prona private dhe shoqërore),
- Inspektime të rregullta - 5,dhe
- Verifikime - 5,

QOEL (Qendra operative Emergjente Lokale) ka kryer detyrat e veta të parashtruara sipas ligjit, rregulloreve, udhëzimeve administrative që janë në fuqi dhe urdhrave dhe urdhëresave, duke qenë elementi themelor i informimit, vëzhgimit dhe të alarmimit, si dhe duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me Qendra të tjera Operative Emergjente të të gjitha niveleve të Republikës së Kosovës

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë kësaj periudhe, ka qenë bartëse e aktiviteteve në përgatitjen dhe menaxhimin e emergjencave lokale ne territorin e Komunës së Malishevës, dhe e cila ka menaxhuar dhe koordinuar me Shërbimet Emergjente Komunale përmes, sektorëve varës në kryerjen e punëve dhe detyrave të

parashtruara sipas planit të punës për vitin 2023, dhe në përputhshmëri me Ligjin, Udhëzimet dhe Urdhëresat administrative që janë në fuqi. Të gjithë sektorët e kësaj Drejtorie i kanë kryer punët dhe detyrat e veta të parashtruara me Ligjet, në kohë dhe me sukses.

Gjatë kësaj periudhe, përkundër rasteve emergjente që kanë ndodhur, e që si pasojë e tyre, nuk pasur humbje jete në njerëz, por vetëm dëme jo të konsiderueshme në të mira material, dhe që nuk pasur nevojë për aktivizimin e POEL. Drejtoria Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe, aktivitetet e veta të angazhimit i ka zhvilluar sipas Planit të Punës së DMSH-së për vitin 2023, duke realizuar aktivitetet si në vijim, dhe atë në:

- Mirëmbajtjen e Planeve Emergjente për komunën e Malishevës,
- Mbajtjen e Gatishmërisë së personelit të Drejtorisë dhe (ERE) Ekipëve për Reagim, gjatë situatave Emergjente, dhe OQ-ve (Organizata Qeveritare), të përfaqësuara në KKMSH (Komitetin Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim-Shtabi),
- Inspektimin e rasteve Emergjente, (zjarreve, vërshimeve, aksidenteve, etj) dhe shkaktarëve të rreziqeve, (shembje dheu dhe rreziqet e tjera), duke dhënë rekomandime dhe kërkesa,
- Hartimin e Plan-Projektit për themelimin e SKMSHN-së (Struktura Komunale për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë),
- Pjesëmarrja aktive e personelit të DKMSH-së në Grupe punuese për hartimin e Planeve Komunale (Planit të Integritetit etj.),
- Koordinimi i punës së KKS-së (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi),
- Përgjigjja ndaj kërkesave të qytetarëve,
- Paraqitjen e kërkesave për furnizim me mjete të punës, paisje dhe pranim të personelit si: (pranim të personelit në NJPZSH, veshmbathje dimërore, autoveturë, paisje të IT, material higjienik dhe administrativë, etj.

Gjatë periudhës së tre mujorit të fundit të vitit 2023, Tetor-Nëntor-Dhjetor, drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka qenë gjatë gjithë kohës e përgatitur për situatat të cilat nga ndryshimi i motit kanë rrezikuar ta godasin me vërshime vendin tonë.

Pas krijimit të situatës në teren nga të reshurat atmosferike, të shoqëruara me erëra të forta është ngrit niveli i gatishmërisë emergjente, duke vënë në veprim të gjithë kapacitetin reagues në Komunën e Malishevës.

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim duke e ngritur nivelin e gatishmërisë Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim duke e ngritur nivelin e gatishmërisë, ka menaxhuar me situatën duke qenë vazhdimisht në monitorimin e situatës dhe duke u koordinuar me personelin dhe ekipet për reagim Emergjent, përmes Qendrës Operative Emergjente Lokale, duke qenë vazhdimisht në kontakt me Qendra të tjera Operative të nivelit Regjional dhe atë AME-MPB-së.

Përmes ZKI, njoftimet e vazhdueshme në media lokale mbi gjendjen dhe në komunën tonë përmes QOEL, janë mbajtur kontaktet e vazhdueshme me KEDSI-në, Hidroregjionin Jugor Ekoregjionin dhe PTK-në furnizimi me energji elektrike, me ndërprerje të vogla si pasojë e dëmtimit të rrjetit elektrik nx137 fshatrat Bellanicë dhe Kërvasari, të cilat janë të sanuara. Furnizimi me ujë, njoftimi ose rekomandimi që të vlohët para se të përdorët për pije. Telefonia dhe Interneti, nuk ka pasur ndërprerje. NJPZSH, ka pasur 7 (shtatë) intervenime. Shërbimet tjera publike kanë funksionuar pa probleme të theksuara. Kërkesa nga QOEL, nuk ka pasur. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar mbajtja e nivelit të gatishmërisë së personelit dhe ERE. Ka vazhduar monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes dhe evidencimi i pikave kritike për intervenim. Fokusimi i shërbimeve publike ka qenë i pandërprerë, uji vazhdon të jetë ende i pa përdorshëm, përgatitja për vlerësimin dhe sanimin e dëmeve, mbajtja e komunikimit me Qendra Operative, kërkesa për caktimin e Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve fatkeqësitë natyrore.

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Drejtorja për Administratë të Përgjithshme ka vazhduar me punët e përditëshme për ofrimin e shërbimeve sa më efikase ndaj qytetarëve të Komunës së Malishevës.

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORIVE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS (Janar – Dhjetor 2023)

Shërbimi i Gjendjes Civile në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithëshme të KK të Malishevës edhe gjatë muajit Janar- Dhjetor 2023 i ka kryer shërbimet sipas kërkesave të qytetarëve në harmonizim me ligjet dhe rregulloret që aplikohen, Kërkesat janë kryer me kohë dhe gjithëherë janë zgjidhur sipas procedurës duke ju përmbajtur afateve ligjore

Tani e japim e raportin e këtij shërbimi si vijon ;

- Aktvendime për ndrrimin, përmisimin e emrit apo të mbiemrit personal..... 105
- Aktvendime për regjistrime me vones në LAL.....126
- Aktvendime për regjistrime me vones në LAV..... 42
- Vertetim sqarime të ndryshme..... 00
- Anulime të regjistrimeve në LAL..... 13

RAPORT I REGJISTRIMEVE DHE LËSHUARJES SË CERTIFIKATAVE NË SHËRBIMIN E GJENDJES CIVILE KK. MALISHEVË PËR PERIODEN JANAR-DHJETOR- 2023

Muaji	Jan ar	Shk urt	Ma rs	Pri ll	Maj	Qersh or	Korr ik	Gus ht	Shtat or	Teto r	Nën tor	Dhjet or	Total
Regjistrimet e reja në LAL	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00
Regjistrimet e mëvon. në LAL	17	07	14	21	07	12	15	04	04	04	09	16	130
Regjistrimet e reja në LAM	80	55	63	57	44	38	26	98	36	46	42	75	660
Regjistrimet e mëvon. në LAM	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00
Regjistrimet e reja në LAV	13	07	16	05	06	09	11	19	13	13	07	12	131
Regjistrimet e mëvon. në LAV	00	03	04	03	08	04	03	01	00	07	06	02	41
Certifikata të Lindjes	204 6	1071	140 1	18 50	142 1	1609	1813	3893	1258	1064	919	1355	20746
Certifikata Martesore	586	432	558	45 0	455	407	374	739	397	445	317	387	5547
Certifikata të Vdekjes	65	64	86	63	91	53	60	97	71	43	61	52	806
Certifikata të Statusit Martesor	275	175	177	18 2	180	123	139	357	157	177	120	227	2289
Deklaratë për bashkësinë familjare	08	564	674	42 9	515	901	350	746	409	387	223	152	5358
Certifikatë e Shtetësisë	09	12	19	11	09	20	12	20	10	08	10	05	145
Certifikatë e Vendbanimit	178	171	233	21 2	226	190	370	392	251	172	160	201	2756
Ekstrakte të Lindjes	224 4	1741	21 08	15 91	179 5	1659	2315	3440	1642	1347	1155	1882	22919
Vërtetim nga Arkiva	55	58	42	38	36	27	26	37	38	34	23	38	452

RAPORT I REGJISTRIMEVE DHE I LËSHUARJES SË CERTIFIKATAVE NË SHËRBBIMIN E GJENDJES CIVILE KK MALISHEVË PËR REGJISTRIMET E LINDJEVE, MARTESAVE DHE VDEKJEVE QË KANË NDODHUR JASHTË KOSOVËS PËR PERIODËN JANAR- DHJETOR 2023

Muajt Regjistrimet	Jan ar	Shk urt	Mar s	Prill	Maj	Qersh or	Korr ik	Gush t	Shtat or	Tetor	Nënt or	Dhje tor	Tota l
Regjistrimet në LAL	10	11	08	26	13	24	27	87	16	14	18	32	286
Regjistrimet në LAM	01	02	03	03	03	03	01	19	03	02	01	04	162
Regjistrimet në LAV	00	01	00	01	02	02	02	04	00	01	01	03	17
Certifikata Lindjes	08	06	07	22	13	12	13	59	12	11	10	28	201
Certifikata Martesës	01	01	02	03	03	02	02	22	01	01	00	04	42
Certifikata Vdekjes	00	01	00	02	00	01	01	04	00	00	02	01	12

DREJTORIA PËR EKONOMI, BUXHET DHE FINANCË

Në bazë të Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048 si dhe Ligjit nr.03/L-221 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-048, gjegjësisht nenit 6.3,6.4 si dhe nenit 45, për raportimet vjetore dhe periodike mbi menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit, Organizatat buxhetore janë të obliguara ti paraqesin raportet periodike dhe përfundimtare financiare.

Prandaj Drejtoria për Buxhet dhe financa ka përpiluar raportin financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2023 në bazë të standardeve të Kontabilitetit dhe procedurave të thesarit mbi të hyrat dhe shpenzimet e ndodhura në këtë periudhë.

